



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Komunikim”  
me profilet “Gazetari”, “Marrëdhënie Publike”, “Grafikë-  
Dizajn” dhe “Marketing”  
i  
Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Europian i  
Tiranës”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Arben Muka

2. Dr. Diana Kalaja

Korrik 2022

## TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Për programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Komunikim” me profilet “Gazetari”, “Marrëdhënie Publike”, “Grafikë Dizajn” dhe “Marketing”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti European i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Humane dhe të Komunikimit (Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale )
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Komunikim” me profilet “Gazetari”, “Marrëdhënie Publike”, “Grafikë Dizajn” dhe “Marketing”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 636, date 20.09.2006
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Shkresë MASR Nr. 8244/2 prot, datë 12.09.2018
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	
7	Urdhëri/ VBA i akreditimit të parë:	Urdhër i MAS Nr. 162 datë 07.4.2016
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vjet
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/ PAK për programin e studimit (2021- 2022):	26 PAE/ 4 PAK
18	Numri i studentëve: (2018-2019 deri 2021- 2022):	128 student
19	Komente / të tjera:	-

## TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Ky program studimi që është në fokus të GVJ-së njihet në Universitetin Europian të Tiranës, UET, si një ndër programet e studimit më të hershëm të ciklit të parë, Bachelor. Programi menaxhohet nga Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit, si njësi bazë, pjesë e Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, riorganizuar me Urdhër të Ministrit Nr. 528 datë 04.09.2018.


UET, me rreth 16 vite aktivitet prej daljes së VKM-së nr. 636, dt. 20.09.2006 për hapjen e universitetit (akredituar më pas me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr.246, dt. 24.07.2009) ka investuar për ndërtimin e një strukture programore në tri nivelet e studimit, ku programi “Komunikim” në BA ka si karakteristikë thelbësore një zhvillim të qëndrueshëm në harmonizimin e aspekteve teorike me shprehitë aplikative për 4 profilet që ndjekin studentët Marrëdhënie Publike, Gazetari, Marketing dhe Grafikë-Dizajn. (Duhet theksuar se ky program studimi është hapur me 5 profile, prej të cilave 4 që janë përmendur më sipër janë aktive aktualisht, kurse profili tjetër, Multimedia, bazuar në vendimin nr. 11 të Senatit të UET, datë 26.03.2021, nuk është aktiv). Profilet e programit, bazuar në kurrikulën e ndërtuar krijojnë një spektër orientimesh për angazhimin e studentëve mbi PR, shkrim dhe raportim të lajmit, aspekte të etikës e deontologjisë, multimedia dhe konvergjenca e tregut mediatik, marketimit në nivele të ndryshme, etj.

Organizimi i lëndëve në program ka 4-6 kredite sipas ECTS, Sistemit Europian të Transferimit të Krediteve, kurse punimi i diplomës (kur studenti ka mesatare 8.5 e lart), ose provimi i përgjithshëm përfundimtar ka nivelin më të lartë të krediteve të fituara, 7. Shumatorja e krediteve për të tri vitet e ndjekjes së programit është 180 ECTS, në përputhje me legjislacionin e vendit tonë dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve. Ndarja e krediteve në të gjithë periudhën kohore të studimit reflekton një ndarje thuajse e barabartë e krediteve në secilin prej dy semestrave të vitit akademik– si një tregues për shpërndarje proporcionale të ngarkesës për studentët.

## SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Programi i studimit Bachelor në “Komunikim” me profilet “Gazetari”, “Marrëdhënie Publike”, “Grafikë Dizajn” dhe “Marketing” zhvillohet pranë Departamentit të Shkencave Humane dhe të Komunikimit, Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, në Universitetit Evropian të Tiranës. Programi është i shtrirë në 3 vite akademike më 180 kredite ECTS.

Akreditimi periodik i këtij programi studimi është bërë me Urdhër të MAS Nr. 162 datë 07.4.2016 mbështetur në Vendimin nr. 128, datë 18.02.2016, të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë. Sipas këtij vendimi “... Programi i studimit, Bachelor në “Komunikim – Marrëdhënie Publike” i përmbush “Standardet shtetërore të cilësisë” për akreditimin e programeve të studimit të ciklit të parë dhe se Universiteti Europian i Tiranës, i ka plotësuar njëkohësisht të gjitha rekomandimet e lëna nga akreditimi i mëparshëm i programit të studimit.”



## Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) e nisi punën që në prill 2022, me takimin e përbashkët dhe përcaktimin e detyrave kryesore që do të realizoheshin gjatë procesit të vlerësimit. Në bashkërendim midis dy ekspertëve të jashtëm të vlerësimit dhe stafit të ASCAL u përcaktuan edhe datat e vizitave. Datat e vizitave në Universitetin Evropian të Tiranës si edhe axhenda e takimeve u dakordësuan edhe me stafin e institucionit me programin në proces akreditimi. Vizitat u realizuan fizikisht në institucion, për shkak të lehtësisë të situatës nga pandemia COVID – 19. Vizita u bë në datë 28 prill 2022.

GVJ u njoh me të gjithë dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni në proces akreditimi përmes platformës dhe kredencialet që secili nga vlerësuesit e jashtëm ka në faqen zyrtare online të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Në ditën e vizitës në UET u zhvilluan takime me Dekanan e Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, me Përgjegjësin e Departamentit, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, stafin e programit në proces akreditimi, Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyrën e Karrierës, të Marrëdhënieve me studentët dhe marrëdhënieve me jashtë, etj. Gjithashtu u vizituan edhe ambientet e UET, sallat e leksioneve, seminareve, laboratorët kompjuterikë dhe laboratorët specialë të Teknologjisë së Informacionit. Vizitat në ambientet e UET ishin të nevojshme për të parë edhe mjediset e reja ku është vendosur universiteti duke filluar nga viti shkollor 2021-2022.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm kërkoi plotësimin me disa materiale të nevojshme për vlerësimin përfundimtar të programit të studimit. Materialet e kërkuara u plotësuan dhe u vendosën në platformën online të ASCAL. Gjatë gjithë këtij procesi vlerësimi ka pasur një bashkëpunim korrekt dhe mirëkuptues midis grupit të vlerësimit të jashtëm dhe stafit të UET.

Koordinator teknik nga ASCAL në këtë vlerësim ka qenë Msc. Aviola Bardhi.

Më datë 14/07/2022, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 87/75 Prot., datë 14/07/2022, dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm.

IAL kthehu përgjigje, përmes AMS, më datë 21/07/2022 dhe me shkresë zyrtare Nr. 120/10 Prot., datë 21/07/2022.

IAL nuk ka komente mbi draftin, kështu drafti kthehet në raport final.

**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Komunikim” me profilet “Gazetari”, “Marrëdhënie Publike”, “Grafikë- Dizajn” dhe “Marketing”**

**I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR**

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë nga Universiteti Europian i Tiranës, rregullores së programit, Statutit të institucionit, si edhe informacioneve të marra gjatë vizitës në institucion, GVJ konkludon se programi i studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Komunikim” me profilet “Gazetari”, “Marrëdhënie Publike”, “Grafikë Dizajn” dhe “Marketing” nuk bie ndesh me interesat kombëtare.
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programet e studimit të ofruara nga Universiteti Europian i Tiranës, synojnë konsolidimin e vlerave akademike dhe kulturore të vendit. Deklarata e vizionit të UET thekson “... UET do të punojë e përipiqet vazhdimisht për thellimin e traditave më të mira universitare shqiptare ...” Në Strategjinë e kërkimit shkencor 2021-2025 theksohet se “...UET synon shndërrimin në një <i>qendër ekspertize</i> në fushën e studimeve shoqërore, humane, juridike, ekonomike dhe teknologjisë së informacionit.” <i>Referencë:</i> 2. Statuti i UET 3.2 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025 3.3 PLANI STRATEGJIK UET 2021
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë, GVJ konstaton se programi i studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Komunikim” me profilet “Gazetari”, “Marrë me Publikun”, “Grafikë Dizajn” dhe “Marketing” është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe me politikat e zhvillimit të Institucionit, në lidhje me përgatitjen e profesionistëve në fushën e komunikimit. <i>Referencë:</i> 2. Statuti i UET 3.2 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025 3.3 PLANI STRATEGJIK UET 2021
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ ose kombëtar.	Gjatë studimit të dokumentacionit të përcjellë nga institucioni GVJ konstaton se programi i Ciklit të Parë Bachelor “Komunikim” me profilet “Gazetari”, “Marrë me Publikun”, “Grafikë Dizajn” dhe “Marketing” është hapur duke pasur parasysh nevoja e tregut dhe programi është formatuar edhe studimeve periodike mbi tregun e punës dhe bashkëpunimeve të vazhdueshme me Bordet e Tregut të Punës që ka ndërtuar universiteti “... nevoja për profesionistë të kualifikuar në këtë fushë të veçantë të dijes dhe të shkencës, për të plotësuar kërkesat e

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 6

	<p>tregut sa i përket institucioneve të fushës specifike, atyre shtetërore e organizatave joqeveritare me ekspertë të fushës së studimeve të komunikimit që njohin njëkohësisht edhe kontekstin e komunikimit, të marrëdhënieve publike e debatet bashkëkohore politike dhe kulturore.”</p> <p>Referencë: 17. Studim i tregut të punës</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi I.2

**Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentacionin e përcjellë konstaton se programi i studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Komunikim” me profilet “Gazetari”, “Marrë me Publikun”, “Grafikë Dizajn” dhe “Marketing” ofrohet në përshtatje me strategjinë e zhvillimit të vetë institucionit.</p> <p>Në “Planin Strategjik 2021” të UET janë të përcaktuara cili është vizioni dhe objektivat strategjike që ky institucion i arsimit të lartë ka në drejtim të programeve studimore që organizon. Në vizion përshkruhet edhe që “... UET synon të ofrojë edukim dhe kërkim të standardeve të krahasueshme me tregun evropian të edukimit. E gjithë veprimtaria e UET do të zhvillohet në mënyrë që të përfitojë e gjithë shoqëria në shkallë lokale, kombëtare dhe më gjerë.”</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Dhe më tej “...UET të punojë për thellimin e traditave më të mira universitare shqiptare, si dhe të kontribuojë në thellimin e lirisë akademike, dëshirës për ndjekjen e studimeve universitare, krijimin e disiplinës akademike e intelektuale në emër të karrierave sa më të qëndrueshme e cilësore, vullnetin për ta parë universitetin si qendër të inovacionit dhe zhvillimit si dhe thellimin e sensit të komunitetit dhe bashkëpunimit.”</p> <p>Edhe Statuti i UET përcakton qartë drejtimet prioritare akademike të tij.</p> <p>Në “Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit BA Komunikim” theksohet se Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit mbështet planin strategjik të zhvillimit të programit për ciklin e parë të studimit “Bachelor” në “Komunikim” bazuar në përcaktimin e qartë të prioriteteve dhe objektiveve strategjike, për përmbushjen me sukses të misionit të tij në këtë program studimi. Ky dokument përcakton edhe objektivat strategjike dhe detajon gjashtë prioritetet kryesore në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Procesin mësimor</li> <li>- Aftësimin për kërkim shkencor</li> <li>- Marrëdhëniet me studentet dhe jetën studentore</li> <li>- Sferën e botimeve, projekteve dhe materialit akademiko-pedagogjik</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Trajnimin e vazhdueshëm të stafit akademik</li> <li>- Bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar</li> </ul> <p>Referencë:</p> <p>2. Statuti i UET</p> <p>3.2 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025</p> <p>3.3 PLANI STRATEGJIK_UET_2021</p> <p>4. Plani strategjik per zhvillimin e programit te studimit BA Komunikim</p>			
<b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë nga Universiteti Europian i Tiranës, rregullores së programit, Statutit të institucionit, GVJ konkludon se programi i studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Komunikim” me profilet “Gazetari”, “Marrë me Publikun”, “Grafikë Dizajn” dhe “Marketing” emërtohet, organizohet, strukturohet dhe ka përmbajtje në përputhje me fushën akademike dhe si një nga drejtimet dhe programet themeluese të këtij universiteti, shkencat humane dhe të komunikimit.</p> <p>Referencë:</p> <p>2. Statuti i UET</p> <p>3.2 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025</p> <p>3.3 PLANI STRATEGJIK_UET_2021</p> <p>4. Plani strategjik per zhvillimin e programit te studimit BA Komunikim</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi I.3</b>	
<b>Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.	<p>Në “Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit BA Komunikim” theksohen qartësisht objektivat strategjike të programit si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Të përgatisë specialistë të nivelit të lartë, ekspertë të komunikimit dhe praktikues të mediave, si edhe ushtrues të marrëdhënieve publike e komunikimeve strategjive, por edhe ekspertë të komunikimeve ndërkulturore e më gjerë;</li> <li>2. Të përshatë njohuritë teorike dhe praktike me kërkesat e tregut të punës;</li> <li>3. Të ofrojë mësimdhënien me pedagogë të aftë, me eksperiencë të gjatë në mësimdhënie, me kontribut në fushën akademike, në bashkëpunim me profesorë të ftuar nga universitetet më të mira, nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit;</li> <li>4. Të përdorë metoda interaktive dhe audiovizuale të mësimdhënies për përvetësimin sa më të mirë të njohurive nga ana e studentëve;</li> <li>5. T’i ofrojë studentëve mundësi të shkëmbimit të studimeve, jashtë vendit;</li> <li>6. Të zhvillojë kërkimin shkencor nëpërmjet projekteve, angazhimit të stafit akademik efektiv dhe studentëve;</li> </ol>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 8



	<p>7. Të sigurojë marrëdhënie të drejtpërdrejta me tregun e punës; 8. Të ofrojë mundësi për trajnimin e vazhdueshëm profesional.</p> <p>Këto objektiva i gjejmë të pasqyruar në kurikulën që ofrohet, planin mësimor, syllabuset dhe praktikat profesionale.</p> <p><i>Referencë:</i> 2. Statuti i UET 4. <i>Plani strategjik per zhvillimin e programit te studimit BA Komunikim</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>UET ka realizuar studime periodike mbi tregun e lokal të punës. Studimi evidenton se <i>“...Nevoja për programet kryesore të studimit që ofron Departamenti, që janë programe të Komunikimit dhe Marrëdhëniet Publike kanë qenë të vazhdueshme dhe madje gjatë vitit aktual akademik janë rritur, gjë që lidhet edhe me rritjen dhe shtimin e organizatave dhe kompanive të biznesit që operojnë në vend si edhe institucioneve publike e private, lidhur gjithashtu ngushtësisht me tregun e mediave klasike dhe mediave të reja, që ka marrë hov vitet e fundit edhe në Shqipëri.”</i></p> <p>UET ka një përvojë shumë të mirë me krijimin e Bordeve të Tregut të Punës. Këto borde dhe Programi i bashkëpunimit me biznesin në kuadër të Projekti 500+ janë një mundësi shumë e mirë për të lidhur njohuritë e marra në auditor me tregun e punës si edhe për tu dhënë mundësinë e njohjes dhe përfshirjes në treg pas përfundimit të studimeve.</p> <p>Në studim për tregun e punës janë të përfshira edhe mundësitë e punësimit të studentëve nëpërmjet një seksioni të veçantë të lidhur me karrierën dhe punësimin e studentëve.</p> <p><i>Referencë:</i> 12.1 <i>Bordi i Tregut të Punës 2017-2021</i> 12.3 <i>Realitetet e Reja të Post- Covid 19 në Tregun e Punës _2020</i> 12.4. <i>Bashkepunime me biznesin - Projekti 500+</i> 17. <i>Studim i tregut të punës</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Objektivat formuese struktura dhe përmbajtja programi i studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Komunikim” me profilet “Gazetari”, “Marrë me Publikun”, “Grafikë Dizajn” dhe “Marketing”, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë përfitim të dijeve, aftësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p> <p>Studentët që diplomohen në këtë program studimi mund të punojnë si zyrtarë e shtypit dhe marrëdhëniet me publikun, në media dhe në zyra të tjera komunikimi dhe grafike.</p> <p>Gjatë vizitës në UET nga kontakti me studentët disa prej tyre ishin të punësuar.</p> <p><i>Referencë:</i> 7. <i>RREGULLORE MËSIMORE BA Komunikim</i> 12.1 <i>Bordi i Tregut të Punës 2017-2021</i></p>

	12.3 Realitetet e Reja të Post-Covid 19 në Tregun e Punës_2020 12.4. Bashkepunime me biznesin - Projekti 500+ 17. Studim i tregut të punës			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### Standardi I.4

Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>GVJ bazuar në vlerësimin e dokumentacionit konstaton se Universiteti Evropian i Tiranës ka përvojën (eksperiencë mbi 16 vjeçare në fushën akademike), kapacitetet si në infrastrukturë dhe struktura ndihmëse universitare dhe burimet njerëzore.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, është një ndër fakultetet themeluese të Universitetit Evropian të Tiranës. Në themelimin e tij në vitin 2006 UET kishte si njësi kryesore “Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Edukimit”. Ndërsa me vendimin e Ministrisë së Arsimit në 2008, fakulteti u riorganizua me emërtimin që mban edhe sot. Fakulteti mbledh rreth vetes një staff me përvojë akademike disa vjeçare, me tituj dhe grada shkencore dhe drejtues të disa veprimtarive të mirëfillta kërkimore dhe shkencore.</p> <p>Në vitin aktual të studimit <b>2021-2022</b> stafi i departamentit të Departamenti i Shkencave Humane dhe të Komunikimit ka 11 staff PAE dhe PAK (10+1) Sipas Tabelës 1 në Tabelat përmbledhëse për Ankes RVB. Mbi 50% e stafit të PAE dhe PAK kanë titull shkencor Dr. dhe Prof. Asc. Dr. Ndërsa njësi kryesore, pra Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale për stafin akademik PAE+PAK, në vitin akademik <b>2021-2022</b> kishte 7 Prof. Dr.; 5 Prof. Asc. Dr.; 16 Dr. dhe 30 me Msc ose Dr. në proces. 42 PAE dhe 16 PAK</p> <p>Bazuar në informacionin e përcjellë shtesa nga UET (Tabela 7) stafi akademik i angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Komunikim” me profilet “Gazetari”, “Marrëdhënie Publike”, “Grafikë Dizajn” dhe “Marketing” në vitin mësimor 2021-2022 është 26 PAE dhe 4 PAK duke përfshirë në këto shifra edhe asistentët e lektorëve dhe ata lektorë që janë të ftuar të japin vetëm një numër të kufizuar temash brenda lëndëve.</p> <p>Nga verifikimi i CV të personelit akademik, si me kohë të plotë ashtu edhe stafi i ftuar të japë lëndë specifike, tregohet se janë burimet njerëzore të duhura për realizimin e një mësimdhënie cilësore në këtë program studimi. Stafi akademik ka eksperiencë akademike dhe përvoja profesionale që më së miri japin <i>know-how</i> e duhur për realizimin e këtij programi studimi.</p> <p><i>Referencë:</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 10

	<p>0.2. Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB - Bachelor Komunikim</p> <p>19. Syllabuset lëndëve</p> <p>20. CV e personelit akademik.</p> <p><u>Informacionet plotësuese të kërkuara gjatë vizitës</u></p> <p>Tabela 7 - Stafit akademik_y.a.2021-2022</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Komunikim” me profilet “Gazetari”, “Marrëdhënie Publike”, “Grafik Dizajn” dhe “Marketing” është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, fakultetit, si edhe atë të njësisë bazë, Departamentit të i Shkencave Humane dhe Komunikimit. Departamenti ofron edhe programe të tjera studimi si në nivel e parë dhe të dytë. Lloji i programit të studimit dhe diploma që lëshohet me mbarimin e tij, emërtimi i programit të studimit, orientimi, gjuha e studimeve, forma e studimeve, kohëzgjatja e studimeve, aktorët e interesit, studimi i tregut si një proces i vazhdueshëm, dhe lidhja me Bordet e Tregut të Punës, vlerësimi dhe shpërndarja e krediteve janë në përputhje me standardet e vendosura kombëtare dhe evropiane.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>7. Rregullore e programit BA komunikim</p> <p>19. Syllabuset lëndëve</p> <p>20. CV e personelit akademik.</p> <p>0.2. Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB - Bachelor Komunikim.pdf</p> <p>26. Të dhëna për numrin e programeve që ofrohen nga njësi përgjegjëse (Aneks_Tabela 3)</p> <p>54.2 URDHER Nr.528, date 04.09.2018, Riorganizimin e F. i Shkencave Sociale dhe Edukimit ne ,F. i Sh. Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi I.5

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësisve respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Njësia bazë e këtij programi studimi, Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit në UET bashkëpunon me njësitë e tjera brenda institucionit si ato akademike ashtu edhe ato administrative për të siguruar mbarëvajtjen e realizimit me sukses të programit të studimit. Departamenti bën ndarjen e detyrave dhe koordinimin mes personelit akademik të departamentit duke përcaktuar përgjegjësitë si në nivel akademik ashtu edhe nga pikëpamja administrative.</p> <p>UET ka një bazë rregullatore të detajuar dhe akte që përcaktojnë rolin dhe detyrat funksionale si të departamenteve, dekanatit, etj. Rregullore</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 11

	<p>e UET si edhe Dokumenti “Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit” janë një themel i qartë në ndarjen e detyrave funksionale dhe mundësitë e bashkëpunimit midis njësive të ndryshme në UET. Departamenti e Fakulteti bashkëpunojnë me njësitë e tjera (Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Sekretaria mësimore, Arkiva dhe protokoli, Zyra e burimeve njerëzore, Zyra e zhvillimit të kurikulave, Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, Zyra e projekteve, etj)</p> <p>Departamenti në mënyrë periodike bën analizimin e ecurisë së procesit mësimdhënës dhe realizimin e bashkëpunimit në funksion të procesit mësimor. Gjatë vizitës në UET nga diskutimi me Dekanan e Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, GVJ u informua rreth mbledhjeve mujore që bën Departamenti si për ecurinë e programit apo edhe për progresin e studentëve. Në disa nga këto mbledhje marrin pjesë edhe studentët e programeve të studimit në mbikëqyrjen e departamentit.</p> <p><u>Referenca:</u></p> <p>5. Rregullore e UET</p> <p>6 F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit</p> <p>7. Rregullore mësimore BA komunikim</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>UET ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit, si dhe me organizma biznesi vendas ose të huaj. Në dokumentin “Lista e subjekteve bashkëpunuese për programin dhe praktikatat profesionale” jepen të listuara disa nga bashkëpunimet themelore të departamentit dhe fakultetit. Në këtë listë janë të renditura 20 institucione të ndryshme/ subjekte ku studentët mund të zhvillojnë praktikatat mësimore. Gjithashtu në kuadër të bashkëpunimeve për projekte ndërkombëtare dhe UET ka bashkëpunime me 15 IAL në vend dhe 94 institucione arsimore/ universitete në mbarë botën (Evropë, Amerikë, Australi dhe Kinë).</p> <p><u>Referenca:</u></p> <p>5. Rregullore e UET</p> <p>32. Lista e subjekteve bashkëpunuese për programin dhe praktikatat profesionale</p> <p>43.1 Të dhëna mbi projektet dhe shkëmbimin e stafit dhe studentëve</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ konstaton se Fakulteti Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale dhe departamenti analizojnë praktikatat profesionale të kryera nga studentët dhe ecurinë e tyre gjatë vitit akademik. Ecuria është e lidhur edhe me Bordet e Tregut të Punës që janë një mundësi shumë e mirë lidhje midis Fakultetit/ Departamentit dhe tregjeve për të zgjeruar mundësitë dhe njohjet e studentëve për tu përballuar me tregun.</p> <p><u>Referenca:</u></p> <p>35. Raporti analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe</p>	<p>GVJ konstaton se, procedura e zhvillimit të praktikave profesionale është e rregulluar nëpërmjet dokumentit përkatës “Mbi Praktikën Profesionale”. Në të janë parashikuar si procedurat që duhet të ndiqen</p>

mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	<p>ashtu edhe roli i aktorëve dhe njërive të ndryshme të përfshira në këtë proces. Sikurse u shpreh më sipër, UET ka lidhur 20 marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme ku kryhen praktikat mësimore, ndërkohë që praktikat kryhen edhe në institucione të tjera me të cilat nuk ka marrëveshje detyrimit të formalizuara me shkrim.</p> <p><i>Referenca:</i> 32.1 Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale</p>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	<p>Fakulteti organizon takime/ prezantime dhe workshop-e me të ftuar të ndryshëm për tematika që lidhen me lëndë të ndryshme dhe vijimësinë e mësimnxënies studentore. Kjo është e mundur në sajë të marrëveshjeve që UET ka lidhur me institucione të ndryshme, si edhe në kuadër të projekteve ndëruniversitare. Po kështu nga dokumenti “Trajnime të mëtjshme profesionale” janë listuara disa nga tematikat dhe të ftuarit në takimet / debatet profesionale/ forumet/panairt e punësimit / veprimtaritë e klubeve studentore për thellim të mëtjshëm.</p> <p><i>Referenca:</i> 33. Trajnime të mëtjshme profesionale</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X




## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Lëndët në programin që është në proces vlerësimi u identifikuan që kishin 4-6 kredite sipas ECTS, Sistemit European të Transferimit të Krediteve, kurse punimi i diplomës (kur student ka mesatare 8.5 e lart), ose provimi i përgjithshëm përfundimtar kanë nivelin më të lartë të krediteve të fituara (7). Shumatorja e krediteve për të tri vitet e ndjekjes së programit është 180 ECTS. GVJ e gjeti këtë mënyrë organizimi në përputhje me legjislacionin e vendit tonë dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>2. Statuti i UET. 5. Rregullore e UET. 7. Rregullore mësimore BA Komunikim. 7.2 Sistemi i vlerësimit të studenteve. 53. Ligji 80.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH".</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale dhe specialitetesh.</p>	<p>Programi "Komunikim" në ciklin e parë BA ka katër profile (Marrëdhënie Publike, Gazetari, Marketing dhe Grafikë-Dizajn), të cilat në vetvete krijojnë një spektër orientimesh që kanë lidhje me marrjen e njohurive dhe shprehive profesionale bazike mbi PR, shkrim dhe raportim të lajmit, aspekte të etikës e deontologjisë, multimedia dhe konvergjenca e tregut mediatik, marketimit në nivele të ndryshme etj. Këto përbëjnë një shtrojë të qëndrueshme për studentin që frekuenton një prej profileve të përmendur më sipër. Këtë mendim ndajnë dhe studentët me të cilët patëm rast të diskutojmë në grup apo në mënyrë individuale (sidomos ata që aktualisht ishin në vitin e tretë të këtij cikli).</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>4. Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit BA Komunikim. 7. Rregullore mësimore BA Komunikim. 14. Kurrikula e programit BA Komunikim. 14.2. Plani mësimor i programit - BA Komunikim. 14.3. Të dhënat për stafin akademik të angazhuar në programin e studimit 28. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Nga shqyrtimi kurikulës së programit që është në proces vlerësimi krijohet bindje se tri vitet akademike kanë një trajektore zhvilluese graduale për njohuritë dhe shprehitë që duhet të fitojë studenti që ndjek një nga 4 profilet. Lëndët, qofshin ato nga grupi bazik (A), apo karakterizuese (B), ndërdisiplinore (C) apo plotësuese (D) japin mundësi për marrjen e njohurive, nxitjen e thellimit në procesin kërkimor dhe shkencor, por dhe</p>

	<p>të aftësive në përballimin e detyrave gjatë angazhimit në redaksi, institucione të ndryshme, njësi a sipërmarrje etj. Kurikula e tri viteve në BA shquan dhe nxit te një pjesë të studentëve dëshirën për të vijuar ndjekjen e studimeve në nivelin MA. Ky ishte një mendim që u artikuluara dhe gjatë bisedës me studentët që ndjekin profilet e këtij program studimi.</p> <p><u>Referencë:</u>  2. Statuti i UET.  3.1 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020.  5. Rregullore e UET.  7. Rregullore mësimore BA Komunikim.  14.2. Plani mësimor i programit - BA Komunikim.  14.3. Të dhënat për stafin akademik të angazhuar në programin e studimit</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Kurikula e programit të studimit që është në fokus të vlerësimit, krahas njohurive në secilën nga 4 profilet që zgjedhin të studentët dhe krijimit të aftësive për punë kërkimore e shkencore, ju ofron gjithashtu dhe shprehni konkrete aplikative dhe angazhimi praktik – si një kombinim mes anës teorike dhe zbatueshmërisë për konceptet e fituara. Programi përfshin dhe aspekte të edukimit qytetar, me nocione të përgjithshme të domosdoshme në karrierën e tyre vijuese, si duke ndjekur programin e ciklit të dytë MA, apo duke u përfshirë në pozicione të përshtatshme në punë.</p> <p><u>Referencë:</u>  4. Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit BA Komunikim.  7. Rregullore mësimore BA Komunikim.  14. Kurrikula e programit BA Komunikim.  14.2. Plani mësimor i programit - BA Komunikim.  14.3. Të dhënat për stafin akademik të angazhuar në programin e studimit</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Sikundër është trajtuar në kriteret e mësipërme, ky program studimi mbështetet në kërkesat e ligjit për arsimin e lartë (80/2015), si dhe akteve nënligjore që janë miratuar dhe janë aktualisht në fuqi. Programi i studimit “Komunikim” në BA shtrihet në tri vite akademike dhe studenti duhet të grumbullojë 180 ECTS, si dhe do të duhet të finalizojë studimet me realizimin e punimit të diplomës ose provim përfundimtar të përgjithshëm.</p> <p><u>Referencë:</u>  4. Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit BA Komunikim.  7. Rregullore mësimore BA Komunikim.  53. Ligji 80.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH”.pdf  53.1. VKM Nr. 41, datë 21.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit”, e ndryshuar.pdf  54.2 URDHER Nr.528, date 04.09.2018, Riorganizimin e F. i Shkencave Sociale dhe Edukimit ne F. i Sh. Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>GVJ gjatë shqyrtimit të kurikulës së programit në fokus, por dhe nga bashkëbisedimet që ka realizuar gjatë vizitës në UET, krijoi bindje se struktura e zhvillimit të lëndëve nga viti parë dhe deri tek shlyerja finale (temë ose provim), përbën një kombinim të përshtatshëm për natyrën e lëndëve (grupet A-D), që japin mundësi për marrjen e njohurive, nxitjen e thellimit në procesin kërkimor dhe shkencor, por dhe të aftësive në përballimin e detyrave gjatë angazhimit në redaksi, institucione të ndryshme, njësi a sipërmarrje etj. Ndarja e ngarkesës për studentin që</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 15

	<p>ndjek programin është proporcionale gjatë tri viteve të zhvillimit të programit. Lëndët për 4 profilet e “Komunikim” në BA kanë 4-6 kredite, ndërkohë që punimi i diplomës (për studentët me mesatare 8.5 e lart) ose provimi i përgjithshëm ka 7 kredite. Në total për tri vitet e studimit janë 180 kredite.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>4. Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit BA Komunikim.</p> <p>7. Rregullore mësimore BA Komunikim.</p> <p>14.2. Plani mësimor i programit - BA Komunikim.</p> <p>14.3. Të dhënat për stafin akademik të angazhuar në programin e studimit 2021-2022. (dokumentet shtesë)</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Programi që është në fokus të këtij vlerësimi menaxhohet nga Departamenti i Komunikimit, si njësi bazë, pjesë e Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale. Bazuar në dokumentacionin që GVJ kishte në dispozicion, krijimi i Fakultetit bazohet në VKM Nr. 636, datë 20.09.2006, (riorganizuar me Urdhër të Ministrit Nr. 528 datë 04.09.2018).</p> <p>Akreditimi i Universitetit Evropian të Tiranës është bërë me vendimin e bordit të akreditimit (nr. 12, datë 07.04.2017) dhe pas riorganizimit me vendimin e bordit (nr. 46, datë 05.07.2019). Struktura e GVB dhe mënyra e procedimit për raportin që kanë prezantuar në ASCAL vlerësojmë se ka qenë në përputhje kuadrin ligjor dhe nënligjor që është në fuqi. Krijimi i GVB është bërë duke u bazuar në Urdhërin e Rektorit të UET (nr. 20, datë 24.11.2021).</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>2. Statuti i UET.</p> <p>3.3 PLANI STRATEGJIK UET 2021.</p> <p>7. Rregullore mësimore BA Komunikim.</p> <p>6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit.</p> <p>53. Ligji 80.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH”.</p> <p>54.2 URDHER Nr.528, date 04.09.2018, Riorganizimin e F. i Shkencave Sociale dhe Edukimit ne F. i Sh. Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në</p>	<p>Në takimet që zhvilluam me stafin akademik dhe drejtuesen e Departamentit, por dhe nga dokumentacioni që shqyrtoam, rolin e koordinorit për këtë program studimi e kishte një prej pedagogëve me kohë të plotë me gradën “Doktore e Shkencave”, e cila ishte pikëlidhje për komunikimin e studentëve me trupën e pedagogëve me kohë të plotë e të pjesëshme, departamentin dhe hallkat e tjera organizative dhe administrative; koordinuese për zhvillimin e kurikulës në tri vitet e studimit për 4 profilet e “Komunikim” në BA. Në komunikimin dhe</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 16



<p>përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>ndërveprim periodik me drejtuesin e Departamentit kordinatori ishte ndjekëse e proceseve të hartimit dhe shpërndarjes së silabus-eve të drejtuesve të lëndëve, të ecurisë së konceptimit dhe miratimit të temave të eseve, tezat për provimet apo zhvillimin e praktikave për studentët.</p> <p><u>Referencë:</u>  3.3 PLANI STRATEGJIK_UET_2021.  5. Rregullore e UET.  7. Rregullore mësimore BA Komunikim.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit mbi mënyrën e organizimit dhe strukturës akademike, por dhe nga bisedat që GVJ zhvilloi me pjesëtarë të stafit të angazhuar, krijoi mendim se në rang fakulteti, si njësia kryesore, apo në rang departamenti, si njësi bazë, përmbushen detyrimet e kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi. Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale ka numrin e nevojshëm të departamenteve dhe nga ana tjetër Departamenti ku përfshihet ky program studimi ka angazhuar staf akademik të kualifikuar sipas fushave të kurrikulës. Struktura bazë respekton dhe treguesin e raportit studentë-pedagogë, ku për shkencat sociale përcaktohet 1 pedagog për 45 studentë.</p> <p><u>Referencë:</u>  3.3 PLANI STRATEGJIK_UET_2021.  5. Rregullore e UET.  7. Rregullore mësimore BA Komunikim.  27.2. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik.  14.3. Të dhënat për stafin akademik të angazhuar në programin e studimit 2021-2022. (dokumentet shtesë)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Në Fakultetin e Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, në 3 departamentet janë të angazhuar në këtë vit akademik <b>(2021-2022) 42 pedagogë me kohë të plotë dhe 16 me kohë të pjeshme, në total 58.</b> Prej tyre janë 7 me titullin Prof.Dr. (4 PAE dhe 3 PAK); janë 5 Prof.Assoc. Dr (5 PAE dhe 0 PAK); me gradën shkencore Doktor janë 16 (10 PAE dhe 6 PAK); nuk ka asnjë me Doktoraturë në proces; si dhe janë 40 Msc. (23 PAE dhe 17 PAK). Numri dhe niveli kualifikimit të personelit akademik të angazhuar përmbush detyrimet e njësisë kryesore ku përfshihet ky program studimi. Sa i takon Departamentit të Shkencave Humane dhe Komunikimit, që është njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi për këtë vit akademik që është në vijim janë të përfshirë <b>11 pedagogë në total (10 PAE dhe 1 PAK).</b> Nga këta, nuk ka asnjë me titullin Prof.Dr; është 1 Prof. Assoc.Dr, (që është dhe drejtues departamenti), janë 5 me gradën Doktor (4 PAE dhe 1 PAK), asnjë me Doktoraturë në proces; 5 janë Msc. (të gjithë PAE).</p> <p>Njësia bazë i përmbush detyrimet për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik të përfshirë. Por duke shqyrtuar të dhënat për 3 vitet e fundit (2019-2020; 2020-2021 dhe viti akademik vijues) vihet re se niveli i kualifikimit ka rënie. Në vitin akademik 2019-2020 ka pasur të angazhuar në Departamentin e Shkencave Humane dhe Komunikimit më shumë pedagogë me kohë të plotë (12) dhe po kështu kanë qenë dhe me kohë të</p>



	<p>pjesshme (13). Në këtë vit akademik ka pasur 1 Prof.Dr (PAE); 5 Prof.Assoc.Dr (3 PAE dhe 2 PAK); 12 me gradën Doktor 12 (4 PAE dhe 8 PAK); si dhe Msc. 7 (4 PAE dhe 3 PAK). Por një vit më pas, 2020 – 2021, ka ndodhur rënia në nivelin e kualifikimit të personelit akademik të angazhuar në Department, nivel i ngjashëm me atë të vitit akademik vijues që u shpjegua më sipër. Gjatë takimit që zhvilloi GVJ me stafin akademik, u përmend fakti se në mënyrë të vazhdueshme njësia bazë ka nxitur personelin që të angazhohet për marrjen e gradave dhe titujve shkencorë në favor të procesit të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>4. Plani strategjik per zhvillimin e programit te studimit BA Komunikim. 7. Rregullore mësimore BA Komunikim. 14. Kurrikula e programit BA Komunikim. 26. Të dhëna për numrin e programeve që ofrohen nga njësia përgjegjëse_Tab 3. 44.1 Format Dosje, Staf Akademik me Kohë të Plotë.pdf 44.2 Format Dosje, Staf Akademik me Kohë të Pjesshme.pdf 7 Staf akademik_v.a.2021-2022. (dokumentet shtesë) 14.3. Të dhënat për stafin akademik të angazhuar në programin e studimit 2021-2022. (dokumentet shtesë)</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale është i organizuar në 3 departamente fokusi studimor i të cilave është brenda qëllimeve dhe objektivave të shpallur me themelimin e tij. Është respektuar nga pikëpamja organizative dhe struktura akademike përputhshmëria e nivelit të kualifikimit të personelit me lëndën për të cilën ai është ftuar të kontribuojë, qoftë me kohë të plotë, qoftë me kontratë. Detyrimet ligjore dhe n/ligjore i përmbush dhe njësia bazë që është përgjegjëse për programin e studimit “Komunikim”, sa i takon organizimit dhe strukturimit akademik. Departamenti zhvillon takime të përjavshme, ku është caktuar dita e martë. Veç anëtarëve të stafit që punojnë me kohë të plotë, në këto takime periodike janë prezentë dhe nga rradhët e pedagogëve të jashtëm, ekspertët e ftuar, apo dhe studentë – kjo pjesëmarrje është në varësi dhe të problematikës që është në fokus. Prezenca e studentëve u konfirmua dhe gjatë kontakteve me ta gjatë vizitës në mjediset e UET. Struktura bazë respekton dhe treguesin e raportit studentë-pedagogë, ku për shkencat sociale përcaktohet 1 pedagog për 45 studentë.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>7. Rregullore mësimore BA Komunikim. 3.3 PLANI STRATEGJIK_UET_2021. 5. Rregullore e UET. 7 Staf akademik_v.a.2021-2022. (dokumentet shtesë) 14.3. Të dhënat për stafin akademik të angazhuar në programin e studimit 2021-2022. (dokumentet shtesë)</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

**Standardi II.3**

**Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/ bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Për dinamikën e zhvillimit të programit të studimit “Komunikim” në BA (për të katër profilet) jepet akses njohës për komponentë të ndryshëm (kurikula, syllabus-et, metodat e vlerësimit, ndarja e programit sipas lëndëve për secilin nga vitet akademike etj.) informacione dhe të dhëna që studentët apo pedagogët i gjejnë në sistemin LMS. Të shkarkuara dhe të aksesueshëm janë dhe aktet dhe rregulloret bazike për funksionimin e UET, për Fakultetin e Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, apo për njësinë bazë që administron dhe menaxhon programin e studimit të ciklit të parë që kemi në fokus. GVJ e shqyrtoi konkretisht prezencën e publikimeve të informacioneve njohëse dhe orientuese në hapësirën virtuale të kësaj IAL-je, por dhe e konfirmoi dhe gjatë takimeve që zhvilloi në grup ose individualisht me studentët apo stafin akademik të “Komunikim” në BA. Njohja e studentëve në të tri vitet e studimit bëhej që në prag të fillimit të vitit akademik dhe vazhdonte me informacionin dhe të dhënat korrente që ata merrnin në mënyrë sistematike nga Departamenti apo drejtuesit e lëndëve, nga Zyrat e këshillimit dhe karrierës, nga zyra e KSBC etj. Studentët vlerësuan qarkullimin e informacionit mbi lëndët e modulet, proces që ishte intensifikuar më shumë gjatë periudhës së pandemisë Covid-19.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>7. Rregullore mësimore BA Komunikim.  14. Kurrikula e programit BA Komunikim.  14.2. Plani mësimor i programit - BA Komunikim.  14.3. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - BA Komunikim (Aneks_Tabela 9).  19. Silabus Metodat e kerkimit.  19.1 Format i Syllabusit.  37. Format i relacionit për monitorimin e silabuseve.  46.1 Urdher Mbi zbatimin e platformes LMS.  46.2 UET LMS - Guide per pedagogun.  46.3 UET LMS Guide per studentet.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit që është në fokus të vlerësimit reflekton kërkesat e legjislacionit në fuqi për mënyrën e organizimit në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese. Nga viti i parë deri në atë të tretë shikohet një ndarje logjike e lëndëve dhe moduleve duke harmonizuar marrjen e dijeve dhe nxitjen e kërkimit shkencor me fitimin e shprehive praktike nga ana e studentëve sipas profilit që ata kanë zgjedhur. Si një premisë për ndjekjen e nivelit të dytë apo dhe të tretë të studimeve, sipas nevojave dhe ambicies që ata shfaqin në karrierë.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>7. Rregullore mësimore BA Komunikim.  14. Kurrikula e programit BA Komunikim.  14.2. Plani mësimor i programit - BA Komunikim.</p>

	<p>14.3. <i>Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - BA Komunikim (Aneks_Tabela 9).</i></p> <p>19. <i>Silabus Metodot e kerkimit.</i></p> <p>19.1 <i>Formati i Syllabusit.</i></p> <p>37. <i>Formati i relacionit për monitorimin e silabuseve.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Program i studimit mbështetet në kërkesat e ligjit për arsimin e lartë (80/2015), si aktet nënligjore në fuqi, duke u shtrirë në tri vite akademike, ku studenti grumbullon në total 180 ECTS, të ndara 60 ECTS për çdo vit akademik. Nga shqyrtimi i ndarjes së krediteve në të gjithë periudhën kohore të studimit reflektohej realisht dhe një ndarje thuajse e barabartë e krediteve në secilin prej dy semestrave të vitit akademik – si një tregues për shpërndarje proporcionale e ngarkesës për studentët.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>4. <i>Plani strategjik per zhvillimin e programit te studimit BA Komunikim</i></p> <p>7. <i>Rregullore mësimore BA Komunikim.</i></p> <p>14. <i>Kurrikula e programit BA Komunikim.</i></p> <p>14.2. <i>Plani mësimor i programit - BA Komunikim.</i></p> <p>14.3. <i>Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - BA Komunikim (Aneks_Tabela 9).</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/ jashtë auditorit, frekuentimin/ ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Në hartimin e planit mësimor për një vit akademik, që miratohet nga drejtuesi i Departamentit, është bërë ndarja e lëndëve që zhvillohen në dy semestral duke prezantuar dhe ngarkesën për orët që studentët do të zhvillojnë në auditor apo jashtë tij, për nivelin e kërkuar të frekuentimit (të paktën 60%), si dhe mënyra se si do të bëhet kontrolli i dijeve dhe struktura e vlerësimit kur ka mbaruar semestri/ cikli i zhvillimit të lëndës/ modulit. Këto njohuri dhe sqarime u adresohen studentëve nga pedagogët e lëndës para se të fillojë semestri/ cikli. Në takimin me studentët që ndjekin profilet e “Komunikim” në BA ata pranuan se ishte aplikuar kjo mënyrë procedimi për t’u informuar dhe familjarizuar me planin mësimor.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>4. <i>Plani strategjik per zhvillimin e programit te studimit BA Komunikim</i></p> <p>6. <i>Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit.</i></p> <p>7. <i>Rregullore mësimore BA Komunikim.</i></p> <p>14. <i>Kurrikula e programit BA Komunikim.</i></p> <p>46.1 <i>Urdher Mbi zbatimin e platformes LMS.</i></p> <p>46.2 <i>UET LMS - Guide per pedagogun.</i></p> <p>46.3 <i>UET LMS Guide per studentet.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Nga bisedat që GVJ zhvilloi me studentët që ndjekin këtë program studimi të nivelit të parë identifikua se ata kishin marrë informacion të mjaftueshëm në mënyrë paraprake për procedurën e pranimit në universitet (në profilin që ata dëshironin), si dhe për raste të transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Këto janë të standardizuara si në rregulloren e UET, apo dhe në atë të programit të studimit që është në fokus të vlerësimit.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>4. <i>Plani strategjik per zhvillimin e programit te studimit BA Komunikim</i></p> <p>6. <i>Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit.</i></p>

	<p>7. Rregullore mësimore BA Komunikim.  7.2 Sistemi i vlerësimit të studenteve.  14. Kurrikula e programit BA Komunikim.  46.1 Urdher Mbi zbatimin e platformës LMS.  46.2 UET LMS - Guide per pedagogun.  46.3 UET LMS Guide per studentet.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikatat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>GVJ ka shqyrtuar përmbajtjet e syllabus-eve për lëndët të paraqitura nga Departamenti, të cilat pavarësisht nga përmbajtja e tyre e ndryshme (varësisht lëndës apo modulit) janë të strukturuar sipas një formati të ngjashëm për gjithë këtë IAL - ku studentëve u jepet informacion mbi objektivat e lëndës, konceptet themelore, tematikën që do të trajtohet në gjithë periudhën e zhvillimit të lëndës, format e kontrollit të dijeve, strukturimi për vlerësimin e studentit dhe literatura e detyrueshme dhe e rekomanduar. Miratimi përfundimtar për syllabus-et bëhet nga drejtuesi i Departamentit para se të fillojë semestri në konsideratë vërejtje e sugjerime për konceptimin dhe hartimin e tyre.</p> <p><u>Referencë:</u>  14. Kurrikula e programit BA Komunikim.  14.2. Plan i mësimor i programit - BA Komunikim.  19. Silabus Metodat e kerkimit.  19.1 Formati i Syllabusit.  37. Formati i relacionit për monitorimin e silabuseve.  46.1 Urdher Mbi zbatimin e platformës LMS.  46.2 UET LMS - Guide per pedagogun.  46.3 UET LMS Guide per studentet.</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Në prag të fillimit të çdo viti akademik nga njësia bazë diskutohet mbi aspekte potenciale të përmirësimeve në ndërtimin e kurikulës për secilin vit. Sidomos në dy mbledhjet e fundit të vitit akademik që zhvillon. Departamenti është si standard fokusimi tek ndërhyrjet potenciale në kurikula, bazuar në propozimet që bëjnë anëtarët e stafit akademik, si dhe mendimet, sugjerimet dhe propozimet që janë përfutur nga anketimi me studentët. Gjatë takimit me stafin akademik u pranua se rishikimet bazohen dhe në propozimet që merren nga Bordet e Tregut të Punës, në funksion dhe në sinkron me nevojat që ka tregu i punës, për profilet e këtij programi të ciklit të parë. GVJ mori në shqyrtim dhe rast konkret nga dinamika e mbledhjes me bordin e tregut të punës, bazuar në procesverbalin që ju dorëzua nga Departamenti.</p> <p><u>Referencë:</u>  6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit.  7. Rregullore mësimore BA Komunikim.  12. Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj studentit.  12.1 Bordi i Tregut të Punës 2017-2021.  17. Studim i tregut të punës.  32. Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkepunuese per programin e studimit dhe praktikatat profesionale.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				X

<b>Standardi II.4</b>	
<b>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Programi që është në fokus të vlerësimit është i strukturuar me një proporcion ngarkese në tri vitet, me lëndë që kanë 4-6 kredite sipas Sistemit European të Transferimit të Krediteve, ECTS, kurse punimi i diplomës (për studentët me mesatare 8.5 e lart) ose provimi i përgjithshëm ka nivelin më të lartë të krediteve të fituara. Totali i krediteve për të tri vitet e ndjekjes së programit është 180 ECTS. GVJ e gjeti këtë mënyrë organizimi në përputhje me legjislacionin e vendit tonë dhe sipas ECTS.</p> <p><u>Referencë:</u>  3.1 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020.  3.3 PLANI STRATEGJIK UET_2021.  5. Rregullore e UET.  7. Rregullore mësimore BA Komunikim.  54.2 URDHER Nr.528, datë 04.09.2018, Riorganizimin e F. i Shkencave Sociale dhe Edukimit ne F. i Sh. Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>Ndërtimi dhe zbatimi kurikulës së programit studimor “Komunikim” në BA ka një trajektore zhvilluese në mënyrë graduale për njohuritë dhe shprehitë që i ofrohen studentit, përmes lëndëve nga grupi bazik (A), nga ato karakterizuese (B), ndërdisiplinore (C) apo plotësuese (D), si një mundësi për marrjen e njohurive, nxitjen e thellimit në procesin kërkimor dhe shkencor, por dhe të aftësive në përballimin e detyrave nëse ata vendosin që në përfundim të ciklit BA të dalin në tregun e punës, duke u angazhuar në redaksi, institucione të ndryshme, njësi a sipërmarrje etj.</p> <p><u>Referencë:</u>  3.1 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020.  4. Plani strategjik per zhvillimin e programit te studimit BA Komunikim.  5. Rregullore e UET.  7. Rregullore mësimore BA Komunikim.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Ndarja e lëndëve në tri vitet akademike vlerësohet nga GVJ si një ndarje logjike e lëndëve dhe moduleve duke harmonizuar marrjen e dijeve dhe nxitjen e kërkimit shkencor me fitimin e shprehive praktike nga ana e studentëve sipas profilit që ata kanë zgjedhur. Edhe pesha që ka në kredite secila prej lëndëve shkon proporcionalisht me vendin që zënë njohuritë në të gjithë spektrin e njohurive që do të duhet të asimilojë dhe konsultohet ndjekësi i programit në arritjen e pritmërive dhe ambicieve për më tej – qoftë në angazhimin në tregun e punës, direk pas përfundimit të ciklit BA, ose për të vijuar studimet e thelluara në ciklin e dytë (Master), apo në ciklin e tretë (Doktoraturë).</p> <p><u>Referencë:</u>  3.1 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020.  3.3 PLANI STRATEGJIK UET_2021.  7. Rregullore mësimore BA Komunikim.  7.2 Sistemi i vlerësimit te studenteve.  7 Stafit akademik _y.a.2021-2022. (dokumentet shtesë)</p>

	<p>14.3. Të dhënat për stafin akademik të angazhuar në programin e studimit 2021-2022. (dokumentet shtesë)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Për GVJ strukturimi i programit në tri vitet e programit, lëndët që janë përfshirë dhe emërtimi janë në përputhje me natyrën e një programi të ciklit të pare, duke ruajtur raport të drejtë për pjesën e trajtimit dhe kërkimit teorik shkencor me aftësimin për shprehje aplikative. Po ashtu ngarkesa e lëndëve në kredite shkon në mënyrë proporcionale, me lëndë që kanë 4-6 kredite ECTS, kurse punimi i diplomës ose provimi i përgjithshëm ka nivelin më të lartë të krediteve të fituara. Totali i krediteve për të tre vitet e ndjekjes së programit është 180 ECTS.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>3.1 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020. 3.3 PLANI STRATEGJIK UET 2021. 5. Rregullore e UET. 7. Rregullore mësimore BA Komunikim. 54.2 URDHER Nr.528, datë 04.09.2018, Riorganizimin e F. i Shkencave Sociale dhe Edukimit në F. i Sh. Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Perspektiva për një student që ndjek “Komunikim” në BA është që në finalizim të tri viteve ose të dalë në tregun e punës, ose të vijojë studimet më të thelluara në ciklin e dytë, (Master), si dhe për më tej për në ciklin e tretë (studimet doktorale). Studentët gëzojnë të drejtën sikundër dhe studentët që janë në degët e tjera në këtë IAL, që në përputhje me parimet e Kartës së Bolonjës, të jenë pjesë e proceseve të transferimeve për/ nga shkollat e tjera universitare, vendase ose të huaja, publike ose jopublike. GVJ u njoh me procedurat për rastet e kërkesave për transferim, nga akti i shprehjes së interesit (me shkrim) nga studenti, deri tek pjesa e lëndëve që njihen për vijimësinë. Në rregulloret që janë në fuqi, saktësohet se procesi i transferimit realizohet vetëm në periudhën e fillimit të vitit akademik.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>4. Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit BA Komunikim. 7. Rregullore mësimore BA Komunikim. 14. Kurrikula e programit BA Komunikim. 14.2. Plani mësimor i programit - BA Komunikim. 14.3. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - BA Komunikim (Aneks Tabela 9). 7 Stafit akademik _y.a.2021-2022. (dokumentet shtesë) 14.3. Të dhënat për stafin akademik të angazhuar në programin e studimit 2021-2022. (dokumentet shtesë)</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Procesi i dorëzimit të syllabus-eve nga pedagogët e lëndëve dhe moduleve në të tri vitet e studimit përfshin dhe përtëritjen e tyre qoftë në përfshirjen e literaturës së detyruar ashtu dhe atë ndihmëse, duke rekomanduar për studentin publikime nga më të fundit, në kufijtë e 5-8 viteve të fundit. Për lëndë të veçanta, kur ky afat limit nuk kapet, nga pedagogu jepej shpjegime të drejtuesi i Departamentit dhe koordinatori i programit për shkaqe të përdorimit të literaturës pa u aktualizuar në kohë. Gjatë bisedës me stafin akademik të angazhuar u vlerësua si mbështetëse dhe ndikimi i UET PRESS në publikimin periodik të përkthimeve nga autorë të njohur</p>

	<p>që lidhen fushën e programit “Komunikim” në BA, apo dhe në programe të tjera që menaxhohen nga njësia bazë.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>3.1 <i>Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020.</i></p> <p>3.3 <i>PLANI STRATEGJIK_UET_2021.</i></p> <p>19. <i>Silabus Metodat e kerkimit.</i></p> <p>19.1 <i>Formati i syllabusit.</i></p> <p>37. <i>Formati i relacionit për monitorimin e silabuseve.</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>GVJ duke shqyrtuar dokumentacionin që iu vu në dispozicion nga njësia bazë dhe struktura të tjera në UET, si dhe nga takimet që zhvilloi drejtpërdrejt gjatë vizitës në këtë IAL krijoi bindjen se programi i studimit në fokus të vlerësimit është një ofertë e konsoliduar për studentët që e ndjekin. Një ofertë që ju jep një shtrojë teorike dhe shprehi praktike për të mundësuar daljen në tregun e punës, si dhe për të pasur mundësi që të vijojnë studimet e thelluara në ciklin e dytë ose të tretë – qoftë në profilet që ata kanë zgjedhur, apo në ato të ngjashme - sipas preference dhe ambicies në karrierë.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>3.1 <i>Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020.</i></p> <p>3.3 <i>PLANI STRATEGJIK_UET_2021.</i></p> <p>6. <i>Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit.</i></p> <p>7. <i>Rregullore mësimore BA Komunikim.</i></p> <p>12. <i>Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.</i></p> <p>14. <i>Kurrikula e programit BA Komunikim.</i></p> <p>14.2. <i>Plani mësimor i programit - BA Komunikim.</i></p> <p>14.3. <i>Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - BA Komunikim (Aneks Tabela 9).</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Bazuar në përmbajtjen e kurikulës së programit të studimit “Komunikim” në BA, njohurive dhe shprehive aplikative që përfiton studenti që e kryen të plotë këtë cikël të parë studimi, mund të përfshihet në angazhime të tilla si gazetar a redaktor në njësi të ndryshme të tregut mediatik, klasik apo online; këshilltar apo drejtues për komunikimin në institucione publike, subjekte private, rrjetin e shoqërisë civile apo formacionet politike; ekspert për marrëdhëniet publike ose për komunikimet digjitale; organizator (animator) etj. Tri vitet e studimit në këtë program janë për një pjesë e studentëve edhe premise për të vijuar më tej ma marrjen e njohurive më të thelluara duke ndjekur ciklin e dytë të studimeve në Master, ndërkohë që për ata që janë me rezultate të larta si dhe me ambicie të përfshirjes në proces kërkimor e shkencor dhe për të qenë proaktiv në jetën akademike, zgjohet objektivi për kryerje të ciklit të tretë në studimet doktorale.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>3.1 <i>Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020.</i></p> <p>3.3 <i>PLANI STRATEGJIK_UET_2021.</i></p> <p>6. <i>Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit.</i></p> <p>7. <i>Rregullore mësimore BA Komunikim.</i></p> <p>12. <i>Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.</i></p> <p>14. <i>Kurrikula e programit BA Komunikim.</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 24



	<p>14.2. Plani mësimor i programit - BA Komunikim.  14.3. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - BA Komunikim (Aneks_Tabela 9).  17. Studim i tregut të punës.</p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Nga informacioni që morëm në njësinë bazë që menaxhon këtë program studimi dhe nga materiali që kemi shqyrtuar GVJ ka indentifikuar se për shkak të masave dhe protokolleve antiCovid, në dy vitet e fundit akademike nuk ka pasur mbledhje të Bordit të Punës. Ka pasur kontakte virtuale me përfaqësues të tyre, ka pasur konsultime për aspekte specifike, por këto kanë qenë jo në periodicitetin dhe formatin standard çdo gjashtë muaj. Ka pasur rikthim të mbledhjet “in person” në mars të këtij viti (2022), duke rikthyer dhe sinergjinë mes Departamentit dhe Bordit të Tregut të Punës, ku fokusi kryesor është shkëmbimi i mendimeve e sugjerimeve për orientimin e kërkesave të tregut. Kjo çmohet nga njësinë bazë, si një nevojë e përmirësimeve dhe përshtatjes së kurikulës së programit të studimit në kolona të njohurive dhe shprehive aplikative të sinkronuara me nevojat e tregut, për të mundësuar sa më shumë hapësira integruese të studentëve kur ata finalizojnë ciklin a parë apo ciklet e mëtejshme studimore në degën e profilit e zgjedhur.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>3.1 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020.  3.3 PLANI STRATEGJIK UET 2021.  6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit.  7. Rregullore mësimore BA Komunikim.  12. Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.  14. Kurrikula e programit BA Komunikim.  14.2. Plani mësimor i programit - BA Komunikim.  14.3. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - BA Komunikim (Aneks_Tabela 9).  17. Studim i tregut të punës.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				X

<p><b>Standardi II.5 Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Siç është përmendur dhe në vlerësimin e kriterëve me lart, Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit, si njësinë bazë përgjegjëse për këtë program studimi, ka të angazhuar në këtë vit akademik (2021-2022) 11 pedagogë (10 PAE dhe 1 PAK). Më shumë se gjysma e tyre kanë tituj dhe grada shkencore: 1 është Prof. Assoc.Dr; 5 janë me gradën Doktor (4 PAE dhe 1 PAK); dhe 5 janë Msc. (të gjithë PAE). Njësinë bazë i përmbush detyrimet për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik të përfshirë. Duke shikuar gjendjen për 3 vitet e fundit (2019-2020; 2020-2021 dhe viti akademik korrent 2021-2022) vihet re se niveli i kualifikimit</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë


E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 25

	<p>ka rënie. Në vitin akademik 2019-2020 ka pasur të angazhuar në Departamentin e Shkencave Humane dhe Komunikimit më shumë pedagogë me kohë të plotë (12) dhe po kështu kanë qenë dhe me kohë të pjesshme (13). Ishin më shumë dhe me tituj dhe grada shkencore (1 Prof.Dr (PAE); 5 Prof.Assoc.Dr (3 PAE dhe 2 PAK); 12 me gradën Doktor 12 (4 PAE dhe 8 PAK); si dhe Msc. 7 (4 PAE dhe 3 PAK). Vitin pasardhës akademik (2020-2021) ka ndodhur rënia në nivelin e kualifikimit të personelit akademik të angazhuar në Department, nivel i ngjashëm me këtë vit alademik që është vijues (2021-2022).</p> <p>Ndërsa stafi akademik në total, që është angazhuar aktualisht në këtë program studimi është 30, nga të cilët 26 janë PAE dhe 4 janë PAK. Duke pasur parasysh kualifikimin e tyre akademik, me titullin Prof. Dr. është 1 (PAE); Prof.Assoc.Dr është 1 (PAE); me gradën Doktor janë 9 (7 PAE dhe 2 PAK); Doktoraturë në proces po kryen një pedagog (PAE) dhe Msc janë 18, nga të cilët 16 (PAE) dhe 2 (PAK). Stafi akademik në total i angazhuar për “Komunikim” në BA përmbush kërkesat ligjore në fuqi.</p> <p><u>Referencë:</u>  3.1 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020.  3.3 PLANI STRATEGJIK UET_2021.  5. Rregullore e UET.  7. Rregullore mësimore BA Komunikim.  7 Stafi akademik_v.a.2021-2022. (dokumentet shtesë)  14.3. Të dhënat për stafin akademik të angazhuar në programin e studimit 2021-2022.(dokumentet shtesë)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Nisur nga dokumentacioni që ka pasur në dipsozicion GVJ evidentohet se njësia bazë ku përfshihet ky program studimi, për këtë vit akademik ka të angazhuar 11 pedagogë (10 PAE dhe 1 PAK). Referuar angazhimit konkret që ata kanë në zhvillimin e kurikulës evidentohet se pedagogët me tituj dhe grada (1 është me titullin Prof. Assoc.Dr dhe 5 janë me gradën Doktor) janë më shumë nga pikëpamja sasiore, por dhe përballojnë ngarkesën më të madhe gjatë zhvillimit të moduleve të programit. Evidentohet dhe sinkroni mes fushës së kualifikimit që ka secili prej personelit akademik me natyrën e lëndës ku është përfshirë.</p> <p>Ngarkesa mësimore që përballon personeli me kohë të plotë është mbi 70% e ngarkesës totale, duke plotësuar detyrimin në ndarjen e ngarkesës mes PAE dhe PAK. Konkretisht bazuar në dokumentacionin që iu paraqit GVJ rezulton se në vitin akademik 2019 – 2020 ndarja e ngarkesës mësimore ishte PAE me 83.2% dhe PAK 16.8%. Për vitin akademik 2020-2021 ngarkesa mësimore për PAE ishte 93.8% ndërkohë që për PAK ishte 6.2%. Për këtë vit vijues akademik (2021-2022) raporti në përqindje i ngarkesës është PAE 91.9% dhe PAK 8.1%.</p> <p>Nga shqyrtimi i ndarjes së lëndëve në zhvillimin e kurikulës së këtij programi studimi u identifikua përmbushja detyrimin që pedagogët e</p>



	<p>përfshirë (me kohë të plotë dhe ata me kontratë) të kenë të kryer kualifikimin e ciklit pasardhës.</p> <p><u>Referencë:</u>  7 Stafit akademik_v.a.2021-2022. (dokumentet shtesë)  14.3. Të dhënat për stafin akademik të angazhuar në programin e studimit 2021-2022.(dokumentet shtesë)  0.2. Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB - Bachelor Komunikim. Tabelat 12.1, 12.2, 12.3, 12.4</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike- kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Duke shqyrtuar procesin e ndarjes së lëndëve që zhvillohen në këtë program studimi në raport me natyrën dhe shkallën e nivelit të kualifikimit faktik kërkimor dhe shkencor të personelit akademik të përfshirë GVJ konstatoi sinkroni në përzgjedhje. Përputhja e fushës ku është fokusuar pedagogu me natyrën dhe specifikat e lëndës që i është ngarkuar për të drejtuar ka qenë dhe mbetet një sfidë për njësinë bazë në bashkëpunim me drejtuesit e Fakultetit apo të IAL-së. Departamenti ka një rol kyç në rekrutimin e personelit akademik, duke pasur parasysh në mënyrë prioritare sinkroninë e natyrës së lëndës me fushën e kërkimit ku është investuar faktikisht pedagogu, ndërkohë që kjo mbahet parasysh dhe në procesin e vlerësimit periodik që kryen Departamenti mbi cilësinë e angazhimit të pedagogut gjatë vitit akademik. Kjo vlen dhe për procesin e mbështetjes që IAL dhe Departamenti japin në kualifikimin e mëtejshëm të personelit akademik të përfshirë në këtë program studimi.</p> <p><u>Referencë:</u>  3.1 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020.  3.3 PLANI STRATEGJIK_UET_2021.  4 Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit BA Komunikim.  5. Rregullore e UET.  7 Stafit akademik_v.a.2021-2022.(dokumentet shtesë)  14.3. Të dhënat për stafin akademik të angazhuar në programin e studimit 2021-2022.(dokumentet shtesë)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Për kryerjen e praktikave profesionale nga ana e studentëve që ndjekin këtë program studimi Departamenti ka krijuar një vijimësi komunikimi dhe bashkëpunimi me institucioneve partnere që operojnë në fushat që lidhen orientimin e profileve të programit “Komunikim”, duke siguruar dy formate aktivizimi: së pari duke atashuar studentët në mjediset e partnerëve për kryerjen e praktikave; së dyti duke ftuar në auditorët e UET ekspertë në trajtimin e temave a aspekteve, për të cilat ata shprehin interes. Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione ose kompani të ndryshme tentohet që të zgjerohen vit pas viti, duke u orientuar tek partnerë që janë më afër qëllimit dhe objektivave që ka program i studimit. Pas relaksimit të masave dhe protokolleve antiCovid-19 drejtues të njësisë bazë shpresojnë në rikthimin e intensitetit të bashkëpunimit me partnerët private, si në periudhën para pandemisë. Për planifikimin dhe ndjekjen e të ftuarve në auditor, gjykohet duke u nisur nga interesimi që shprehin studentët e përfshirë në programin e studimit.</p> <p><u>Referencë:</u>  3.1 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020.  3.3 PLANI STRATEGJIK_UET_2021.  5. Rregullore e UET.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit” , Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 27

	<p>7. Rregullore mësimore BA Komunikim.</p> <p>12. Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj studentit.</p> <p>14.3. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - BA Komunikim (Aneks_Tabela 9).</p> <p>30.1. Plani veprimt KSBC.pdf</p> <p>30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p> <p>30.3 Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p> <p>30.4. Urdhër administrativ mbi përbërjen e KSBC.pdf</p> <p>30.5 Metodologjia e punës së KSBC provimet.</p> <p>32. Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkepunuese për programin e studimit dhe praktikën profesionale.</p> <p>32.1 Mbi praktikën profesionale.</p> <p>Evidenca 7 (dokumentet shtesë)</p> <p>Evidenca 14.3 (dokumentet shtesë)</p>
--	---

**Kriteri 5.** Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.

Në procesin e kryerjes së studimeve në programin “Komunikim” studentët e katër profileve kanë në dispozicion dhe mjedise ku fitojnë ose konsolidojnë shprehuri praktike, si sendërtim për njohuri teorike që diskutojnë dhe trajtojnë në orët e leksioneve a seminareve. Një prej tyre është Media Lab, një infrastrukture në dispozicion të njësisë bazë që menaxhon këtë program studimi. GVJ u njoh dhe me aktivitetin e klubit studentor “McLuhan”, ku vetëm gjatë këtij viti kishte pasur të ftuar disa gazetarë dhe ekspertë të komunikimit, për të ndarë me studentët tema dhe aspekte që kanë interes për ta. Në dy vitet e fundit akademike ka pasur një lloj kufizimi në përdorimin e mjediseve të tilla, si përshtatje për masat e protokollit të vendosura nga autoriteti publik shëndetësor në kuadër të parandalimit të pandemisë Covid-19.

Referencë:

7. Rregullore mësimore BA Komunikim.

12.1 Bordi i Tregut të Punës 2017-2021.

14.3. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - BA Komunikim (Aneks\_Tabela 9).

17. Studim i tregut të punës.

32. Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkepunuese për programin e studimit dhe praktikën profesionale.

32.1 Mbi praktikën profesionale.

32.2 Formulari i vetvlerësimit të praktikës (nga studenti).

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>UET ka përgatitur dhe miratuar një sërë aktesh dhe rregulloresh në funksion të garantimit dhe promovimit të cilësisë në mësimdhënie, duke aplikuar dhe forma të monitorimit dhe vlerësimit të saj. Zgjerimi i infrastrukturës me departamente dhe programe të reja studimi në dy ciklet, por dhe fluksi personelit akademik (me kohë të plotë dhe të pjesshme) si dhe personalit mbështetës – kanë nxjerrë në pah nevojën periodike për trajnime të këtyre burimeve njerëzore të angazhuara në IAL. Ndër fokuset prioritare është përdorimi i metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve. Konceptimi dhe hartimi i syllabus-eve për lëndët/ modulet, si dhe metodologjia e mësimdhënies dhe trajtimit të programit, format e interaktivitetit në auditor, vlerësimi për njohuritë teorike dhe shprehitë aplikative etj., janë ndër aspektet kryesore në procesin e kualifikimit të personelit akademik.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>4. <i>Plani strategjik per zhvillimin e programit te studimit BA Komunikim.</i>  7. <i>Rregullore mësimore BA Komunikim.</i>  19. <i>Silabus Metodat e kerkimit.pdf</i>  19.1 <i>Formati i silabusit.pdf</i>  30.1. <i>Plani veprimit KSBC.</i>  30.5 <i>Metodologjia e punes se KSBC provimet.</i>  37. <i>Formati i relacionit për monitorimin e silabuseve.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Njësia bazë që menaxhon programin e studimit është një nga hallkat kyçe në procesin e monitorimit dhe vlerësimit të herëpashershëm të nivelit të aftësitë mësimdhënëse dhe inovative nga ana e personelit akademik dhe atij ndihmës. Monitorim dhe vlerësim bëhet dhe në nivel fakulteti. Studentët që përfshihen në tri vitet e studimit japin mendime dhe sugjerime për mësimdhënien në përfundim të çdo semestri, përmes mekanizmit të fokus grupeve që realizohen duke ruajtur anonimat. Po ashtu dhe angazhimi i Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, KSBC, që kryen periodikisht monitorime dhe vlerësime, mbi bazën e të cilave lëshon rekomandime të ndryshme, si dhe raporton në instancat drejtuese të IAL-së.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>4. <i>Plani strategjik per zhvillimin e programit te studimit BA Komunikim.</i>  7. <i>Rregullore mësimore BA Komunikim.</i>  30.1. <i>Plani veprimit KSBC.pdf</i>  30.2. <i>Mamuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë.</i>  30.3 <i>Strategjia per sigurimin e brendshem te cilesise.</i>  30.7 <i>Shperndarja e relacionit te KSBC mbi silabuset.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e</p>	<p>E përmendur dhe në kriterin më sipër, studentët janë një nga aktorët influencues për vlerësimin e procesit të mësimdhënies, si dhe vlerësimin e dijeve teorike e shprehive aplikative që fitojnë në kohë e zhvillimit të</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al



Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 29

<p>metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>programit. Vlerësimet që bëjnë studentët, në mënyrë sistematike, në fund të semestrit, kur kanë trajtuar temat e lëndës, ndihmojnë në përmirësimin e metodave të mësimdhënies në vijim. Marrja e mendimeve prej tyre siguron anonimitetin, për të krijuar besim dhe lirishtetëri në të shprehur. Gjatë bisedës me studentët e programit “Komunikim” në BA u informuam dhe për aksesin që ata kanë në çdo periudhë të vitit akademik për të adresuar mendime dhe sugjerime për ecurinë e programit, apo për ankesa të cilat mund t’ja drejtojnë Departamentit, Fakultetit apo strukturave drejtuese dhe monitoruese në UET. Për problematika që duan zgjidhje ata drejtohen dhe në Zyrën e Kujdesit ndaj Studentit.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>4. Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit BA Komunikim. 7. Rregullore mësimore BA Komunikim. 12. Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj studentit. 40. Format i vlerësimit të pedagogut nga studentët. 40.1 Formular për ankesat e studenteve. 41. Formular i vetvlerësimit të performancës së personelit akademik.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Të dhënat e përfuara nga anketimi i studentëve administrohen nga Komisioni për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë KSBC dhe zyra e IT-së që menaxhon sistemin virtual LMS. Gjetjet konkrete përcillen dhe në strukturat drejtuese të IAL-së, por dhe në njësinë bazë, mbi bazën e të cilave analizohet ecuria, por dhe piketohen masa për të ndërhyrë në përmirësimin konkret të gjendjes.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>4. Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit BA Komunikim. 30.5 Metodologjia e punës së KSBC provimet. 30.7 Shpërndarja e relacionit të KSBC mbi silabuset. 40. Format i vlerësimit të pedagogut nga studentët. 40.1 Formular për ankesat e studenteve.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Siç është shpjeguar dhe në kriterin e mësipërm, gjetjet konkrete nga anketimi virtual me studentët, apo dhe monitorimet dhe analizat që realizon KSBC – janë si lëndë e parë për të ndërhyrë në përmirësimin konkret të gjendjes. Nga ana tjetër dhe për të promovuar raste pozitive, që kthehen në standard dhe për ecurinë në lëndë të ndryshme.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>4. Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit BA Komunikim. 30.5 Metodologjia e punës së KSBC provimet. 30.7 Shpërndarja e relacionit të KSBC mbi silabuset. 40. Format i vlerësimit të pedagogut nga studentët. 40.1 Formular për ankesat e studenteve.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

**Standardi III.2**  
**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Gjatë tri viteve që zhvillohet programi i studimit “Komunikim” në BA, ofrohet një paketë lëndësh që ka përmbajtje të ndryshme dhe po ashtu mënyra të ndryshme realizimi nga pedagogu. Por bazuar në aktet rregullative të miratuara në rang IAL-je, fakulteti, apo dhe njësie bazë ekzistojnë forma të mësimdhënies dhe mësimnxënies që hasen tek të gjitha lëndët, si leksionet, seminarët, detyrat e kursit, praktikat profesionale apo realizimi i orëve të hapura me ekspertë të ftuar në auditor. Pësha specifike që secila prej këtyre formave, varet nga mënyra e konceptimit dhe trajtimit të tematikës nga pedagogu, por e rëndësishme është njësia bazë, apo strukturat monitoruese në rang fakulteti e IAL-je bëjnë vlerësime periodike për transmetimit e njohurive teorike e shprehive aplikative tek studentët, duke verifikuar dhe zbatimin e akteve rregullative që janë miratuar.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>7. Rregullore mësimore BA Komunikim.  14. Kurrikula e programit BA Komunikim.  14.2. Plani mësimor i programit - BA Komunikim.  14.3. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - BA Komunikim (Aneks Tabela 9).  26. Të dhëna për numrin e programeve që ofrohen nga njësia përgjegjëse Tab 3.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t’u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Gjatë takimit të GVJ me stafin akademik që është përfshirë në këtë program studimi u evidentua dhe fakti se studentët kanë nivele të ndryshme të formimit të tyre (nga rezultati që kanë pasur në ciklin e arsimit parauniversitar) por dhe kanë ambicie dhe pritmëri të ndryshme për njohuritë teorike dhe shprehite aplikative që do të asimilojnë në nivelin BA për “Komunikim”. Kjo larmi e nivelit të kapacitetit, por dhe e grindit që reflekton grupi i studentëve që ndjek programin është premisë për perspektivën e vijueshmërisë në studimet në ciklet e tjera. Këtë diversitet të bagazhit apo pritmërive ka parasysh personeli akademik i angazhuar në ofertën e mësimdhënies, duke përdorur metoda alternative të prezantimit dhe trajtimit të tematikës, bazuar dhe në natyrën që kanë profilet e programit apo dhe zhvillimin e moduleve e aktiviteteve formuese të planifikuara në kurrikul.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit.  7. Rregullore mësimore BA Komunikim.  30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë.  40. Format i vlerësimit të pedagogut nga studentët.  40.1 Formular për ankesat e studenteve.  41. Formular i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të</p>	<p>Një pjesë e stafit akademik që përfshihet në këtë program studimi ka pasur eksperiencë të mëparshme të kryerjes së studimeve jashtë vendit, apo dhe pjesëmarrje në programe të shkëmbimit akademik. Përvoja e fituar prej tyre transmetohet në auditorët e UET, si dhe vihet në qendër të diskutimit mes kolegëve në mbledhjet analitike që organizon</p>

<p>shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxëniet, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Departamenti. Ndikim në përmirësimin e kompetencave didaktike ka dhe procesi trajnuar bazuar në nivelin e kualifikimit që ka arritur pedagogu (doktorant, apo doktor shkencash), ku trajtohen aspekte që lidhen direkt ose indirekt me mësimdhënien, mësimdhënien, qasjen në kërkimin shkencor etj.</p> <p><u>Referencë:</u>  2. Statuti i UET.  4 Plani strategjik per zhvillimin e programit te studimit BA Komunikim.  5. Rregullore e UET.  7. Rregullore mësimore BA Komunikim.  40. Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët.  40.1 Formular per ankesat e studenteve.  41. Formular i vetevlerësimit te performancës së personelit akademik.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Që nga krijimi i njësisë bazë duket se ka një standardizim në rekrutimin e personelit akademik dhe atij mbështetës në funksion të zhvillimit të programeve të studimit të akredituara. Kështu ka funksionuar dhe me programin “Komunikim” në BA, duke ndërtuar një potencial të burimeve njerëzore që reflekton kompetencë didaktike në transmetimin e njohurive teorike dhe shprehive aplikative duke iu referuar formave tërheqëse të mësimdhënies dhe nxitjes së interaktivitetit gjatë seancave në auditor.</p> <p><u>Referencë:</u>  2. Statuti i UET.  4 Plani strategjik per zhvillimin e programit te studimit BA Komunikim.  5. Rregullore e UET.  7. Rregullore mësimore BA Komunikim.  41. Formular i vetevlerësimit te performancës së personelit akademik.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur, por dhe bisedat që u realizuan në UET me studentët apo me personelin akademik të angazhuar, u identifikua se dy here brenda vitit akademik (në fund të çdo semestri) realizohen duke ruajtur anonimatit anketime virtuale me studentët. Ku përbën një burim konstant për Departamentin dhe strukturat e tjera në IAL-së për reflektimin e sugjerimeve dhe propozimeve potenciale nga ana e studentëve që ndjekin programin e studimit. Burim tjetër janë dhe propozimet që bëhen nga studentët në mbledhjet e hapura të Departamentit, ashtu si dhe trajtimi i ankesave të ndryshme që ata adresojnë nga dinamika e zhvillimit të kurikulës së programit, si dhe të vlerësimeve që kanë marrë nga pedagogët.</p> <p><u>Referencë:</u>  7. Rregullore mësimore BA Komunikim.  30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë.  40. Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët.  40.1 Formular per ankesat e studenteve.  41. Formular i vetevlerësimit te performancës së personelit akademik.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	<p>Siç është përmendur në kriteret e mësipërme, në programin që është në fokus të këtij vlerësimi aplikohen forma të ndryshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies që hasen tek të gjitha lëndët, si leksionet, seminarët, detyrat e kursit, praktikat profesionale apo realizimi i orëve të hapura me ekspertë të ftuar në auditor. Përsa specifikë që secila prej këtyre formave,</p>



	<p>varet nga mënyra e konceptimit dhe trajtimit të tematikës nga pedagogu, por e rëndësishme është njësia bazë, apo strukturat monitoruese në rang fakulteti e IAL-je bëjnë vlerësime periodike për transmetimit e njohurive teorike e shprehive aplikative tek studentët, duke verifikuar dhe zbatimin e akteve rregullative që janë miratuar.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>2. Statuti i UET.</p> <p>7. Rregullore mësimore BA Komunikim.</p> <p>30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p> <p>37. Formati i relacionit për monitorimin e silabuseve</p> <p>40. Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët.</p> <p>40.1 Formular per ankesat e studenteve.</p> <p>41. Formular i vetevlerësimit te performancës së personelit akademik.</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Komunikimi student – personel akademik reflekton një raport bashkëpunues, ku student orientohet në studimin e një pakete temash e nëntemash që janë pjesë trajtimeve teorike apo shprehive aplikative, përmes të cilave krijohet dhe një shtrojë njohurish bazike e domosdoshme. Nga ana tjetër pedagogu lëndës nxit punën e pavarur të studentit në ofrimin e një spektri dijesh, mes të cilave ai zgjedh pjesët më tërheqëse apo që gjykohen më të dobishme për t'u thelluar. Respektimi i autonomisë për studentin bazohet te respekti i ndërsjellë me pedagogun, në favor të formimit të lirë të ideve dhe pikëpamjeve për çështjet që trajtohen në lëndën që zhvillohet, ndikon në fillimin e krijimit të personalitetit kërkimor dhe studimor të tij.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>7. Rregullore mësimore BA Komunikim.</p> <p>30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p> <p>37. Formati i relacionit për monitorimin e silabuseve</p> <p>40. Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët.</p> <p>40.1 Formular per ankesat e studenteve.</p> <p>41. Formular i vetevlerësimit te performancës së personelit akademik.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

**Standardi III.3**

**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Në kuadër të vizitës në UET, GVJ kaloi dhe në mjediset universitare ku zhvillohen programet e studimit, duke përfshirë dhe mjediset ku është përqendruar më shumë dinamika e kurikulës së “Komunikim” në BA. Kjo IAL ka lëvizur në mjediset të reja në dy vitet e fundit, lëvizje që nuk është ndjerë në pikëpamjen e zhvendosjes së infrastrukturës fizike e didaktike në dispozicion ngaqë momenti i kalimit nga një kohë që pjesa më e madhe e aktivitetit zhvillohej virtualisht. GVJ krijoi mendimin se hapësira universitare është e përshtatshme, mirëmbahet dhe mbi të gjitha është në</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 33

	<p>funksion të studentëve, personelit akademik, personelit mbështetës, si dhe strukturave të tjera administrative e menaxheriale që kontribuojnë.</p> <p><u>Referencë:</u>  5. Rregullore e UET.  7. Rregullore mësimore BA Komunikim.  42. Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programeve të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Sallat në dimensione të ndryshme, të vogla, të mesme dhe të mëdha, janë përshtatur për zhvillimin e orëve të leksioneve, seminareve, mësimëve të hapura, konsultimeve në formate të ndryshme, panele forumesh etj., gjithashtu ka dhe mjedise për zhvillimin e laboratorëve, praktikumeve, mjedise me infrastrukture (rrjet) virtual, si dhe holl-e të adaptueshme në arredim për formate të larmishme eventesh. Sistemi kondicionimit, ndriçimit dhe mbulimi me wireless është komfort për studentët, pedagogët, për punonjësit e administratës etj. Në mjediset ku zhvillohen leksionet janë të instaluar sisteme të fonisë, por dhe projektorë të lidhur në kompjuter si lehtësi për prezantime në forma të shumëllojshme didaktike për auditorin.</p> <p><u>Referencë:</u>  5. Rregullore e UET.  7. Rregullore mësimore BA Komunikim.  42. Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programeve të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Pajisjet kompjuterike dhe mbulimi i hapësirës me wireless janë të dobishme që para, gjatë ose pas seancave të mësimit studentët, pedagogët apo punonjësit e tjerë të administratës të punohet në mënyrë të pavarur (komunikim virtual, realizim detyrash, kërkim etj.). GVJ evidentoi se mjaft student a pedagogë përdornin pajisjet e tyre personale për të punuar, duke shfrytëzuar mbulimin me wireless. Stafi IT, është njësia që mbulon mbarëvajtjen e përdorimit të infrastrukturës kompjuterike, të instalimit të programeve dhe aplikacioneve, përshtatjen e tyre me nevojat që ka stafi akademik, studentët apo administrata. Studentët marrin njoftime, rezultate provimesh, vlerësime për detyrat, rekomandime për literaturë të detyruar apo alternative në mënyrë të personalizuar virtualisht. Kjo shërben për mbarëvajtjen e procesit mësimor në programet e ndryshme të studimit.</p> <p><u>Referencë:</u>  5. Rregullore e UET.  7. Rregullore mësimore BA Komunikim.  42. Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programeve të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Një pjesë e rëndësishme e syllabus-eve që ju shpërndahen studentëve në hard copy dhe soft copy (kjo e dyta përmes sistemit të komunikimit të personalizuar LMS), është dhe literature bazë e ajo ndihmëse që nevojitet gjatë kohës që do të zhvillohet lënda. Për literaturën studentët marrin informacion dhe sqarime specifike edhe në javën e parë të fillimit të semestrit, por kur është e nevojshme dhe gjatë javëve vijuese, në konsultim me pedagogun titullar. Me këtë informacion studenti krijon paraprakisht ide për atë që duhet të studiojë, por dhe procesin e kërkimit të literaturës virtualisht apo kopje fizike.</p>

	<p><u>Referencë:</u></p> <p>7. Rregullore mësimore BA Komunikim.  14. Kurrikula e programit BA Komunikim.  14.2. Plani mësimor i programit - BA Komunikim.  14.3. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - BA Komunikim (Aneks Tabela 9).  19. Silabus Metodat e kerkimit.  19.1 Format i Syllabusit.  37. Format i relacionit për monitorimin e silabuseve  42. Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programeve të studimit.  46.1 Urdher Mbi zbatimin e platformes LMS.  46.2 UET LMS - Guide per pedagogun.  46.3 UET LMS Guide per studentet.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Nga 1774 tituj nga shkencat humane dhe komunikimi, që disponon biblioteka e IAL-së, rreth 10% e tyre janë gjuhë të huaj, pjesa tjetër është në shqip. Për programin që po vlerësohet, ka literaturë të përkthyer në shqip, por pavarësisht ndikimit dhe rolit të UET PRESS sërish ka nevoja për publikime përkthimesh, sidomos tituj nga vitet e fundit. Biblioteka e UET shfrytëzon dhe shërbimin virtual të publikimeve, që janë pjesë e katalogut me tituj për të cilat ka të drejtë qarkullimi. Një pjesë tjetër arrihet përmes mekanizmave të shkëmbim- huazimit me biblioteka partnere të institucioneve universitare nga vende të tjera.</p> <p>Biblioteka e UET ka një hapësirë prej rreth 300 m2, me 150 vende uljeje, ku funksionon një rrjet kompjuterik (12 PC) përmes të cilit vizitorët (studentë e pedagogë) kërkojnë apo përdorin përmbajtjet që janë në disponim.</p> <p>Në ditë jave Biblioteka funksionon në dy turne (09:00-20:00), të shtunë (09:00-17:00) dhe të dielën pushim. Në periudhën e sezonit të provimeve orari është pak më i zgjatur se në një ditë jave të zakonshme, në varësi dhe të fluksit të kërkesave dhe prezencës së vizitorëve në mjediset e Bibliotekës. Gjatë takimit me studentët u konfirmua koha e funksionimit në periudha normale dhe në javët e sezonit të provimeve.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>5. Rregullore e UET.  42. Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programeve të studimit.  45. Inventari i teksteve ne Bibilotekë për fushën e programit të studimit BA.  45.1. Mbi funksionimin e Bibliotekës.  45.2. Formular per pasurimin e literatures ne biblioteke.  45.3. Shembull procedure blerje literature.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Sic u shpjegua më sipër biblioteka në UET shfrytëzon shërbimin virtual të publikimeve, që janë pjesë e katalogut me tituj për të cilat ka të drejtë qarkullimi, ndërkohë që një pjesë tjetër arrihet përmes mekanizmave të shkëmbim-huazimit me biblioteka partnere të institucioneve universitare nga vende të tjera.</p> <p>Biblioteka përfiton nga programi COBISS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online), me bazë në Slloveni, që garanton të dhëna bibliografike (ose modulën e katalogimit) duke ju dhënë akses</p>

	<p>studentëve dhe pedagogëve për të gjetur literaturë të fushës së kërkimit ku investohen.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>5. Rregullore e UET.</p> <p>42. Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programeve të studimit.</p> <p>45. Inventari i teksteve në Bibliotekë për fushën e programit të studimit BA.</p> <p>45.1. Mbi funksionimin e Bibliotekës.</p> <p>45.2. Formular për pasurimin e literatures në bibliotekë.</p> <p>45.3. Shembull procedure blerje literature.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Për realizimin e detyrave të kursit, ese, apo kur u duhet të bëjnë produkte mediatike në formate të ndryshme prezantimi (tekst, video, audio, fotografi/ galeri fotografike, animim etj) studentëve ju krijohen mundësi që të përdorin infrastrukturën e Media Lab. Aty punojnë dhe në mënyrë të pavarur, ose me asistencën e pedagogut titullar ose personeli mbështetës. Ky mjedis është i përshtatshëm dhe në procesin e përgatitjes së punimit të diplomës, veçanërisht në fazat e përpunimit të të dhënave, ndërtimin e grafikëve, tabelave etj. Edhe ky ambient është mbuluar me Wi-Fi, lehtësi për aksesin në internet qoftë kur punon me pajisjet e universitetit, qoftë kur përdor pajisjet personale.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>7. Rregullore mësimore BA Komunikim.</p> <p>7.3 Formati i Tezës së Provimit Përfundimtar.</p> <p>42. Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programeve të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Zyra e ekspertëve të IT, menaxhon mbarëvajtjen e përdorimit të të gjithë infrastrukturës kompjuterike, të instalimit të programeve dhe aplikacioneve, përshtatjen e tyre me nevojat që ka stafi akademik, studentët apo administrata. Studentët marrin njoftime, rezultate provimesh, vlerësime për detyrat, rekomandime për literaturë të detyruar apo alternative në mënyrë të personalizuar virtualisht. Kjo shërben për mbarëvajtjen e procesit mësimor në programet e ndryshme të studimit.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>7. Rregullore mësimore BA Komunikim.</p> <p>7.2 Sistemi i vlerësimit të studentëve.</p> <p>42. Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programeve të studimit.</p> <p>46.1 Urdher Mbi zbatimin e platformes LMS.</p> <p>46.2 UET LMS - Guide për pedagogun.</p> <p>46.3 UET LMS Guide për studentet.</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>Siç është përmendur më sipër, syllabus-et që ju shpërndahen studentëve dhe në soft copy përmes sistemit të komunikimit të personalizuar LMS. Gjithashtu përmes komunikimit të personalizuar virtual studentët kanë mundësi të marrin njoftime, vlerësime, pjesë të literaturës bazike dhe ndihmëse, gjithashtu dhe adresojnë pyetje, propozime dhe sugjerime për pedagogë të veçantë ose për njësinë bazë që menaxhon programin e studimit në fokus.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>7. Rregullore mësimore BA Komunikim.</p> <p>14. Kurrikula e programit BA Komunikim.</p> <p>14.2. Plani mësimor i programit - BA Komunikim.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 36

	<p>14.3. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - BA Komunikim (Aneks_Tabela 9).</p> <p>19. Silabus Metodot e kerkimit.</p> <p>19.1 Format i Syllabusit.</p> <p>37. Format i relacionit për monitorimin e silabuseve</p> <p>42. Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programeve të studimit.</p> <p>46.1 Urdher Mbi zbatimin e platformes LMS.</p> <p>46.2 UET LMS - Guide per pedagogun.</p> <p>46.3 UET LMS Guide per studentet.</p>			
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Pjesa e studentëve që ka mesatare të notave të marra 8.5 e lart ka të drejtën e shlyerjes së provimit final me punim diplome. Departamenti përgatit paraprakisht një set drejtimesh ku ata mund të fokusohen në përzgjedhjen e temës. Pas përzgjedhjes së temës dhe propozimit për pedagogun udhëheqës (në sinkroni me specializimin apo fushën e tij të kërkimit) student përfshihet në seancat metodologjike – si udhërrëfyes për të gjithë dinamikën e realizimit të punimit. Në çdo hap të punimit studenti asistohet nga pedagogu udhëheqës, deri në momentin kur vetëm me aprovimin e tij tema e finalizuar dorëzohet në Departament për mbrojtje e vlerësim.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>5. Rregullore e UET.</p> <p>7. Rregullore mësimore BA Komunikim.</p> <p>7.2 Sistemi i vleresimit te studenteve.</p> <p>27.2 Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				X

#### Standardi III.4

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/ bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Njësia kryesore në UET që promovon dhe koordinon përmirësimin sistematik të mësimdhënies është Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, KSBC. Kjo njësi bën monitorim dhe vlerësim të pavarur për zbatimin e kurikulës dhe për impaktin që ka veprimtaria kërkimore e shkencore në të gjithë strukturën e IAL-së, për fakultetet, departamentet apo programet e veçanta në nivele të ndryshme studimi KSBC është njësi autonome, e cila në bazë të gjetjeve dhe analizave që kryen, bën propozime për ndryshime në drejtim të përmirësimit të mësimdhënies, me synimin e afrimit të standardeve me universitetet e vendeve të zhvilluara. KSBC ka bashkëpunim me hallka të tjera në IAL në përmbushje me angazhimeve të planifikuara.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>7. Rregullore mësimore BA Komunikim.</p> <p>13. Mbi funksionimin e Zyres se Kurrikulave</p> <p>14. Kurrikula e programit BA Komunikim.30.1. Plani veprimtari KSBC.</p> <p>30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p> <p>30.3 Strategjia per sigurimin e brendshem te cilesise.</p>

	<p>30.4. Urdhër administrativ mbi përbërjen e KSBC.  30.5 Metodologjia e punes se KSBC provimet.  30.7 Shperndarja e relacionit te KSBC mbi silabuset.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/ bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Departamenti menaxhon dhe koordinon çdo aspekt që lidhet me programet e studimit që janë të akredituara. Duke iu përmbajtur rregulloreve të aktivitetit (si ato në rang IAL, ato të fakultetit, apo dhe të Departamentit) njësia bazë ndjek dhe garantimin e cilësisë në mësimdhënie, ndikon dhe nxit në trupën akademike (me kohë të plotë ose të pjesshme) që në mënyrë periodike të aktualizojnë metodat për zhvillimin e mësimin në auditor, si dhe të punëve aplikative. Kjo reflektohet sidomos në procesin parapërgatitor të fillimit të vitit akademik, duke diskutuar mbi syllabus-et që dorëzon çdo pedagog lëndë/moduli. Tregues tjetër është dhe delegimi i lëndëve që do të zhvillohen tek personel akademik që ka kualifikimin dhe ekspertizën e nevojshme, në sinkron të plotë me natyrën dhe kërkesat e njohurive që përfshihen në këtë apo atë lëndë. Ftesat për studentët në takimet që zhvillon njësia bazë, por dhe nxitja e të shprehurit të mendimeve dhe propozimeve prej tyre, shikohet si një instrument i dobishëm për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, në marrjen parasysh të problematikave të qenësishme që ata ngrenë.</p> <p><u>Referencë:</u>  7. Rregullore mësimore BA Komunikim.  13. Mbi funksionimin e Zyres se Kurrikulave  14. Kurrikula e programit BA Komunikim.  30.1. Plani veprimit KSBC.  30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë.  30.3 Strategjia per sigurimin e brendshem te cilesise.  30.4. Urdhër administrativ mbi përbërjen e KSBC.  30.5 Metodologjia e punes se KSBC provimet.  30.7 Shperndarja e relacionit te KSBC mbi silabuset.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Gjatë takimit më përfaqësues të stafit akademik, GVJ, u njoh me kombinimin e formave të mësimdhënies për tërhequr sa më shumë studentët në prezantime dhe diskutime mbi temat që trajtohen në auditor. Periudha dyvjeçare, me masat dhe protokollet antiCovid-19, kur mësimi në pjesën më të madhe është realizuar virtualisht, dha kufizime në metodat e aplikuara. Por rikthimi në kushtet normale, “in person”, ka krijuar terrenin e interaktivitetit gjatë zhvillimit të procesit mësimor, mbështetur nga metoda inovative nga ana e titullarëve të lëndëve.</p> <p><u>Referencë:</u>  7. Rregullore mësimore BA Komunikim.  14. Kurrikula e programit BA Komunikim.  30.1 Plani veprimit KSBC.  30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>UET ka në fokus kualifikimin e stafit akademik dhe atë mbështetës. Krahas përpjekjeve që bëjnë vetë anëtarët e stafit, duke shfrytëzuar mundësi që krijohen brenda a jashtë IAL-së, janë të konsoliduara dhe një sërë formateve tradicionale që kryen periodikisht, si Anuarët e Filozofisë dhe Shkolla e Humaniteteve, Shkolla e Lidërsipit, Shkolla Dimërore për Inovacion, New Media Trends etj.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë



E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222 43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 38

	<p><u>Referencë:</u>  3.1 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020.  3.3 PLANI STRATEGJIK_UET_2021.  44.1 Format Dosje, Staf Akademik me Kohë të Plotë.  44.2 Format Dosje, Staf Akademik me Kohë të Pjesëshme.  7. Staf akademik_v.a.2021-2022 (dokumentet shtesë).  14.3. Të dhënat për stafin akademik të angazhuar në programin e studimit 2021-2022 (dokumentet shtesë)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajtojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Në rang IAL-je por dhe Fakulteti apo Departamenti, anëtarët e stafit akademik të përfshirë janë përfitues të skemave (moduleve) trajnuese; si ato që realizohen në kuadër të programeve të shkëmbimit akademik me universitete ose institucione arsimore nga vende të tjera; nga investimi që bëhet brenda IAL-së për të sjellë në auditore të hapura ekspertë të ftuar, brenda dhe jashtë UET, apo kualifikime më të fokusuar në fusha të ndryshme.</p> <p><u>Referencë:</u>  2. Statuti i UET.  5. Rregullore e UET.  7. Rregullore mësimore BA Komunikim.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Rekrutimi i personelit akademik (me kohë të plotë ose të pjesëshme), si dhe personelit mbështetës, kualifikimi dhe përfshirja në veprimtarinë kërkimore dhe shkencore periodikisht – janë indikatorë që përcaktojnë nivelin e mësimdhënies dhe aplikimin e metodave të reja në zhvillimin e kurikulës së një program studimor. Ndaj dhe Departamenti investohet në këto drejtime, duke monitoruar dhe analizuar performancat e anëtarëve të stafit akademik e mbështetës në favor të mësimdhënies dhe mësimnxënies nga ana e studentëve që frekuentojnë njërin prej profileve të programit “Komunikim” BA.</p> <p><u>Referencë:</u>  2. Statuti i UET  5. Rregullore e UET.  7. Rregullore mësimore BA Komunikim.  11.1 Shembull thirrje për staf akademik  44.1 Format Dosje, Staf Akademik me Kohë të Plotë.  44.2 Format Dosje, Staf Akademik me Kohë të Pjesëshme.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Metodat e mësimdhënies janë variabël, në varësi të përmbajtjes dhe formatit të lëndës apo dhe aplikimeve që ka zgjedhur pedagogu për prezantimin dhe trajtimin e temave. Kjo eksperiencë individuale e secilit prej pjesëtarëve të stafit akademik është temë që trajtohet mbledhjet e Departamentit, për ta ndarë si përvojë pozitive. Burim tjetër për përfshirjen e metodave të reja në mësimdhënie janë dhe periudhat e vizitave që pedagogë të ndryshëm zhvillojnë në universitete të tjera, në kuadër të programeve të ndryshme të shkëmbimit akademik.</p> <p><u>Referencë:</u>  7. Rregullore mësimore BA Komunikim.  3.1 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020.  3.3 PLANI STRATEGJIK_UET_2021.  7 Staf akademik_v.a.2021-2022 (dokumentet shtesë).</p>

	14.3. Të dhënat për stafin akademik të angazhuar në programin e studimit 2021-2022 (dokumentet shtesë).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi III.5

**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Studenti që ndjek programin “Komunikim” në ciklin e parë BA ka marrë njohuri mbi standardin e vlerësimit të njohurive përmes testeve të ndërmjetme ose finale – nga shpjegimet që janë bërë në ditët e para të fillimit të studimeve, gjatë procesit orientues. Por nëse ky informacion mbetet i përgjithshëm (ashtu siç informacioni që merr nga përmbajtja e rregulloreve të UET-it apo e programit që ata ndjekin), detaje specifike, referuar dhe lëndës konkrete, studentët e marrin dhe nga syllabus-et që ju shpërndajnë titullarët e lëndëve. Aty gjejnë pjesën e strukturimit të vlerësimit (pjesëmarrja, detyrat, testet e ndërmjetme, testi final) referuar përqindjes konkrete që zë secili prej elementëve përbërës. Një mundësi informimi për aspekte specifike që ka një student në interesimin për mënyrën e vlerësimit është konsultimi me koordinatoren e njësisë bazë, apo duke u adresuar tek zyra e kujdesit ndaj studentit.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>5. Rregullore e UET. 7. Rregullore mësimore BA Komunikim. 7.2 Sistemi i vlerësimit të studenteve. 19. Silabus Metodot e kerkimit. 19.1 Formatit i syllabusit. 37 Formatit i relacionit për monitorimin e silabuseve.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/ modulit.</p>	<p>Siç dhe u përmend në kriterin më sipër, informacion dhe rifreskim të mënyrës se si do të procedohet për metodologjinë e testimit dhe vlerësimit studentit merr nga përmbajtja e syllabus-it që iu shpërndan paraprakisht pedagogu i lëndës. Pjesa e njohjes me rezultatin vlerësues për çdo provim apo detyrë të kryer realizohet përmes komunikimit virtual në mënyrë të personalizuar. Njoftimet e rezultateve jepen përmes e-mailit, ose në platformën LMS, e aksesueshme nga të gjithë studentët që në ditën e parë të fillimit të vitit akademik dhe deri sa ai/ajo finalizon ciklin e studimit.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>5. Rregullore e UET. 7. Rregullore mësimore BA Komunikim. 19. Silabus Metodot e kerkimit. 19.1 Formatit i syllabusit. 37 Formatit i relacionit për monitorimin e silabuseve.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive</p>	<p>Mënyra se si kryet testimi dhe vlerësimi i njohurive teorike e shprehive aplikative për një student varet nga natyra e lëndës, që shërben si</p>



<p>profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>referencë për strukturimin e peshës specifike që do të zënë komponentët që në total janë 100%. Studenti krijon bindjen para se të testohet, se çfarë niveli ka arritur paraprakisht, si i ka realizuar komponentët përbërës (p.sh. pjesëmarrja në procesin mësimor, detyrat a shlyerje që janë caktuar gjatë semestrit nga pedagogu, vlerësimi për testin e ndërmjetëm etj.), fakt që e përgatit për pritshmëritë në rezultatin final. Njohja me komponentët e vlerësimit ndikojnë tek studentit që të jetë i angazhuar gjatë periudhës që zhvillohet lënda, duke pasur një kurbë konstante që e lehtëson në përgatitjet për kryerjen e testit final.</p> <p><u>Referencë:</u>  5. Rregullore e UET.  7. Rregullore mësimore BA Komunikim.  7.2 Sistemi i vlerësimit të studenteve.  19. Silabus Metodot e kerkimit.  19.1 Formati i syllabusit.  37 Formati i relacionit për monitorimin e silabuseve  40.1 Formular për ankesat e studenteve</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p>X</p>

**Standardi III.6**

**Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studentit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p>	<p>Për mënyrën e vlerësimit të nivelit të përgatitjes së studentit gjatë zhvillimit të lëndës jepen udhëzime paraprakisht, të paktën në dy momente: së pari, ku pedagogu shpërndan për të gjithë studentët syllabusin, pjesë e të cilit është dhe strukturimi i peshës specifike që ka te nota që nga pjesëmarrja (aktivizimi) e deri tek rezultati në detyrën e kursit, në teste dhe deri tek provimi final i lëndës; së dyti, përmes shpjegimeve që ju jepen studentëve në ditët e para të vitit akademik të informimit dhe familjarizimit mbi kurikulën vijuese që do të zhvillohet. Kështu që student jo vetëm ka të qartë dinamikën vlerësuese, e cila shtrihet në tërë periudhën e realizimit të lëndës.</p> <p><u>Referencë:</u>  3.1 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020.  3.3 PLANI STRATEGJIK UET 2021.  5. Rregullore e UET.  7. Rregullore mësimore BA Komunikim.  7.2 Sistemi i vlerësimit të studenteve.  19. Silabus Metodot e kerkimit.  19.1 Formati i syllabusit.  27.2 Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat</p>	<p>Duke qenë se në dy vite akademike radhazi, 2019 – 2020 dhe 2020 – 2021, mësimi u zhvillua kryesisht virtualisht në të gjithë IAL-në, nga shkaku i mospërhapjes së pandemisë Covid-19, institucioni u detyruar të adaptonte një sistem vlerësimi që siguronte saktësi dhe transparencë në kushtet kur</p>

<p>eliminonjë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>testimet zhvilloheshin të gjitha online. Gjatë bisedës me studentët apo stafin akademik morëm informacion mbi aplikimin e sistemit të vlerësimit “clean scoring”, siguruar nga partneriteti mes UET dhe Fondit të Zhvillimit Shqiptaro-Amerikan, AADF, që është një infrastrukturë virtuale që siguron shqyrtimin me saktësi të testeve nga studentët, kur ato kryen online. Pavarësisht se në këtë vit akademik (2021-2022) situata rreth pandemisë ka përmirësime të dukshme, me relaksim të masave bllokuese dhe kufizuese, institucioni po e mban në zbatim këtë aplikacion, si një alternativë për procesin e provimeve që zhvillohen.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>5. Rregullore e UET.  6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit.  7. Rregullore mësimore BA Komunikim.  7.2 Sistemi i vlerësimit të studenteve.  46.1 Urdher Mbi zbatimin e platformes LMS.  46.2 UET LMS - Guide per pedagogun.  46.3 UET LMS Guide per studentet.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/ modulit.</p>	<p>Në testimin periodik për lëndët dhe modulet e planifikuara për t’u zhvilluar, vlerësimi i njohurive realizohet nga pedagogu i lëndës, kurse në rastet e provimit përfundimtar (ose kur përgatitet punim diplome), ose për praktikant profesional kjo bëhet me komision, që formohet me vendim të njësisë bazë. Departamenti na njohu dhe me praktika të veçanta, kur studenti ishte me aftësi ndryshe (kufizim ose humbje shikimi), raste për të cilat kishte të paktën dy pjesëtarë të stafit akademik, njëri prej tyre pedagogu lëndës.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>5. Rregullore e UET.  6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit.  7. Rregullore mësimore BA Komunikim.  7.2 Sistemi i vlerësimit të studenteve.  27.2 Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Mënyra e testimit të dijeve, qoftë në kontrollin pjesor apo atë final të lëndës, realizohet përmes mbajtjes anonime të emrit për secilin student dhe sinkronizimi emër-vlerësim bëhet pas korrigjimit të provimeve. Nga informacioni që GVJ mori në bashkëbisedim me studentët dhe personelin akademik u identifikua aspekti i zhvillimit të provimeve vetëm në prezencë të pedagogut të lëndës (ose komisionit të formuar), si dhe koordinatorit, duke mos lejuar asnjë person tjetër të përfshihet në proces.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>5. Rregullore e UET.  6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit.  7. Rregullore mësimore BA Komunikim.  7.2 Sistemi i vlerësimit të studenteve.  27.2 Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla</p>	<p>Gjatë zhvillimit të testeve të ndërmjetme, apo në procesin e dorëzimit të detyrave të kursit nga studentët, procesi i vlerësimit nga pedagogu shoqërohet dhe me komente e sqarime mbi përgjigjet ose punën e studentit, duke rikapitulluar dhe çështje apo nënçështje që janë përmendur gjatë seancave të zhvillimit të lëndës. Kjo mbështet studentin që të ketë</p>


Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 42




<p>mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>parasysh për rishikim më të thelluar të pjesëve nga prezantimet në auditor apo literatura e rekomanduar, si ndihmë për përvetësimin më të mirë të njohurive që trajtohen, për rrjedhojë dhe rezultat më optimal në provimin final të lëndës.</p> <p><u>Referencë:</u>  5. Rregullore e UET.  6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit.  7. Rregullore mësimore BA Komunikim.  7.2 Sistemi i vleresimit të studenteve.  27.2 Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Evitimi i fenomenit të kopjimit gjatë zhvillimit të testeve, në dy vitet e fundit akademike kur ato janë realizuar thuajse të gjitha online (nga masat kufizuese dhe penguese për frenimin e përhapjes së pandemisë Covid-19) ka pasur rezultatet mbresëlënëse, falë përdorimit të platformave virtuale dhe aplikimit nga pedagogët të formateve pyetësorësh me alternative zgjedhjeje, me zhvillim ose forma mikse. Në rastin e zhvillimit të testit në auditor (in person), merren masa nga pedagogu lëndës dhe Departamenti që të ketë monitorim në evitimin e fenomenit, duke zgjedhur auditor me hapësira, në mënyrë që studentët të punojnë individualisht dhe në distancë, duke mos lejuar komunikimin bisedor, përdorimin e aparateve celulare etj. Për evitimin e plagjiaturës nga detyrat dhe punimet që prezanton studenti, prej 6 viteve përdoret Turnitin Ephorus, një sistem dedektor që kap raste të plagjiaturës kur materiali që prezanton një student shkarkohet për verifikim.</p> <p>Bazuar në rregulloren e IAL-së, për të dy rastet, kopjim ose plagjiaturë, vlerësimi është 4 (mbetës), pavarësisht elementëve të tjerë vlerësues që ka fituar studenti paraprakisht.</p> <p><u>Referencë:</u>  5. Rregullore e UET.  7. Rregullore mësimore BA Komunikim.  7.2 Sistemi i vleresimit të studenteve.  2.1/2.2/2.3/2.4 Mbledhje e hapur me studentë - 2021 (dokumentet shtesë)</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Nga shpjegimet që na u bënë nga studentët apo dhe pjesëtarë të stafit akademik, GVJ konstatoi se një nga indikatorët kryesorë për objektivitetin e vlerësimeve të njohurive, ishte niveli i kontestimeve nga ana e studentëve. Atyre u garantohej hedhja e vlerësimeve online në mënyrë të personalizuar brenda dy javëve, gjithashtu ju njihej e drejta për proces rishikimi të vlerësimeve. Fillimisht kjo bëhej në konsultim me pedagogun e lëndës, por kur kjo nuk bindte studentin, atëherë kishte dhe një hap të mëtejshëm për trajtimin e ankesës me komision që ngrihet nga njësia bazë.</p> <p><u>Referencë:</u>  3.1 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020.  3.3 PLANI STRATEGJIK UET 2021.  5. Rregullore e UET.  7. Rregullore mësimore BA Komunikim.  7.2 Sistemi i vleresimit të studenteve.  19. Silabus Metodat e kerkimit.  19.1 Formatit i syllabusit.  27.2 Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al



Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



Faqe 43

<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Afati për publikimin e rezultateve të provimit nga pedagogu i lëndës është brenda dy javëve. Rezultatet shpërndahen në mënyrë të personalizuar virtualisht për secilin student. Nëse ka kontestime për mënyrën e vlerësimit (rezultatit), ai/ ajo kanë të drejtë për rishikim, proces që realizohet në dy hapa: ose përmes konsultimit për rezervat që shfaqen drejtpërdrejt me pedagogun, ose kur kjo nuk mjafton dhe bind palën ankuese, kalohet në trajtimin me komision që ngre njësi bazë (shpjegohet dhe më poshtë). Në rastin kur nuk paraqiten kontestime, pedagogu (ose komisioni kur aplikohet një format i tillë), e konsideron të mbyllur procesverbalin me vlerësimet, duke e dorëzuar në Sekretarinë Mësimore.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>3.1 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020.  3.3 PLANI STRATEGJIK UET 2021.  5. Rregullore e UET.  7. Rregullore mësimore BA Komunikim.  7.2 Sistemi i vlerësimit të studenteve.  19. Silabus Metodat e kerkimit.  19.1 Format i syllabusit.  27.2 Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik.</p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Për rastet kur nga një student shprehen rezerva mbi nivelin e vlerësimit, fillimisht ai/ ajo ja prezanton ankimimin pedagogut në një takim ballafaqimi, ku trajtohen aspektet që kontestohen. Në rast se kjo nuk e mjafton për studentin, atëherë ankesa adresohet në Departament, duke kaluar në shqyrtimin e rezervave përmes një komisioni, për procedimet e të cilat në çdo rast mbahet dokumentacion shpjegues për trajtimin dhe kolaudimin e rastit. Në takime me studentët, morëm informacion se ka pasur raste të tilla në dy vitet e fundit akademike, të cilat ishin zgjidhur që në fazën e konsultimit me pedagogun e lëndës përmes sqarimit të çdo pretendimi nga student. Për studentët që kontaktuan nuk kishte raste të identifikuara për ta apo studentë të tjerë që ndjekin një nga profilet e programit të studimit BA “Komunikim”.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>5. Rregullore e UET.  6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit.  7. Rregullore mësimore BA Komunikim.  7.2 Sistemi i vlerësimit të studenteve.  40. Format i vlerësimit të pedagogut nga studentët.  40.1 Formular për ankesat e studenteve.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

<p><b>Standardi III.7</b>  <b>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese të studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>

<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi që po vlerësohet, në të katër profilet, Marrëdhënie Publike, Gazetari, Grafikë-Dizajn dhe Marketing dhe Grafikë-Dizajn), ka një kurikula që i ofron studentit që e ndjek marrjen e njohurive dhe shprehive profesionale bazike mbi PR, shkrim dhe raportim të lajmit, aspekte të etikës e deontologjisë, multimedia dhe konvergjenca e tregut mediatik, marketimit në nivele të ndryshme etj. Sikundër është shprehur dhe në shpjegimet më sipër, për GVJ, këto përbëjnë një bazë të qëndrueshme për studentët, e cila merret në tri vitet akademike në mënyrë graduale si njohuri dhe shprehje që duhet të fitojnë. Lëndët, si ato të natyrës bazike, karakterizuese, ndërdisiplinore apo plotësuese japin garanci për thellimin e njohurive, nxitjen e përfshirjes në procesin kërkimor dhe shkencor, por dhe të aftësive në përballimin e detyrave gjatë angazhimit në redaksi, institucione të ndryshme, njësi a sipërmarrje etj.</p> <p><u>Referencë:</u>  3.1 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020.  3.3 PLANI STRATEGJIK UET 2021.  4 Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit BA Komunikim.  7. Rregullore mësimore BA Komunikim.  14. Kurrikula e programit BA Komunikim.  14.2. Plani mësimor i programit - BA Komunikim.  14.3. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - BA Komunikim (Aneks Tabela 9).  26. Të dhëna për numrin e programeve që ofrohen nga njësi përgjegjëse Tab 3.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Kurikula që kryejnë studentët në programin e studimit “Komunikim” në ciklin BA përfshin marrjen e njohurive teorike dhe shprehive aplikative në fushën e teknologjisë së informacionit, në lëndë të tilla si “Bazat e informatikës”, “Bazat e Multimedias”, “E-shërbimet”, “Parimet e kërkimit të tregut”, “Programe të aplikuara dizajni” etj., apo në lëndët me natyrë humane, si “Hyrje në filozofi”, “Hyrje në Sociologji”, “Hyrje në ekonomi”, “Histori arti”, “Histori bashkëkohore” etj. Ndërkohë që ka lëndë nga fusha e komunikimit dhe ndërveprimit si ato “Hyrje në komunikim”, “Teoritë e komunikimit”, “E folura në publik”, “Teoritë e komunikimit pamor”, “Komunikim ndërkulturor”, “Komunikimi organizativ”, “Puna individuale dhe në grup” etj. Veç lëndës “Anglisht”, pjesë e literaturës së detyruar apo plotësuese që jepen nga pedagogët e lëndës (pasqyruar dhe në syllabus-e) janë në gjuhën angleze.</p> <p><u>Referencë:</u>  3.1 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020.  3.3 PLANI STRATEGJIK UET 2021.  4 Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit BA Komunikim.  7. Rregullore mësimore BA Komunikim.  14. Kurrikula e programit BA Komunikim.  14.2. Plani mësimor i programit - BA Komunikim.  14.3. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - BA Komunikim (Aneks Tabela 9).  26. Të dhëna për numrin e programeve që ofrohen nga njësi përgjegjëse Tab 3.</p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Procesi përmbylles së zhvillimit të lëndës në programin që është në fokus përfshin dhe analizimin nga pedagogu të treguesve sasiorë (nivelein e vlerësimit për secilin student), por dhe anën cilësore të detyrave që ata kanë dorëzuar. Para fillimit të vitit të ri akademik, pedagogu reflekton përmirësime në syllabus-et që duhet të dorëzojë në Departament, në rishikimin e temave që trajtohen apo të literaturës që ofrohet, duke e aktualizuar me tituj të publikimeve që kanë nisur të qarkullojnë; si dhe duke sjellë në raporte proporcionale shkallën e teorive me shprehitë aplikative. Mendimet që tërhiqen nga studentët që sa kanë kryer lëndën vlejné për të tjerët që kanë rast të ulen në ndjekje të vitit të ri akademik.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>3.1 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020.  3.3 PLANI STRATEGJIK_UET_2021.  4 Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit BA Komunikim.  7. Rregullore mësimore BA Komunikim.  14. Kurrikula e programit BA Komunikim.  14.2. Plani mësimor i programit - BA Komunikim.  14.3. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - BA Komunikim (Aneks_Tabela 9).  26. Të dhëna për numrin e programeve që ofrohen nga njësia përgjegjëse Tab 3.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/ moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Rikapitulumimi i çështjeve kryesore të trajtuara gjatë zhvillimit të lëndës është pjesë e komunikimit pedagog– studentë. Veçanërisht në periudhën para zhvillimit të provimit ose të testeve të ndërmjetëm, pedagogu rikthehet tek temat kryesore që janë zhvilluar në auditor, ose tek pjesë që janë të vështira për asimilim nga studentët. Këto konsultime paraprake rifreskojnë dhe konsolidojné njohuritë teorike dhe shprehitë aplikative si pjesë e kurikulës së programit studimor që ndjekin studentët.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>7. Rregullore mësimore BA Komunikim.  7.2 Sistemi i vlerësimit të studenteve.  14.3 Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - BA Komunikim (Aneks_Tabela 9).  40. Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët.  40.1 Formular për ankesat e studenteve.  41. Formular i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Praktika e zhvillimit të orëve të hapura me anëtarë të personelit akademik të IAL-së apo të ftuar si ekspertë të jashtëm, që trajtojnë aspekte të zhvillimit të shkencës dhe teknologjisë ndihmon studentët, por dhe stafin pedagogjik të aktualizojné njohuritë mbi trendet e reja, që janë premisë për thellim të mëpasëm. Këto tema që nuk përfshihen në programin mësimor vlejné dhe për përmirësimin e përshtatjen e programeve të lëndëve që lidhen direkt ose indirekt, vlejné për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe procesit të kërkimit shkencor.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>7. Rregullore mësimore BA Komunikim.  13 Dokumenti E.VIII Mbi funksionimin e Zyres së Kurrikulave.  17 Studim i tregut të punës.</p>

	<p>32. Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkepunuese per programin e studimit dhe praktikat profesionale.</p> <p>32.1 Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale.</p> <p>32.2 Formulari i vevleresimit te praktikës (nga studenti).</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Fluksi i trajtimeve teorike në zhvillimin e lëndëve harmonizohet dhe me shprehitë praktike, aplikative që studentëve iu ofrohen. Për vetë natyrën e programit të studimit që është në fokus mjaft nga konceptet dhe njohuritë teorike përthyhen në shprehi praktike, të cilat në pjesën më të madhe zhvillohen në Media Lab, që siç e kemi shpjeguar më sipër është një infrastrukturë në dispozicion të njësisë bazë që menaxhon programin "Komunikim" BA. Detyrat dhe angazhimet praktike në këtë mjedis formëzojnë metodën learning by doing, për konsolidimin e sa më shumë përvojave në konceptimin dhe realizimin e produktit, si në kushte reale.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>7. Rregullore mësimore BA Komunikim.</p> <p>7.2 Sistemi i vleresimit te studenteve.</p> <p>14.3 Plani mësimor i ndarë sipas veprintarive formuese - BA Komunikim (Aneks Tabela 9).</p> <p>40. Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët.</p> <p>40.1 Formular per ankesat e studenteve.</p> <p>41. Formular i vevlerësimit te performancës së personelit akademik.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/ çështjeve të caktuara.</p>	<p>Ndarja e ideve dhe zgjidhjeve për detyrat që studentët kryejnë në programin studimor me njeri-tjetrin, duke prezantuar në grup shikohet nga UET, si dhe çlirim pikëpamjesh apo shkëmbim të tyre, në përzgjedhjen më të favorshme për detyrën që duhet të përmbushin. Konsultimi në grup është një instrument nxitës dhe konkurrues që motivon cilësinë e nivelit të njohurive teorike dhe shprehive aplikative. Gjatë takimit me studentët dhe personelin akademik u trajtua dhe ky aspekt, ku u pranua si një standard i konsoliduar shpërndarja e detyrave për t'u kryer në grup, kryesisht me 2-3 vetë, por në varësi të natyrës së temave edhe me pjesëmarrje më të madhe në secilin grup zbatues.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>4 Plani strategjik per zhvillimin e programit te studimit BA Komunikim.</p> <p>7. Rregullore mësimore BA Komunikim.</p> <p>7.2 Sistemi i vleresimit te studenteve.</p> <p>32. Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkepunuese per programin e studimit dhe praktikat profesionale.</p> <p>32.1 Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>Gjatë takimit me stafin akademik një nga aspektet që u diskutua në bashkëbisedim në grup apo individualisht ishte dhe motivimi që ata marrin nga IAL-ja për zhvillimin e ideve inovative dhe për studimet e avancuara. GVJ identifikoi se për stafin ka pasur stimuj dhe mbështetje konkrete financiare për projekte të propozuara studimore, por dhe për pjesëmarrje në konferenca shkencore ndërkombëtare mbi tema që lidhen me fushat e tyre të kërkimit shkencor, me vizita pune etj. Në mjaft raste pjesëtarët e stafit kanë angazhuar në grupet punuese dhe student që kanë shprehur interes për përfshirje në veprimtari kërkimore.</p>

	<p><u>Referencë:</u>  3.1 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020.  3.3 PLANI STRATEGJIK UET 2021.  4 Plani strategjik per zhvillimin e programit te studimit BA Komunikim.  13 Mbi funksionimin e Zyres se Kurrikulave.  Evidenca 30.1/30.2/30.3/30.4/30.5  30.1 Plani veprimit KSBC.  30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë.  30.3 Strategjia per sigurimin e brendshem te cilesise.  30.4. Urdhër administrativ mbi përbërjen e KSBC.  30.5 Metodologjia e punes se KSBC provimet.</p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	<p>UET ndjek politika për mbështetjen e procesit të kërkimit shkencor dhe përfshirjen e personelit akademik apo studentëve në zhvillimin dhe përhapjen e ideve inovative, duke mundësuar mbështetje për pjesëmarrje në studime konkrete të avancuara. Studentët angazhohen në grupe pune të krijuara nga personeli akademik, për studime, për kumtesa a referime në konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit, por gjithashtu studentët përfshihen në punë të pavarur "Strategjia e Kërkimit Shkencor; Vizioni, pika 1.2,</p> <p><u>Referencë:</u>  3.1 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020.  3.3 PLANI STRATEGJIK UET 2021.  4 Plani strategjik per zhvillimin e programit te studimit BA Komunikim.  13 Mbi funksionimin e Zyres se Kurrikulave.</p>			
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Mbështetja e konceptimit dhe hartimit të kurikulës për programet e studimit në përvojat e institucioneve universitare dhe akademike të vendeve të tjera është tregues në favor të ngushtimit të diferencave. Kjo ushqehet dhe nga rastet e zbatimit të programeve të shkëmbimit të personelit akademik në universitete partnere, ku kthimi i pedagogëve në auditorë përbën vlerë të shtuar në kontributin e tyre në mësimdhënie, apo në procesin kërkimor dhe në eventet e mirëfillta shkencore, konferenca, seminare, workshop-e etj. Ndikim pozitiv kanë dhe rastet e studentëve që përfitojnë në kuadër të Erasmus+, duke ju dhënë atyre më shumë siguri në tregun e punës, brenda ose jashtë vendit.</p> <p><u>Referencë:</u>  7. Rregullore mësimore BA Komunikim.  28 Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin.  43.1 Mobilitete akademike dhe studente</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				X

**Standardi III.8**

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
-----------------	-------------------------------



<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e UET, por dhe në dokumente të tjera të miratuara në nivel fakultetesh apo departamentesh, ka një procedurë për finalizimin e studimeve, si në rastin kur studenti e kryen me punim diplome, ashtu dhe kur kryet me provim përfundimtar. Për rastin e realizimit të punimit të diplomës, një student i jepet informacion paraprakisht mbi përcaktimin e aspekteve të përzgjedhjes së temës, miratimit të saj, përcaktimit të pedagogut udhëheqës, të seancave konsultuese metodologjike, si dhe formati për tekstin final të dorëzuar, mbrojtja në komision etj. Niveli i mesatares për rastet e provimit final me punim diplome është 8.5 e lart. Për rastin e provimit përfundimtar po ashtu jepet informacion paraprak mbi çështjet që përfshihen, për ngritjen e komisionit e deri tek procedimi në seancën e provimit, të njohjes me rezultatin etj.</p> <p><u>Referencë:</u> 5 Rregullore e UET. 7. Rregullore mësimore BA Komunikim.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Në kohën kur GVJ ishte në vizitë në UET identifikoi se për studentët e vitit të tretë, të programit në fokus ishte bërë saktësimi për ata që do të kryenin provim përfundimtar të përgjithshëm dhe për ata që do të kenë punim diplome. Njësia bazë kishte hartuar një listë me aspektet kryesore të njohurive që ishin marrë në tri vitet akademike të studimit dhe jua kishte ndarë studentëve. Ndërkohë që pjesa që do të merrej me temë diplome ishte informuar me planifikimin e seancave metodologjike, që ishin hapësira konsultimi me pedagogët udhëheqës mbi dinamikën e konceptimit, strukturimit dhe shkrimit të temës së zgjedhur.</p> <p><u>Referencë:</u> 5 Rregullore e UET. 7. Rregullore mësimore BA Komunikim.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Përmbajtja që përzgjidhet për provimin e përgjithshëm përfundimtar bazohet lëndët/modulet që zhvillojnë studentët në tri vitet akademike, por në peshë specifike, më shumë janë nga grupi i lëndëve B, rreth 80%, kurse pjesa e mbetur nga lëndët e grupeve të tjera. Hartimin e tezës për provimin përfundimtar njësia bazë e bën duke përfshirë më shumë pyetje cilësore dhe në zhvillim. Nga biseda me drejtues të Departamentit mësuam se në rastin e provimit synimi mbetet që përmes listës së çështjeve që ju jepen studentëve për përgatitje ata të kenë mundësi të rikapitulojnë njohuritë për të cilat kanë marrë informacion apo kanë diskutuar me pedagogët e lëndëve në tri vitet akademike që zgjat programi i studimit “Komunikim” BA.</p> <p><u>Referencë:</u> 5 Rregullore e UET. 7. Rregullore mësimore BA Komunikim.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/diplomave.</p>	<p>Për studentët që zgjedhin si detyrim final provimin e përgjithshëm përfundimtar, nga Departamenti përcaktohen hapësira kohore konsultimi të tyre me pedagogë nga lëndët që përfshihen në aspektet e përzgjedhura për t’u përgatitur. Konsultimi është një ndihmë për orientim dhe fokusim për studentët që të arrijnë të studiojnë temat dhe nëntemat që përbëjnë lëndën për përgatitje. Nga ana tjetër për studentët që do të përgatisin temë</p>

	<p>diplome, asistencën kryesore e jep pedagogu udhëheqës, që i orienton për qasjen në literature, në strukturimin e temës, shkrimin apo çështje të ndryshme metodologjike që maksimalizojnë cilësinë e punimit dhe paraqitjen në kohë për mbrojtje para komisionit.</p> <p><u>Referencë:</u>  5 Rregullore e UET.  7. Rregullore mësimore BA Komunikim.  40 Format i vlerësimit të pedagogut nga studentët</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Për natyrën që ka programi “Komunikim” në ciklin e parë për temat e diplomës që kërkojnë mbledhjen e analizimin e të dhënave empirike, Departamenti angazhon kordinatoren e programit apo kordinatorë të programeve të tjera për shpërndarjen e pyetësorëve të përgatitur nga studenti nën vëmendjen e udhëheqësit të temës. Studentët që kanë domosdoshmëri mbledhjen e të dhënave në institucione të tjera publike ose jopublike, pajisen me vërtetim (kërkesë) nga IAL-ja, si mbështetje për detyrën që ai do të kryejë në funksion të temës së diplomës që zhvillon.</p> <p><u>Referencë:</u>  5 Rregullore e UET.  7. Rregullore mësimore BA Komunikim.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Për programin që është në fokus të këtij vlerësimi aplikohen punime të diplomës, ku kriteri bazik është mesatarja e tri viteve akademike 8.5 e lart. Në themel të bashkëpunimit që një student ka me udhëheqësin e tij janë realizimi i seancave metodologjike, të cilat mbulojnë hapat që hedh autori i diplomës për konceptimin, strukturimin, për qasjen metodologjike, për procesin e kërkimit, përpunimit dhe analizimit të të dhënave, të trajtimit teorik të çështjeve dhe nënçështjeve etj. Seancat metodologjike precizojnë dhe bazën e literaturës që nevojitet si mbështetje teorike për zhvillimin e temës, por dhe njohjen me format e shkrimit akademik, që e bëjnë punimin me një linjë logjike zhvillimi dhe prezantimi të gjetjeve, përfundimeve dhe propozimeve potenciale. Pedagogu udhëheqës kujdeset dhe për procesin e grumbullimit të të dhënave empirike, përmes anketave, si dhe tregimin e të dhënave të përfuara në forma tabelare, grafike etj., qartësisht të kuptueshme. Para se punimi i studentit të kalojë për procesin e mbrojtjes para komisionit, duhet që patjetër të ketë gjurmë aprovimi nga pedagogu udhëheqës.</p> <p><u>Referencë:</u>  5 Rregullore e UET.  7. Rregullore mësimore BA Komunikim.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Në të dy rastet, kur një student jep provim përfundimtar, apo kur realizon punim diplome – vlerësimi bëhet me notë. Vlerësimi është mesatarizim i vlerësimeve që jep çdo anëtar i komisionit, përlogaritje që kryet mes pjesëmarrësve. Më pas vlerësimi i bëhet prezent çdo studenti në përfundim të seancës, ku veç anëtarëve të komisionit janë dhe studentët që diplomohen. Procesverbalet përkatëse kalojnë në sekretarinë mësimore, ku bëhet hedhja e vlerësimeve në listat ku janë të gjitha notat e studentit për të tri vitet akademike.</p> <p><u>Referencë:</u>  5 Rregullore e UET.</p>

	7. Rregullore mësimore BA Komunikim. 7.2 Sistemi i vleresimit te studenteve.			
<b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Fillimisht, sapo studenti ka kryer të gjitha shlyerjet nga kurikula për tri vitet akademike, plus dhe provimin përfundimtar (ose temën e diplomës) ai merr një vërtetim provizor të shoqëruar me listën e të gjitha notave në lëndët që zhvilluar. Më pas, brenda gjashtë muajsh jepet dhe diploma sipas standardit të Ministrisë së Arsimit, po ashtu dhe suplementi i diplomës.  <i>Referencë:</i> 5 Rregullore e UET. 7. Rregullore mësimore BA Komunikim. 7.2 Sistemi i vleresimit te studenteve.			
<b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Një student që finalizon dhe provimin përfundimtar të përgjithshëm, apo punimin e diplomës, nëse i nevojitet, tërheq dhe një dokument ku përfshihen të gjitha syllabus-et e lëndëve që ka kryer, po ashtu ai merr nga zyra e sekretarisë mësimore dhe suplementin e diplomës ku jepen në gjuhën shqipe dhe angleze shpjegimet e nivelit të kualifikimit që ka arritur në ciklin e studimeve që ka arritur.  <i>Referencë:</i> 5 Rregullore e UET. 7. Rregullore mësimore BA Komunikim. 46.3 UET LMS Guide per studentet.			
<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/ konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	GVJ u njoh gjatë vizitës në UET dhe me procedimin e ruajtjes (arkivimit) të dokumenteve individuale për secilin student që kryen studimet në një program të caktuar. Arkivimi siguron që studentit mund të paraqitet sa e herë që e ka të nevojshme të marrë kopje të dokumentacionit mbi kryerjen e ciklit apo cikleve të studimit, por dhe për ato raste kur kërkon vërtetim mbi rezultatet e arritura në kryerjen e kurikulës në mënyrë jo të plotë, ku identifikohen notat dhe kreditet për ato lëndë e module që ka shlyer.  <i>Referencë:</i> 7. Rregullore mësimore BA Komunikim. 7.2 Sistemi i vleresimit te studenteve. 28 Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin. 5 Rregullore e UET. 43.1 Mobilitete akademike dhe student.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,  
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Mbështetur në dokumentacionin e përcjellë nga institucioni dhe informacionin e siguruar gjatë vizitave në UET, GVJ vëren se institucioni dhe specifikisht, Zyra e Burimeve Njerëzore, ka mbledhur dhe ruajtur të dhënat e personelit akademik (me kohë të plotë apo të pjesshme) dhe administrativ të angazhuar me programin e studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Komunikim” me profilet “Gazetari”, “Marrëdhënie Publike”, “Grafikë Dizajn” dhe “Marketing” duke i përmbledhur të gjitha informacionet në dosje individuale për stafin.</p> <p>Gjatë vizitës dhe takimit me përfaqësues të zyrës së burimeve njerëzore në UET u morëm me përzgjedhje rastësore dosjet e personelit akademik të dy anëtarëve të personelit akademik të angazhuar me programin e studimit, si për staff Akademik PAE dhe PAK. GVJ konstaton se zyra Dosja përmban elementët e domosdoshëm si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>(i) Informacionin mbi arsimin, në të gjitha nivelet;</li> <li>(ii) Informacionin mbi kualifikimet dhe publikimet /botime;</li> <li>(iii) Informacionin shëndetësor;</li> <li>(iv) Dosja përmban edhe vlerësimin që i është bërë pedagogut nga studentët;</li> <li>(v) Kontratat e punës në vite, etj.</li> </ul> <p><i>Referenca:</i> 44.1 Format Dosje, Staf Akademik me Kohë të Plotë. 44.2 Format Dosje, Staf Akademik me Kohë të Pjesshme</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>UET ka hartuar procedura të përcaktuara lidhur me menaxhimin e burimeve njerëzore. Sipas Rregullores së Burimeve Njerëzore, aty janë të përcaktuara:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>(i) Politikat dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;</li> <li>(ii) Kriteret e shpërndarjes së ngarkesës mësimore;</li> <li>(iii) Trajtimi i rasteve të ekselencës së personelit; si edhe</li> <li>(iv) Kriteret dhe procedurat e marrjes lejë në UET.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>UET ka të ndërtuara edhe procedurat e rekrutimit bazuar edhe në statusin e tij dhe në kuadrin e përgjithshëm rregullues. Njoftimet publikohen në faqen zyrtare të universitetit si edhe në gazetën “Liberale” pjesë e UET Press. Përzgjedhja e stafit kalon në disa faza seleksionimi, duke filluar që me aplikimin me dosjen dhe më pas duke kaluar edhe në fazën e konkursit/ intervistimit. Për stafin akademik që kërkohet me profile të veçanta, secili departament harton edhe kriteret specifike në varësi të nevojës që ka programi i studimit. Procedurat e përzgjedhjes dhe vlerësimit të kandidatëve janë të përcaktuara edhe në rregulloret e UET</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë</p>	<p>UET ka të ndërtuara edhe procedurat e rekrutimit bazuar edhe në statusin e tij dhe në kuadrin e përgjithshëm rregullues. Njoftimet publikohen në faqen zyrtare të universitetit si edhe në gazetën “Liberale” pjesë e UET Press. Përzgjedhja e stafit kalon në disa faza seleksionimi, duke filluar që me aplikimin me dosjen dhe më pas duke kaluar edhe në fazën e konkursit/ intervistimit. Për stafin akademik që kërkohet me profile të veçanta, secili departament harton edhe kriteret specifike në varësi të nevojës që ka programi i studimit. Procedurat e përzgjedhjes dhe vlerësimit të kandidatëve janë të përcaktuara edhe në rregulloret e UET</p>



Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 52



përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	<i>Referenca:</i> 2. Statuti I UET 5. Rregullore e UET 11. Dokumenti G. Rregullore për Burime Njerezore. 11.1 Shembull thirrje për staf akademik			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### Standardi IV.2

**Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësi të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	<p>Bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga UET dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në institucion, GVJ vëren se është ndërmarrë angazhimi i duhur duke krijuar mjedis dhe infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e detyrave në mënyrë profesionale nga personeli i institucionit.</p> <p>Stafi i departamentit kishte në dispozicion zyra me hapësira të mjaftueshme dhe të pajisura me infrastrukturën e nevojshme, kondicionim, ndriçim dhe poste pune të pajisura me kompjuter personal. (Do të përshkruhet më në detaje në Standardin IV.3)</p> <p>Në kuadrin e krijimit të mundësi të barabarta për kryerjen e detyrave në funksion të mësimdhënies, stafi akademik nxitet të marrë pjesë në aktivitete/workshope/seminare në drejtim të forcimit dhe diversifikimit të metodave të mësimdhënies. Po kështu stafi akademik inkurajohet të përfshihet edhe në projekte të ndryshme sipas specifikave të lëndëve dhe kualifikimeve të tij. Gjithashtu i gjithë stafi përfshihet në trajnime si për metodologjinë e mësimdhënies, ashtu edhe për zbatimin e programeve të reja të Teknologjisë së Informacionit, përfshirjen në projekte, etj.</p> <p><i>Referenca:</i> 42. Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programeve të studimit</p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	<p>Bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga UET, GVJ vëren se ky institucion e ka të shprehur që në statusin e tij, në deklaratën e vizionit të tij, synimin për të qenë një universitet me staf cilësor, akademik e profesional. Për të vijuar me këtë qëllim, UET është i angazhuar në zhvillimin profesional të burimeve njerëzore akademike. Pedagogët nxiten të marrin pjesë në disa aktivitete. Të tilla mund të përmendim “Ditët e Studimeve Shqiptare”; pjesëmarrjen në projekte në kuadrin e Erasmus + ku bashkëpunohet edhe me universitet jashtë vendit; “Takimet Liberale të Dardhës”, “Shkolla Dimërore e Inovacionit”, etj. Sikurse është e saktësuar edhe në Strategjinë e Kërkimit Shkencor 2021-2025 “... Në këtë kuadër, në bashkëpunim me Qendrën e Metodologjisë dhe Kërkimit, do të ofrohen trajnime 1-ditore ose me gjatë (professional development and research) për të rritur aftësitë e stafit</p>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	

	<p>akademik për të ndërmarrë punë kërkimore të pavarur që të jetë e botueshme në revista shkencore me faktor impakti. Trajnimet do të jenë të ndarë në katër grupe: (1) Trajtime për Doktorantë; (2) Trajtime për Junior Researchers; (3) Trajtime për Senior Researchers; (4) Trajtime Metodologjike.”</p> <p>Në kuadrin e mësimdhënies online, të kushtëzuar nga pandemia COVID-19 janë zhvilluar trajnimi në përdorimin e formave interaktive online të mësimdhënies dhe njohja e të gjithë pedagogëve me sistemin LMS. Trajnimet janë zhvilluar nga zyra e TI.</p> <p>Edhe gjatë vizitës në institucion, GVJ u njoh nga Zyra e Burimeve Njerëzore me trajnimet e zhvilluara (i) mbi metodologjinë didaktike; dhe (ii) mbi metodologjinë e kërkimit shkencor.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>2. Statuti I UET</p> <p>3.1 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020</p> <p>3.2 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025</p> <p>5. Rregullore e UET</p> <p>55.1 Kalendar i aktiviteteve 2018-2021</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Mbështetur në dokumentacioni e përcjellë nga institucioni, GVJ vëren se UET kujdeset që si stafi akademik ashtu edhe ai mbështetës të jetë tërësisht i angazhuar në realizimin e programit të studimit. Ngarkesa e pedagogeve është brenda normave të caktuara.</p> <p>Nga analiza e stafit mësimdhënës për vitin mësimor aktual, rezultojnë se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Lëndët Baze (A) 35 kredite - zhvillohen të gjitha nga staf PAE</li> <li>▪ Lëndët Karakterizuese B 96 kredite - zhvillohen nga staf PAE 84 dhe dy lëndë me 12 kredite zhvillohen në kombinim të staff PAE dhe PAK</li> <li>▪ Lëndët Ndërdisciplinare/ Integruese (C) 24 kredite (sipas profileve) – Marrëdhënie Publike zhvillohen nga staf PAE 18 dhe një lëndë me 6 kredite zhvillohen në kombinim të staff PAE dhe PAK; - Gazetari zhvillohen nga staf PAE 12 dhe dy lëndë me 12 kredite zhvillohen në kombinim të staff PAE dhe PAK; Grafikë - Dizajn zhvillohen të gjitha nga staf PAE; Marketing zhvillohen të gjitha nga staf PAE</li> <li>▪ Lëndët Plotësuese 18 kredite – zhvillohen të gjitha nga staf PAE</li> <li>▪ Punimi i diplomës/ provimi 7 kredite</li> </ul> <p><u>Referenca për Standardin IV.2:</u></p> <p>5. Rregullore e UET</p> <p>11. Dokumenti G. Rregullore për Burime Njerëzore.</p> <p>0.2. Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB - Bachelor Komunikim</p> <p><u>Informacionet plotësuese të kërkuara gjatë vizitës</u></p> <p>14.3. Të dhënat për stafin akademik të angazhuar në programin e studimit 2021-2022</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

<b>Standardi IV.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	UET e filloi vitin mësimor 2021-2022 në vendndodhjen e re, “Rruga Xhanfise Keko”, Nd 56, Tiranë. Gjatë vizitës në institucion, GVJ u njoh me ambientet e reja të universitetit si për klasat mësimore, laboratorët, zyrat e profesoratit, si edhe ambientet mbështetëse, të përbashkëta, etj. Nga informacioni i përcjellë rezultoi se sipërfaqja totale e godinave ku është vendosur aktualisht UET është 7,545 m <sup>2</sup> . Godinat A dhe B janë ato kryesore për zhvillimin e programit mësimor, ku ndodhen edhe sallat e leksioneve seminareve dhe laboratorëve. Ndërsa godina C është aty ku janë strehuar laboratorët dhe sallat e arteve.
<b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	UET ka aktualisht në përdorim 45 salla mësimore, nga të cilat janë 17 laboratorë me 410 vende, 13 salla seminaresh me 353 vende dhe 15 salla leksionesh me 1138 vende. Sallat janë të pajisura me mjete didaktike dhe elektronike për të mundësuar zhvillimin interaktiv të mësimin. Sallat e leksionit kanë mjete audivizive për të mundësuar komunikim të qartë me studentët. UET gjithashtu ka: 9 laboratorë mësimorë (463 m <sup>2</sup> ); 7 laboratorë informatike (383m <sup>2</sup> ) dhe 1 sallë interneti (97 m <sup>2</sup> ). UET ka edhe sistemet e saj të komunikimit të brendshëm online të cilat mbështesin edhe procesin mësimor dhe facilitet për student siç janë UET LMS.
<b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Që prej themelimit deri në korrik 2021 UET ka qenë i vendosur në lokacionin Bulevardi “Gjergj Fishta” Nd. 70 H1. Sipas diskutimeve dhe takimit me anëtarë të stafit akademik, UET po planifikon ndërtimin e një kampusi të ri, tërësisht të ndërtuar duke ju përputhur stilit universitar.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.	<u>Referencë:</u> 42. <i>Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programeve të studimit</i> 42.1. <i>Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Rr. Xhanfize Keko</i>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e	Me infrastrukturën ekzistuese në UET dhe marrëveshjet institucionale të lidhura me institucione të tjera, është garantuar mundësia e zhvillimit të praktikave profesionale si edhe veprimtarive të tjera praktike. Nga informacionet e përcjella nga institucioni, janë 20 organizma me të cilët UET ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunim për praktikat. <u>Referencë:</u>

praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	32. Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkepunuese per programin e studimit dhe praktikat profesionale 32.1 Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			X

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	UET ka një bibliotekë mjaft të pasur në tituj dhe në literaturë që përfshin fushat e studimit që realizohen në këtë institucion. Edhe nga vizita në institucion u vu re përdorimi i bibliotekës nga studentët dhe pasja e një numri të larmishëm titujsh edhe të shkencave të komunikimit. Sipas rregullores së bibliotekës studentët mund të përdorin lirisht titujt aty. Biblioteka ndodhet në një sipërfaqe prej 35m2 në godinën A.
<b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Nga dokumentacioni i përcjellë nga institucioni rezulton se janë 1774 tituj si tekste për shkencat e komunikimit dhe 12 botime periodike në shqip dhe 31 botime periodike në anglisht që janë të përdorshme në UET. Tituj janë mjaft të larmishëm dhe përfshijnë botime që përdoren edhe si literaturë e detyrueshme edhe si literaturë plotësuese për shkencat e komunikimit.  <i>Referencë:</i> 45. <i>Inventari i teksteve në Bibliotekë për fushën e programit të studimit BA.pdf</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Universiteti përdor edhe platformat online të marrjes së literaturës. Kështu, ndër bibliotekat online në UET përdoret Sage, Ebsco dhe Questia, ku universiteti është abonuar. Universiteti ofron mundësinë e përdorimit të këtyre platformave pa pagesë. Kompjuterët e vendosur në sallë ofrojnë mundësinë e përdorimit të tyre nga studentët përgjatë gjithë orarit, duke u ndihmuar në realizimin e detyrave të tyre.
<b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Biblioteka e UET është pjesë e rrjetit COBISS (shërbimet online të bibliotekave, rrjet ky që përfshin të gjitha vendet e Evropës Juglindore, duke njëtrajtësuar edhe sistemin e katalogizimit. <i>Referencë: Vizita në bibliotekë</i>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Pasurimi i bibliotekës bëhet në mënyrë periodike çdo vit, krahas edhe përditësimit të syllabuseve të programeve të ndryshme të studimit. Nga dokumentacioni i përcjellë tregohet edhe proceduara e ndjekur për pasurimin dhe shtimin e fondit të librave në UET <i>Referencë:</i> 45.2. <i>E-IV-2 Formular për pasurimin e literatures në bibliotekë.pdf</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 56



<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Oraret e bibliotekës janë 09.00 - 20.00 në ditët e javës dhe 09:00- 17.00 për ditën e shtunë. Në ditët e provimeve biblioteka funksionon me orar më të zgjatur.</p> <p><i>Referencë: Vizita ne biblioteke</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga institucioni dhe informacionit të mbledhur gjatë vizitave në UET, GVJ konstaton se institucioni përdor sistemin/ programin UMIS (Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Universitetit) nëpërmjet të cilit menaxhohet informacioni personal për ecurinë e detyrimeve financiare të studentëve të të gjitha programeve të studimit nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre. Ky sistem ruan dhe menaxhon të gjithë informacionin për studentët për pjesën administrative, si edhe pjesën e të dhënave për bibliotekën, notat, adresat, rezultatet dhe ecurinë. Sistemi, sipas “Manualit të Përdoruesit të Sistemit UMIS” ka module të veçanta të tilla si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Moduli i Kontratave, regjistrimi i studentëve në UMS</li> <li>▪ Moduli i Koordinatorëve,</li> <li>▪ Moduli i Orarit</li> <li>▪ Moduli i Statistikave</li> <li>▪ Moduli i Menaxhimit të lëndëve dhe programeve</li> </ul> <p>Sistemi krijon mundësinë edhe të gjenerimit të të dhënave statistikore që duhen për menaxhimin institucional të gjithë universitetit dhe për të krijuar profile dhe për t’ju përgjigjur drejtimeve akademike dhe institucionale të zhvillimit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p><i>Referencë:</i> 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS 46.1 Urdher Mbi zbatimin e platformës LMS</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>UET ka edhe një sistem tjetër informativ i cili ndihmon procesin mësimor MOODLE (UET LMS). Ky sistem është i dedikuar për procesin mësimor duke mundësuar dhënien e leksioneve të studentët, materialet dhe informacionin, literaturën, plotësimin e anketimeve, materialeve audio dhe prezantimeve. Ky sistem jep akses të dedikuar për secilin nga stafi akademik dhe studentët dhe ka të regjistruar dhe të përditësuar informacionin e nevojshëm për lëndët e programit të</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe</p>	

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 57

module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	studimit, për çdo semestër, akses në literaturën e lëndëve, si dhe pedagogët përgjegjës për lëndët. Në këtë platformë organizohet dhe administrohet procesi, materialet, format e vlerësimit të dijeve dhe forumet e diskutimit online të studentëve me pedagogun në funksion të zhvillimit të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies.  <i>Referencë:</i> 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS 46.1 Urdher Mbi zbatimin e platformes LMS								
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Mbështetur në dokumentacionin e përcjellë nga institucioni dhe informacionit të mbledhur gjatë vizitave në UET, GVJ konstaton se institucioni e përdor sistemin LMS për të gjeneruar informacione lidhur me (i) Ngarkesën e Pedagogut dhe procesin mësimor të zhvilluar; (ii) Mbarëvajtjen e procesit akademik; (iii) Vlerësimin online të pedagogut, proces që realizohet çdo semestër. Nga ky sistem gjenerohen në kohë reale raporte, të dhëna për organet drejtuese dhe titullarët për performancën e çdo pedagogu, numrin e studentëve të përfshirë për çdo proces vlerësimi.  <i>Referencë:</i> 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS 46.1 Urdher Mbi zbatimin e platformes LMS 46.2 UET LMS - Guide per pedagogun 46.3 UET_LMS_Guide per studentet 46.4 Video-trajtime mbi sistemin TEAMS_LMS								
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	GVJ konstaton se UET ka në funksion faqen zyrtare online, <a href="https://uet.edu.al/">https://uet.edu.al/</a> një faqe dinamike në të cilën publikohet informacion mbi programet e studimit, strukturën organizative të institucionit, fakulteteve, personelin akademik, aktivitete të ndryshme në lidhje me jetën akademike, studentore, ato të zhvilluara në bashkëpunim me partnerë të ndryshëm në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Informacioni i publikuar azhurnohet në mënyrë të vazhduar. Ai është edhe në gjuhën shqipe edhe në gjuhën angleze.  <i>Referencë:</i> 48. Dokumenti E.V. Politikat e prezantimit dhe promovimit të UET online								
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

#### Standardi IV.6



**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të	Administratori edhe Zyra e Financës së UET janë përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e planit buxhetor të institucionit. Raportet dhe

<p>programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve bëhet për të gjithë institucionin dhe nuk bëhet për programe të veçanta studimi. Gjatë takimit me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm në institucion na u theksua se institucioni bën planifikimin për buxhetin e vitit pasardhës me fillimin e vitit akademik. Ky buxhet detajohet më pas duke u bërë parashikimin edhe mbi baza mujore, për nivelin e të ardhurave dhe shpenzimeve.</p> <p>Institucioni nuk përgatit buxhet specifik për secilin program studimi, pasi realizimi i planeve të tilla të detajuara është i pamundur për shkak se pedagogët japin mësim në disa programe studimi dhe po kështu edhe shpenzime të tjera materiale nuk është e mundur të ndahen sipas programeve.</p> <p><u>Referencë:</u> 0.2. Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB - Bachelor Komunikim Tabelat 18 "Të ardhurat nga financiamet ne tre vitet e fundit"</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Plani i shpenzimeve bëhet për të gjithë institucionin dhe ai përmban të gjithë zërat e nevojshëm për mbarëvajtjen institucionale, për ecurinë e programeve të studimit.</p> <p>Shpenzimet administrative janë të përbashkëta për të gjitha programet e studimit. Në planifikim përfshihen të gjitha zërat, si shpenzimet ato për stafin akademik dhe administrativ, teknologjike, operacionale, bibliotekat, akseset, stoftware, etj.</p> <p><u>Referencë:</u> 0.2. Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB - Bachelor Komunikim Tabelat 18 "Të ardhurat nga financiamet ne tre vitet e fundit" 49. Të dhëna mbi koston për student (Aneks Tabela 18.1) 50. Të ardhura dhe financime të ndryshme (Aneks Tabela 18.2) 50.1 Pasqyrat Financiare 2018 me shënime 50.2 Pasqyrat Financiare 2019 me shënime 50.3 Pasqyrat Financiare 2020 me shënime</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Institucioni kryen auditim të përvitshëm. Auditimi kryhet nga zyra të licensuara të auditimit. Sipas RVB në vitet 2016-2017 kompania "Deloitte Albania" Për periudhën 2018-2020 auditimi është kryer nga kompani të ndryshme private.</p> <p>Raporti i përmban të dhënat financiare për institucionin.</p> <p>Raportet e auditimit japin detaje dhe transparencën financiare për institucionin në tërësi.</p> <p><u>Referencë:</u> 0.2. Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB - Bachelor Komunikim Tabelat 18 "Të ardhurat nga financiamet ne tre vitet e fundit"</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe</p>	<p>50.4 Raport auditimi viti 2018 50.5 Raport auditimi viti 2019 50.6 Raport auditimi viti 2020</p>

<p>planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>				
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Mbështetur në dokumentacionin e përcjellë nga institucioni dhe specifikisht të ardhurat e pasqyruara në anekset e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm/ Tabelave përmbledhëse 18/2 rezulton shifra të ardhurash që sigurohen nga tre burime kryesore:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Tarifat e shkollimit;</li> <li>• Donacionet, aktivitetet siguroese, fondacione, etj., si edhe</li> <li>• Aktivitetet tregtare (qiradhënie, provime, vërtetime).</li> </ul> <p>Nga raporti i RVB në vitet 2018- 2020 institucioni ka pasur rënie të të ardhurave në të tre zërat kryesorë dhe më shumë kjo vërehet tek të ardhurat e siguruara nga tarifat e shkollimit nga studentët. Ndërsa për donacionet, aktivitetet siguroese, fondacione, në vitin 2019 ka pasur rritje, por përsëri ka vijuar rënia në 2020. Sikurse shihet edhe nga tabela 18/1 krahas rënies së të ardhurave në total kanë rënë gradualisht edhe kosto për student.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>0.2. Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB - Bachelor Komunikim Tabelat 18 “Të ardhurat nga financiamet ne tre vitet e fundit”</p> <p>49.Të dhëna mbi koston për student (Aneks Tabela 18.1)</p> <p>50. Të ardhura dhe financime të ndryshme (Aneks Tabela 18.2)</p> <p>50.1 Pasqyrat Financiare 2018 me shënime</p> <p>50.2 Pasqyrat Financiare 2019 me shënime</p> <p>50.3 Pasqyrat Financiare 2020 me shënime</p> <p>50.4 Raport auditimi viti 2018</p> <p>50.5 Raport auditimi viti 2019</p> <p>50.6 Raport auditimi viti 2020</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p><b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p><b>X</b></p>
---	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	--

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Nga tërësia e dokumentacionin të vënë në dispozicion nga institucioni, rregullore dhe baza nënligjore GVJ mendon se UET e bazon veprimtarinë e tij në “Rregullore e UET” e cilësuar si dokumenti themelor nga derivojnë edhe rregulloret specifike të programeve. Rregullorja mësimore e “Rregullore Mësimore Ba Komunikim” përshkruan hapat nëpër të cilat duhet të kalojë i gjithë procesi me studentët që nga momenti i regjistrimit deri në diplomimin përfundimtar. Sipas nënplikave të veçanta, kjo rregullore jep Kriteret e pranimit, tërësinë e programit të studimit, kreditet, mënyrën e vlerësimit të njohurive dhe deri tek procesi i diplomimit.</p> <p>Dokumente të tjera të rëndësishme janë ato të lidhura me vlerësimin e studentëve, formatin e tezës së provimit, dokumente mbi veprimtarinë e sekretarisë mësimore, mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik, mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin , etj.</p> <p>Të gjitha këto dokumentacione janë të bazuar në rregulloren e brendshme të UET dhe Statutin e UET.</p> <p>UET i ka këto material edhe në “Guida UET” e cila përditësohet çdo vit akademik dhe jep informacione të përgjithshme për studentët. <a href="https://uet.edu.al/wp-content/uploads/2021/10/broshura-2020-2021.pdf">https://uet.edu.al/wp-content/uploads/2021/10/broshura-2020-2021.pdf</a></p> <p>Të gjitha këto informacione dhe bazë dokumentare, akte nënligjore të ndërtuara dhe politikat institucionale në UET garantojnë barazinë dhe të drejta të barabarta për studentet në programet e studimit</p> <p><i>Referencë:</i></p> <p>2. Statuti i UET</p> <p>5. Rregullore e UET</p> <p>7. RREGULLORE MËSIMORE BA Komunikim</p> <p>7.2 Dokumenti A.IV. Sistemi i vlerësimit të studentëve (1)</p> <p>7.3 Formatin e Tezës së Provimit Përfundimtar</p> <p>9. Dokumenti E.I. Mbi funksionimin e Sekretarisë Mësimore</p> <p><a href="https://uet.edu.al/wp-content/uploads/2021/10/broshura-2020-2021.pdf">https://uet.edu.al/wp-content/uploads/2021/10/broshura-2020-2021.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Informacioni kryesor që u nevojitet studentëve është i publikuar në faqen online të UET, të tilla si: (i) si të aplikoni, (ii) transfero studimet, (iii) bursa, (iv) apliko për financim, (v) guida UET, (vi) biblioteka UET. Në një nënfaqe jepen edhe degët dhe mundësitë e studimit në UET. Informacioni është publik dhe i lehtë për t’u kuptuar.</p> <p>Pas regjistrimit dhe fillimit të studimeve, një mjet shumë i mirë për studentët në programet e studimit në UET për komunikim është edhe (Learning Management System).</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë



E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 61

	<p><u>Referencë:</u>  <a href="https://uet.edu.al/si-te-aplikojme/">https://uet.edu.al/si-te-aplikojme/</a>  <a href="https://uet.edu.al/transferimi-i-studimeve-ne-uet/">https://uet.edu.al/transferimi-i-studimeve-ne-uet/</a>  <a href="https://uet.edu.al/apliko-per-burse/">https://uet.edu.al/apliko-per-burse/</a>  <a href="https://bankacredins.com/financim-per-studentet-e-uet/">https://bankacredins.com/financim-per-studentet-e-uet/</a>  <a href="https://uet.edu.al/wp-content/uploads/2021/10/broshura-2020-2021.pdf">https://uet.edu.al/wp-content/uploads/2021/10/broshura-2020-2021.pdf</a>  <a href="https://uet.edu.al/biblioteka/">https://uet.edu.al/biblioteka/</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>UET harton kritere për studentët në varësi të programit të studimeve. Ndërsa për kriteret e përgjithshme ato janë të përcaktuar nga aktet nënligjore të ndërtuara nga Ministria e Arsimit. Studentët e programit të studimit të ciklit të parë në komunikim nuk ka kritere të veçanta, pasi njohuritë e përgjithshme mjaftojnë dhe nuk kanë kërkesa specifike siç mund të jenë studentët e degëve të arteve që testohen për aftësi të ndryshme. Sipas rregullores mësimore BA në komunikim të UET, pika 2 e saj përcakton kriteret e pranimit në këtë program studimi (të cituara më poshtë):</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>“Për t'u pranuar në këtë program studimi kandidati/ studentit duhet të ketë përfunduar me sukses provimet e detyrueshme të Maturës Shtetërore, të plotësojë kriterin e notës mesatare të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi, dhe të zotërojë një diplomë të shkollës së mesme të përgjithshme me kohëzgjatje tre vjet, ose sipas sistemit të vjetër me kohëzgjatje katër vjet, ose dhe shkollë të mesme profesionale.</p> <p>2.2 Kandidati mund të ketë edhe diplomë të lëshuar nga një institucion jashtë vendit, e cila duhet të njihet nga Ministria përgjegjëse për arsimin, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p>2.3 Në këtë program studimi pranohen edhe kandidatë/ studentë të cilët kanë një diplomë universitare të marrë në një institucion të arsimit të lartë brenda ose jashtë vendit dhe kërkojnë të ndjekin një program të dytë studimi. Në rastet kur studentit kërkohet njohje të krediteve, procesi i njohjes dhe vlerësimit të programit të studimit bëhet nga Departamenti përgjegjës për programin ku studentit kërkohet të regjistrohet.</p> <p>2.4 Kandidatët pranohen në varësi të kapaciteteve infrastrukurore dhe akademike të UET-it dhe sipas kriterëve specifike që mund të përcaktohen paraprakisht nga Departamenti. Numri maksimal i studentëve që mund të regjistrohen dhe mënyrat e përzgjedhjes së tyre, përcaktohen me vendim të Senatit Akademik dhe bëhen publike çdo fillim viti akademik para fillimit të regjistrimeve.</p> <p>2.5 Dokumentacioni për regjistrim dorëzohet nga i interesuari në Zyrën e Kontratave, e cila ndjek procedurën për regjistrimin e tij.</p> <p>2.6 Në fillim të vitit akademik organizohet java orientuese, ku mbahen takime dhe leksione për shpjegimin e sistemit të studimeve, të rregulloreve dhe të procedurave administrative në UET për studentët e rinj, si dhe kurse parapërgatitore ekstra-kurrikulare.</p> <p>2.7 Lista përfundimtare e studentëve të pranuar i njoftohet Qendrës së Shërbimeve Arsimore brenda afatit ligjor të përcaktuar.</p>

	<p>2.8 Kryerja e pagesës së tarifës së regjistrimit, sipas kushteve dhe përcaktimeve të kontratës përkatëse mes UET-it dhe Studentit, është kusht i domosdoshëm për hyrjen në fuqi të kontratës së lidhur.” Në procesin e pranimit studentët njihen edhe me natyrën e programit të studimit që ata kanë përzgjedhur.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>UET ndërtuar planin e tij për promovimin e programeve të studimit duke nisur që prej muajve të parë të vitit të ri. Një mjet është panairi “Work &amp; study”, takimet informuese me gjimnazistët në shumë qytete të mëdha të vendit. Ndër aktivitetet e tjera janë realizuara për këtë janë “Akademia e të folurit publik”, “Master class me të ftuar në auditor”, etj.</p> <p>UET është i pranishëm edhe në rrjetet sociale, Facebook dhe Twitter me anën e të cilëve mund të komunikojë dhe promovojë universitetin dhe programet specifike të studimeve.</p> <p>Faqja online e UET është një burim i gjerë informacioni dhe ajo përditësohet në mënyrë periodike. Këto informacione janë kontakti i parë me studentët, dhe vijimësia lidhet me informacionin që jepet nga zyrat specifike dhe nga pedagogët në varësi të programeve të studimit. Gjithashtu një burim i mirë janë edhe materialet e shkruara, fletëpalosje/ broshura si edhe në mediat vizive spote TV dhe prezencë të pedagogëve në emisione televizive. Java e parë e fillimit të viti shkollor është orientuese, me regjistrime, këshillime, etj.</p> <p><u>Referencë:</u> 7. RREGULLORE MËSIMORE BA Komunikim <a href="https://uet.edu.al/si-te-aplikojme/">https://uet.edu.al/si-te-aplikojme/</a> <a href="https://uet.edu.al/transferimi-i-studimeve-ne-uet/">https://uet.edu.al/transferimi-i-studimeve-ne-uet/</a> <a href="https://uet.edu.al/apliko-per-burse/">https://uet.edu.al/apliko-per-burse/</a> <a href="https://bankacredins.com/financim-per-studentet-e-uet/">https://bankacredins.com/financim-per-studentet-e-uet/</a> <a href="https://uet.edu.al/wp-content/uploads/2021/10/broshura-2020-2021.pdf">https://uet.edu.al/wp-content/uploads/2021/10/broshura-2020-2021.pdf</a> <a href="https://uet.edu.al/biblioteka/">https://uet.edu.al/biblioteka/</a></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

**Standardi V.2**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Mbështetur në dokumentacionin e përcjellë nga institucioni GVJ vlerëson se janë disa mënyra që institucioni vë në dispozicion për studentët informacionet e nevojshme. Platformat UMIS dhe LMS si edhe faqja online e UET japin të gjitha kriteret e nevojshme dhe informacionin e duhur për studentet për procedurat e fillimit të studimeve në programin e studimit. Gjithashtu, rregullorja e programit të studimit është dokumenti bazë që shërben për t’u dhënë studentëve gjithë informacionin</p>

	<p>e nevojshëm për programin e studimit. I gjithë ky informacion gjendet edhe në faqen zyrtare online të UET.</p> <p><u>Referencë:</u> 7. RREGULLORE MËSIMORE BA Komunikim <a href="https://uet.edu.al/si-te-aplikojme/">https://uet.edu.al/si-te-aplikojme/</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Mbështetur në legjislacionin aktual si edhe udhëzimet përkatëse të Ministrisë së Arsimit si edhe në përputhje me parimet e Kartës së Bolonjës, UET pranon transferime të studentëve në vitet ndërmjetëse nga shkollat e tjera të larta, vendase ose të huaja, publike ose jopublike, dhe lejon transferimin e studentëve të tij në shkolla të tjera të larta. UET ka miratuar dokumentin “Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin” i cili qartëson hapat/ procedurat që i shërbejnë njohjes dhe transferimit të studimeve.</p> <p>Dokumenti përshkruan:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Transferimi dhe njohja e krediteve;</li> <li>▪ Parime bazë të njohjes dhe të vlerësimit;</li> <li>▪ Transferimet brenda UET;</li> <li>▪ Paraekuivalentimi për aplikantët jashtë UET;</li> <li>▪ Regjistrimi paraprak;</li> <li>▪ Komisioni i Njohjes i Departamentit – KNJ;</li> <li>▪ Vlerësimi i programit të studimit/lëndëve;</li> <li>▪ Regjistrimi përfundimtar;</li> <li>▪ Transferimi dhe mobiliteti i studentëve në programet e Ciklit të Tretë.</li> </ul> <p><u>Referencë:</u> 7. RREGULLORE MËSIMORE BA Komunikim 28. Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin.pdf</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Syllabuset e lëndëve japin mënyrat e kriteret dhe procedurat e vlerësimit të studentëve, për secilin program studimi. Gjithashtu kriteret e vlerësimit të studentëve janë të vendosura edhe në Rregulloren mësimore të programit të studimit.</p> <p><u>Referencë:</u> 7. RREGULLORE MËSIMORE BA Komunikim 19. Silabus e lëndëve (dokument për secilën nga lëndët)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>UET ka hartuar dokumentacionin bazë që ndihmon studentët për t'u njohur me procedurat e tyre për përfundimin e programit, nëpërmjet punimit të diplomës apo provimit përfundimtar. Janë disa dokumente të cilat japin informacion të duke filluar që nga rregulloret e përgjithshme, rregulloret e programit të studimit dhe dokumentete specifike “Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit” si edhe dokumenti “Formati i Tezës së Provimit Përfundimtar” janë informacionet bazë që i shërbejnë studentit për të realizuar punimin e diplomës ose për të realizuar provimin përfundimtar. Afatet për dorëzimin e diplomave janë të përcaktuara edhe në kalendarin akademik që miratohet në fillim të vitit dhe bëhet publik për studentët. Gjithashtu, komunikimi me sekretarinë e departamentit jep info plotësuese të rëndësishme për studentet.</p>



	<p><u>Referencë:</u>  7. RREGULLORE MËSIMORE BA Komunikim  19. Silabus e lëndëve (dokument për secilën nga lëndët)  10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit  10.3 Kalendarit akademik 2020-2021</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Një praktikë e rëndësishme dhe e standardizuar tashmë në UET, në çdo fillim viti shkollor, është edhe java orientuese. Gjatë kësaj jave, pedagogë nga departamente të ndryshme japin info për studentët në varësi të programeve të studimit ku ata janë të interesuar. Kjo bëhet si në javën e regjistrimit, ashtu edhe në javën e orientimit.  Edhe guida e studimeve, e vendosur në faqen online të universitetit jep info të orjentuese për studentët në fillesat e tyre.</p> <p><u>Referencë:</u>  7. RREGULLORE MËSIMORE BA Komunikim  10.3 Kalendarit akademik 2020-2021  <a href="https://uet.edu.al/wp-content/uploads/2021/10/broshura-2020-2021.pdf">https://uet.edu.al/wp-content/uploads/2021/10/broshura-2020-2021.pdf</a></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

**Standardi V.3**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Dokumenti fillestar dhe më i rëndësishme për studentët në fillimet e tyre është Rregullorja e programit të studimit e cila jep gjithë informacionin e nevojshëm për strukturën organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.  Ky informacion jepet për studentët edhe nga Zyra e Kujdesit ndaj Studentit. Informacione jepen edhe gjatë këshillimit me stafin akademik përpara procesit të regjistrimit.</p> <p><u>Referencë:</u>  7. RREGULLORE MËSIMORE BA Komunikim  10.3 Kalendarit akademik 2020-2021</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Studentët në UET, që në momentin e këshillimit akademik dhe regjistrimit në programin e studimit marrin informacion për programin e lëndëve. Më pas në javën e këshillimit dhe me informacionin nga sekretaria mësimore dhe takimi me pedagogët ata marrin edhe syllabuset e lëndëve, me informacion të plotë për studentin për mënyrën se si janë të specifikuar lëndët dhe modulet mësimore, e veprimtaritë formuese. Ato përshkruajnë, temat, ngarkesën javore, literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar, format e kontrollit të dijeve etj.  Ky informacion jepet edhe në sistemim LMS.</p> <p><u>Referencë:</u>  7. RREGULLORE MËSIMORE BA Komunikim  19. Silabus e lëndëve (dokument për secilën nga lëndët)</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 65

<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>UET e konsideron si shumë të rëndësishme njohjen e studenteve me mundësitë e tregut të punës. UET ka ngritur Bordet e tregut të punës për çdo fakultet/departament dhe komunikimi me to është ndihmesë për studentët për të njohur potencialet e tyre të punësimit.</p> <p>Info për tregun e punës jepen në disa forma. Një ndër to është informacioni i përcjellë nga Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit. Edhe koordinatori e departamentit, po ashtu u përcjell informacione mbi kërkesat nga tregu i punës, edhe nëpërmjet postimeve në sistemet online LMS.</p> <p>Gjithashtu UET organizon pothuajse çdo vit panairin e tregut të punës, ku janë të mbledhur kompani të ndryshme të cilat vijnë dhe paraqesin ofertat e tyre për punonjës dhe njëkohësisht janë edhe një formë e studentëve për t'u përballuar për herë të parë me një intervistë reale pune. Në periudhën 2020-2021 nuk ishin zhvilluar panire pune me kontakte fizike, për arsye të kushteve të pandemisë.</p> <p>Gjatë takimit të GVJ me studentët ata u shprehën pozitivisht për mundësitë që u ofron UET për punësim. Disa prej tyre kishin gjetur punët aktuale nëpërmjet këtyre kontakteve.</p> <p><i>Referencë:</i></p> <p>12. Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit</p> <p>12.1 Bordi i Tregut të Punës 2017-2021</p> <p>12.2. Poster Panairi i Punës 2018 dhe 2019</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Informacioni i studentëve të UET lidhur me programin e studimit jepet në forma të ndryshme. (Me nënshkrimin e kontratës së studimit në program, nëpërmjet guidës së studentët, nëpërmjet sistemit të komunikimit online, si edhe me sekretarinë mësimore).</p> <p>Koordinatorja e fakultetit është një pikë lidhëse shumë efektive midis studentëve dhe universitetit edhe nga pikëpamja organizative.</p> <p>Që në fillim të procesit të regjistrimit, studentet e UET kanë kredencialet e tyre të email dhe mundësinë e aksesit në LMS për të marrë gjithë infon e nevojshme. Kjo platformë krijon mundësinë edhe të komunikimit me pedagogët në distancë. Edhe sistemi LMS është mjaft i përdorshëm për studentët për dhënien e informacionit lidhur me kalendarin akademik, procesin mësimor, aktivitetet ekstrakurrikulare, etj.</p> <p><i>Referencë:</i></p> <p>7. RREGULLORE MËSIMORE BA Komunikim</p> <p>9. Dokumenti E.I. Mbi funksionimin e Sekretarise Mesimore</p> <p>10.4. Kalendar akademik 2021-2022</p> <p>46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS</p> <p>46.1 Urdher Mbi zbatimin e platformes LMS</p> <p>46.3 UET LMS Guide per studentet</p>			
<p><b>Kriteri 5</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p><i>Referencë:</i></p> <p>7. RREGULLORE MËSIMORE BA Komunikim</p> <p>9. Dokumenti E.I. Mbi funksionimin e Sekretarise Mesimore</p> <p>10.4. Kalendar akademik 2021-2022</p> <p>46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS</p> <p>46.1 Urdher Mbi zbatimin e platformes LMS</p> <p>46.3 UET LMS Guide per studentet</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

**Standardi V.4**

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.</p>	<p>Në Sekretarinë Mësimore në UET gjenden informacione të plota për statistikat e studentëve në hyrje dhe në dalje për secilin fakultet dhe program studimi. Edhe gjatë vizitës së GVJ në Sekretarinë Mësimore u njohën me mënyrën e mbajtjes së informacionit dhe ruajtjen e tij sipas rregulloreve.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore nr i studentëve të regjistruar ndër vite është si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Viti akademik 2018- 2019: 48 studentë të regjistruar; 8 të çregjistruar; 1 pa numër matricullimi- <b>totali (40)</b></li> <li>- Viti akademik 2019- 2020: 25 studentë të regjistruar; 2 të çregjistruar; 1 pa numër matricullimi- <b>totali (23)</b></li> <li>- Viti akademik 2020- 2021: 40 studentë të regjistruar; 3 të çregjistruar- <b>totali (37)</b></li> <li>- Viti akademik 2021- 2022: 28 studentë të regjistruar; 8 me transferim- <b>totali (28)</b></li> </ul> <p>Dokumenti “BA Komunikim_ Cilesia ne hyrje dhe dalje” jep informacione për studentët në vitet 2016-2022 për cilësinë e tyre në hyrje dhe ecurinë e provimeve gjatë viteve, deri në diplomim. Sekretaria mësimore, me anë të regjistrave të saj, ka statistikat e studentëve të regjistruar në programet e studimit sipas viteve, rezultatet e provimeve, lëvizjet, largimet, cilësinë e studentëve në hyrje, etj.</p> <p>Ka një diferencë në numrin e studentëve të raportuar në dokumentin “27. BA Komunikim_ Cilesia ne hyrje dhe dalje” dhe informacionit të marrë nga sekretaria mësimore.</p> <p><i>Referencë:</i></p> <p>9. Dokumenti E.I. Mbi funksionimin e Sekretarise Mesimore</p> <p>27. BA Komunikim_ Cilesia ne hyrje dhe dalje</p> <p>38. Analiza e departamentit.pdf</p> <p>46. Manuali i perdoruesit te sistemit UMIS</p> <p>46.1 Urdher Mbi zbatimin e platformes LMS</p> <p>Vizita e GVJ në UET – 28 prill 2022</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Në Sekretarinë Mësimore, gjendet dosja e çdo studenti me informacionin e duhur, më të dhënat e rezultateve në provime dhe ecurinë vit pas viti. Ky informacion është i ruajtur edhe në sistemin elektronik të UET, si edhe në regjistrat e depozituar në sekretarinë mësimore.</p> <p>GVJ u njoh me këto regjistra gjatë vizitës në institucion.</p>



	<p><u>Referencë:</u>  9. Dokumenti E.I. Mbi funksionimin e Sekretarise Mesimore  27. BA Komunikim_ Cilesia ne hyrje dhe dalje  Vizita e GVJ në UET – 28 prill 2022</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>GVJ u njoh me të dhënat statistikore që mbahen për studentët në format elektronik dhe në formatin e regjistrave fizikë pranë sekretarisë mësimore. Sistemi UMIS dhe LMS që ka ndërtuar UET krijojnë mundësinë e menaxhimit dhe ruajtjes së të dhënëve statistikore të studentëve si edhe të gjenerojë statistika të ndryshme. Këto të dhëna ruhen dhe janë të aksesueshëm vetëm nga personat e ngarkuar nga zyra e TI për këtë qëllim.</p> <p>Në Sekretarinë Mësimore, gjendet dosja e çdo studenti me informacionin e duhur, më të dhënat e rezultateve në provime dhe ecurinë vit pas viti. Ky informacion është i ruajtur edhe në sistemin elektronik të UET, si edhe në regjistrat e depozituar në sekretarinë mësimore.</p> <p><u>Referencë:</u>  9. Dokumenti E.I. Mbi funksionimin e Sekretarise Mesimore  46. Manuali i perdoruesit te sistemit UMIS  46.1 Urdher Mbi zbatimin e platformes LMS  Vizita e GVJ në UET – 28 prill 2022</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Komunikim” me profilet “Gazetari”, “Marrëdhënie Publike”, “Grafikë Dizajn” dhe “Marketing” zhvillohet në Departamentin e Shkencave Humane dhe të Komunikimit, që është pjesë e Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale. Në dokumentin e dhënë nga UET “Analiza e departamentit” jepet një analizë e bërë nga departamenti lidhur me ecurinë e këtij programi.</p> <p>Gjithashtu në dokumentet shtesë që GVJ kërkoi gjatë vizitës jepen informacione lidhur me mbledhjet e zhvilluar me praninë e studentëve për të diskutuar për tematika të ndryshme.</p> <p><u>Referencë:</u>  27. BA Komunikim_ Cilesia ne hyrje dhe dalje  38. Analiza e departamentit.pdf  Vizita e GVJ në UET – 28 prill 2022</p> <p><u>Informacionet plotësuese të kërkuara gjatë vizitës</u>  2.1. E-mail_Mbledhje e hapur me studentë - 2021  2.2. E-mail_Mbledhje e hapur me studentë - 2022  2.3. Mbledhje e hapur me studentë - 2021  2.4. Mbledhje e hapur me studentë - 2022</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				X

**Standardi V.5**

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Statuti i UET ka vendosur ndërtimin e disa prej organeve të UET ku janë të përfshirë edhe studentë nga Këshilli Studentor. Sipas Statutit/ Kreun VII/ Neni 51 saktësohet Këshilli Studentor dhe pjesëmarrjen në qeverisjen e UET. Aty saktësohet se Këshilli i Studentëve është organ i cili zgjidhet çdo dy vjet me votat e studentëve dhe mbështeten nga legjislacioni në fuqi. Këshillat e Studentëve shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes në UET si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtarinë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve dhe zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive, etj.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Studentët janë të përfaqësuar në:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Këshillimin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (një anëtar që zgjidhet nga Këshilli Studentor);</li> <li>2. Këshillin e Etikës (një anëtar i rekomandohet Rektorit nga Këshilli Studentor);</li> <li>3. Senatin Akademik (Kryetari i Këshillit Studentor dhe 2 studentë anëtarë që zgjidhen me mandat 2-vjeçar).</li> </ol>
	<p>Duke shikuar dokumentacionin e përcjellë dhe nga vizitat në UET GVJ vëren se mënyrat për përfshirjen e studentëve në organizmat vendimmarrëse të UET dhe marrjen e mendimit të tyre ishin të ndryshme. Opinioni i studentëve merrej në UET në mënyrë anonime nëpërmjet pyetësorëve online, me frekuencë semestrale (dy herë në vit). Rezultatet e pyetësorëve për pedagogët u jepen atyre dhe shërbejnë si një pikë orientuese. Gjithashtu studentët janë pjesëmarrës në mbledhjet e departamentit si edhe në fokus grupe për marrjen e informacionit nga studentët.</p> <p>Një nga studentët e programit të studimit Bachelor në “Komunikim” ka qenë pjesë e hartimit të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm për këtë program studimi.</p> <p>Gjatë takimit të GVJ me grupin e studenteve në program, ata u shprehën pozitivisht për mundësitë që u ofron UET në diskutime dhe kontakte të afërta me pedagogët dhe departamentin.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>2. Statuti i UET</p> <p>30.4. Urdhër administrativ mbi përbërjen e KSBC</p> <p><u>Informacionet plotësuese të kërkuara gjatë vizitës</u></p> <p>2.1. E-mail_Mbledhje e hapur me studentë - 2021</p> <p>2.2. E-mail_Mbledhje e hapur me studentë - 2022</p> <p>2.3. Mbledhje e hapur me studentë - 2021</p> <p>2.4. Mbledhje e hapur me studentë - 2022</p> <p>11.2. Vlerësime online të stafit akademik</p>

	<p>11.4. Evidenca për zhvillimin e focus-grupeve_njoftimet_shpërndarja e Raporteve</p> <p>11.5. Ekstrakt - Raport i fokus grupeve_2021-2022 dhe Kalendari i takimeve</p> <p>18.1. Informacion nga Zyra e Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit mbi këshillimin e karrierës</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Programet mësimore si edhe tërësia e lëndëve dhe syllabuseve përditësohen dhe përshtaten me nevojat e zhvillimit të programeve mësimore, duke u bazuar në legjislacionin aktual. Në ndërtimin dhe shpërndarjen e ngarkesës mësimore, programi është shpërndarë në ngarkesë të njëtrajtshme midis semestrave.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Komunikim” me profilet “Gazetari”, “Marrëdhënie Publike”, “Grafikë Dizajn” dhe “Marketing” kreditet janë ndarë në mënyrë të barabartë nga 60 kredite në vit.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>5. Rregullore e UET</p> <p>7. RREGULLORE MËSIMORE BA Komunikim</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>UET organizon fokus grupe, pyetësorë online dhe mbledhje të hapura në departament për të marrë <i>feedback</i> dhe për të shikuar mundësitë e përmirësimit të programit të studimit.</p> <p>Studentët janë pjesëmarrës edhe në mbledhjet e hapura në departament që organizohen çdo fillim semestri.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>2. Statuti i UET</p> <p>7. RREGULLORE MËSIMORE BA Komunikim</p> <p><u>Informacionet plotësuese të kërkuara gjatë vizitës</u></p> <p>2.1. E-mail_Mbledhje e hapur me studentë - 2021</p> <p>2.2. E-mail_Mbledhje e hapur me studentë - 2022</p> <p>2.3. Mbledhje e hapur me studentë - 2021</p> <p>2.4. Mbledhje e hapur me studentë – 2022</p> <p>11.2. Vlerësime online të stafit akademik</p> <p>11.4. Evidenca për zhvillimin e focus-grupeve_njoftimet_shpërndarja e Raporteve</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/ pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Rregulloret e brendshme të UET si edhe rregullorja specifike e programit të studimit përcaktojnë edhe mënyrën e vlerësimit të studentëve. Specifikisht, mënyra e vlerësimit është detajuar edhe në syllabuset e secilës lëndë. Provimet janë të sekretuara dhe pas nxjerrjes së rezultateve, studentët kanë mundësinë të marrin sqarime nga pedagogët lidhur me procesin e vlerësimit. Në fund të çdo semestri, studentët nëpërmjet pyetësorëve shprehin opinionin e tyre për të gjitha aspektet e jetës studentore brenda institucionit.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>2. Statuti i UET</p> <p>7. RREGULLORE MËSIMORE BA Komunikim</p> <p><u>Informacionet plotësuese të kërkuara gjatë vizitës</u></p> <p>2.3. Mbledhje e hapur me studentë - 2021</p> <p>2.4. Mbledhje e hapur me studentë - 2022</p>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### Standardi V.6

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Mbështetur në informacionin e përcjellë nga institucioni, GVJ gjykon se UET ka procedura dhe njësi të posaçme për t'i shërbyer sa më mirë studentëve, bazuar edhe në aktet ligjore dhe rregullatore. UET ka të ngritur Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit. Bazuar në rregulloren specifike Zyra për Kujdesin ndaj Studentit ...shërben si burim primar i informacionit dhe këshillave rreth mundësive të studimit. Anëtarët e stafit ndihmojnë studentët të përfshihen në jetën e kampusit, mësojnë studentët në lidhje me politikat e Universitetit, ndërmjetësojnë mosmarrëveshjet organizative dhe individuale, këshillojnë programe dhe aktivitete të veçanta, mbështesin studentët për qeverinë studentore, ...”</p> <p>Zyra për Kujdesin ndaj Studentit ka për detyrë të ndërtojë komunikimin dhe informimin me studentët, përmes të cilave atë orientohen për të gjitha detajet e jetës studentore, si nga pikëpamja mësimore ashtu edhe për jetën në kampus. Kjo zyrë orienton edhe për aplikimin online për bursa si edhe aplikimin për bursa Erasmus, projekte, intershipe dhe punësime, etj.</p> <p>UET ka gjithashtu edhe Zyrën e Këshillimit të karrierës e cila në bashkëpunim edhe me këshilluesit e karrierës pranë çdo departamenti ndihmon studentët duke i mbështetur që nga hartimin e CV, letrës së motivimit &amp; korrespondencën me zyrat e Burimeve Njerëzore të kompanive/organizatave, si edhe këshillim të studentëve për faza të intervistës së punës.</p> <p><u>Referencë:</u> 12. Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit 27.2. Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/ njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në</p>	<p>Krahas Zyrës së Këshillimit të Karrierës siç u shpjegua në standardin e mësipërm, pranë çdo departamenti në UET është edhe një pedagog i cili është caktuar në rolin e këshilluesit të karrierës për studentët duke i orientuar ata në procesin e përzgjedhjes së drejtimit akademik, lëndëve me zgjedhje, vendosjen për praktikat profesionale, etj.</p> <p>Zyra e këshillimit të karrierës i ndihmon studentët edhe në drejtim të aplikimeve për kurse trajnimi dhe përfshirjes në projekte të ndryshme me “Qendrën UET, ashtu edhe për trajnime online dhe për shkëmbimin e studentëve në kuadër të projekteve ndërkombëtare.</p> <p><u>Referencë:</u></p>

institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	12. Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit 32.1 Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale			
<b>Kriteri 4.</b> Zyra/ njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteve drejtuese përkatëse.	Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit mbledh dhe përpunon edhe të dhënat e studentëve pas diplomimit. Studentët e parë në UET janë diplomuar në vitin 2009. Që prej asaj kohe UET ka krijuar edhe ALUMNI UET. Në faqen zyrtare online të universitetit <a href="https://uet.edu.al/uet-alumni/">https://uet.edu.al/uet-alumni/</a> ndodhen edhe informacione plotësuese për alumni dhe aktivitetet e tyre në UET. Sikurse shihet edhe në këtë faqe çdo vit UET organizon aktivitete të ndryshme (UET Alumni festival, UET Çmimi i karrierës, etj). Këto aktivitete lidhen edhe me tregun e punës dhe Bordet e Tregut të punës, duke i dhënë një mundësi dhe shembull studentëve aktualë në UET për të njohur dhe marrë eksperiencat e tregut të punës. <u>Referencë:</u> 12. Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit 29. Shkalla e punësimit ALUMNI 2017-2020 <a href="https://uet.edu.al/uet-alumni/">https://uet.edu.al/uet-alumni/</a>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X



## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR


Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Mbështetur në Ligjin “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në ILA, në Republikën e Shqipërisë” UET ka ndërtuar një bazë rregullatore dhe një sistem të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Dokumentet kryesore mbi të cilat bazohet janë aktet rregullatore të aprovuara si “Statuti i UET”, “Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë”, “Plani veprimit KSBC”, “Manuali për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë”, “Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë”, “Urdhër Administrativ mbi përbërjen e KSBC”, “Metodologjia e punës së KSBC”.</p> <p>E gjithë kjo bazë rregullatore ka shërbyer për ngritjen e Komisionit për Sigurimin e Brendshme të Cilësisë. Ky komision ka të draftuar edhe planin e tij të veprimit për monitorim e cilësisë dhe arritjen e rezultateve.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>2. Statuti i UET</p> <p>8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshem te cilesise</p> <p>16. A.II. Kodi i Etikës</p> <p>30. Të dhëna për individët e angazhuar në KSBC</p> <p>30.1. Plani veprimit KSBC</p> <p>30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë</p> <p>30.3 Strategjia per sigurimin e brendshem te cilesise</p> <p>30.4. Urdhër administrativ mbi përbërjen e KSBC</p> <p>30.5 Metodologjia e punes se KSBC provimet</p> <p>30.7 Shperndarja e relacionit te KSBC mbi silabuset</p> <p>30.8. G-III-4-1 Formulari i vleresimit te pedagogut nga eprori-kolegu</p> <p>37. Format i relacionit për monitorimin e silabuseve</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Në zbatim të legjislacionit dhe bazës rregullatore të ndërtuar (siç u listua më sipër), UET ka ngritur Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë – KSBC, me objektiv themelor monitorimin dhe ruajtjen e brendshme të cilësisë. Gjithashtu Zyra e Standardeve dhe Cilësisë, është një tjetër organizëm i krijuar nga UET që kujdeset për hartimin, përditësimin dhe rishikimin e kuadrit rregullator të UET në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ajo ndërton politikat për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe kujdeset ti monitorojë ato.</p> <p>Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC) është rinovuar me urdhër nr. 19 të 12/11/2021 nga Rektori i UET. Komisioni përbëhet nga 11 anëtarë përfaqësues të brendshëm dhe një anëtar ekspert i jashtëm. Sipas dokumentit respektiv, anëtar i KSBC-së është edhe një</p>

	<p>student nga Këshilli i Studentëve. Sipas dokumentit të përcjellë studentit është i ndryshëm në çdo vit akademik.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>30. Të dhëna për individët e angazhuar në KSBC</p> <p>30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë</p> <p>30.3 Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p> <p>30.4. Urdhër administrativ mbi përbërjen e KSBC</p> <p>30.5 Metodologjia e punës së KSBC provimet</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Sigurimi i cilësisë realizohet nëpërmjet mekanizmave të ndryshme, siç janë mekanizmat e brendshme dhe të jashtëm. Ndër instrumentet e brendshme të sigurimit të cilësisë përmendim monitorimet, anketimet, bashkëpunimet me ekspertë të jashtëm dhe bordet e tregut të punës. Sigurimi i jashtëm i cilësisë realizohet në saj të bashkëpunimit me Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, ASCAL. Sipas informacionit nga Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, UET ka akredituar programin e studimit Bachelor në “Komunikim” si një ndër programet e para që u hap në vitin 2006 dhe diplomoi studentët e parë në vitin 2009. Vendimi i akreditimit të parë ka qenë nga Ministria e Arsimit, Nr. 246 datë 27.07.2009. Më pas po ky program studimi është akredituar me Urdhër nr. 162 datë 07.04.2016 të MASR (bazuar në Vendimin nr. 128 datë 18.02.2016 të Këshillit të Lartë të Akreditimit.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>0. RVB - BA_Komunikim – firmosur</p> <p>30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë</p> <p>30.3 Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>UET ka të hartuar Strategjinë për sigurimin e Brendshëm të cilësisë, 2017-2022. Materiali është në anglisht, ndërtuar sipas formatit të një projekti që ka zbatuar UET në lidhje me sigurimin e cilësisë. Megjithatë është material lirish të përdorshëm edhe në gjuhën angleze. Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë, përmban:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Vizionin, prioritetet dhe objektivat strategjikë;</li> <li>▪ Organizimin dhe menaxhimin e UET;</li> <li>▪ Organizimin dhe veprimin e Komisionit të sigurimit të cilësisë.</li> </ul> <p>Gjithashtu UET ka ndërtuar edhe Planin e Veprimit të KSCB, sipas viteve akademike. Dokumenti paraqet iniciativat apo komponentët lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë si për (i) mësimdhënien, mësim-nxënien dhe Vlerësimin (ii) Kërkimin shkencor, (iii) Mbështetjen e studentëve, dhe (iv) dhe sigurimin e cilësisë.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë</p> <p>30.1. Plani veprimit KSBC</p> <p>30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë</p> <p>30.3 Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë</p> <p>30.5 Metodologjia e punës së KSBC provimet</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				X

<b>Standardi VI.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>UET ka ngritur Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, KSCB. Ky komision harton planin e punës për secilin vit akademik për të gjitha programet e studimit. Në përbërje të grupit të KSCB janë edhe dy anëtarë nga Fakulteti i Shkencave Humane Edukimit dhe Arteve.</p> <p>Për të garantuar cilësinë, një rol të rëndësishëm luajnë edhe departamentet ku janë mbështetur dhe zhvillohen programet e studimit, si edhe Bordet e Tregut të Punës të cilat garantojnë përcjelljen e zhvillimeve dhe ecurisë që tregu i punës ka dhe kërkesat për përditësime të programeve mësimore.</p> <p><i>Referencë:</i>  8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë  30.1. Plani veprimi KSBC  30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë  30.3. Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë  30.5 Metodologjia e punës së KSBC provimet</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>KSCB në UET ka hartuar metodologjinë për kontrollin e provimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare. Sipas dokumentit përkatës institucioni studion dhe analizon syllabuset e lëndëve si edhe rezultate dhe testet e provimeve. Për provimet dhe vlerësimin e tyre, sondimi bëhet me kampion. Nëse janë deri në 50 provime shqyrtohen 20 prej tyre, nëse janë 51-100 provime, shqyrtohen 30 prej tyre dhe mbi 100 provime, shqyrtohen 50 prej tyre.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>KSCB në UET ka hartuar edhe metodologjinë për vlerësimin e syllabuseve për programet e studimit.</p> <p>Informacionet/ vlerësimet e përmbledhura përcillen si në nivel Rektorati edhe në nivel Departamenti ku zhvillohet programi i studimit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Komisioni KSCB jep edhe rekomandime në rast kur gjen problematika. Metodologjia e vlerësimit për programet e studimit është në rang universiteti, pra e njëtrajtësuar për të gjithë institucionin. (ndryshimet qëndrojnë në objektivat e programeve të studimit apo shkallët krahasuese, por metodologjia dhe instrumentet e përdorura janë të njëjta.)</p> <p>Dokumenti “Shpërndarja e relacionit të KSBC mbi syllabuset” pasqyron kanalet e komunikimit të KSBC për gjetjet dhe informacionin e marrë nga vrojtimit dhe monitorimet e saj.</p> <p><i>Referencë:</i>  30.5 Metodologjia e punës së KSBC provimet  30.7 Shpërndarja e relacionit të KSBC mbi silabuset  37. Formati i relacionit për monitorimin e silabuseve</p>

<p><b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>Nga informacioni i përcjellë në formë dokumentare nga Institucioni si edhe nga diskutimi me KSBC dhe Zyrën e Standardeve dhe Cilësisë, gjatë vizitës së GVJ në institucion u evidentua se informacionet e mbledhura nga monitorimet nga KSBC tregojnë se aktiviteti mësimor është në përputhje me standartet e vendosura. Instrumentet e marra si të drejtpërdrejta, ashtu edhe pyetësorët apo fokus grupet me studentët kanë sjellë informacione që kanë vlerësuar ecurinë e procesit mësimor. Dokumentet e përcjellë përfshijnë edhe komunikimin me email midis zyrave për transmetimin e informacionit të mbledhura nga Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë drejt rektoratit.</p> <p><u>Referencë:</u>  30.5 Metodologjia e punes se KSBC provimet  30.7 Shperndarja e relacionit te KSBC mbi silabuset  37. Formati i relacionit për monitorimin e silabuseve</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p>X</p>

<p><b>Standardi VI.3</b>  <b>Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Nga dokumentacioni i përcjellë nga institucioni, nga RVB si edhe nga takimi me KSBC, GVJ konstaton se vlerësimi i bërë nga KSBC nuk detajohet vetëm për një program specifik studimi. Vlerësimet bëhen në mënyrë periodike 2 herë në vit me anën e pyetësorëve. Për pedagogët e rinj, apo edhe në rastet kur mund të jenë evidentuar problematika nga kontaktet me studentët, atëherë përgjegjësi i departamentit ku zhvillohet programi i studimit, mund të hyjë edhe të asistojë/ vëzhgojë një orë mësimi së bashku me një koleg të fushës përkatëse të studimit. Në përfundim të vëzhgimit, pedagogut i jepet një format vlerësues, ku pasqyrohen anët pozitive si edhe çështjet të cilat kanë nevojë të adresohen më tej nga pedagogu.</p> <p>Ndërsa produkti final i KSCB është më i gjerë dhe përmban info për të gjithë departamentet dhe programet e studimit. Ndërkohë, ky informacion i kalon edhe departamenteve, të cilët nga ana e tyre mund ta thelloje analizën duke grupuar informacionet sipas programeve të studimit.</p> <p>Vlerësimet janë në nivel institucional dhe si të tilla janë pjesë e procesit të vetëvlerësimit në kuadër institucional.</p> <p><u>Referencë:</u>  30.5 Metodologjia e punes se KSBC provimet  30.7 Shperndarja e relacionit te KSBC mbi silabuset  <u>Informacionet plotësuese të kërkuara gjatë vizitës</u>  11.1. Formularë të plotësuar për monitorimin e mësimdhënies në audior</p>




	<p>11.2. Vlerësime online të stafit akademik</p> <p>11.3. Raporti për provimet Departamenti Shkenca Humane dhe Komunikim</p> <p>11.4. Evidenca për zhvillimin e focus-grupeve_njoftimet_shpërndarja e Raporteve</p> <p>20. Formati vetëvlerësimi i stafit akademik_follow-up</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Sipas informacioneve të përcjellë nga Institucioni janë disa nga metodat e mbledhjes së informacionit që përdoren nga UET për kryerjen e vlerësimit. Këto forma bazohen në Disa nga elementët që vlerësohen, bazuar edhe në metodologjinë e punës së aprovuar për KSBC, që lidhet me syllabuset, literatura e lëndëve, provimet. Sipas dokumentit të përcjellë, KSCB përdor sondazhet për testimin e provimeve. Kështu kampioni:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Nëse janë deri në 50 provime shqyrtohen 20 prej tyre;</li> <li>▪ Nëse janë 51-100 provime, shqyrtohen 30 prej tyre;</li> <li>▪ Nëse janë mbi 100 provime, shqyrtohen 50 prej tyre.</li> </ul> <p>Ndërsa syllabuset e lëndëve shqyrtohen të gjitha në fillim të vitit akademik/semestrit.</p> <p>Marrja e mendimit të studentëve realizohet nëpërmjet pyetësorëve online, çdo semestër, fokus grupet, apo mbledhjet e hapura të departamenteve.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë</p> <p>30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë</p> <p>30.3 Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë</p> <p>30.5 Metodologjia e punës së KSBC provimet</p> <p>30.7 Shpërndarja e relacionit të KSBC mbi silabuset</p> <p>30.8. G-III-4-1 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu</p> <p>37. Formati i relacionit për monitorimin e silabuseve</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Bërthama kryesore për ruajtjen e cilësisë së programit të studimit është departamenti dhe përgjegjësi i tij, aty ku është mbështetur programi specifik i studimit.</p> <p>Vlerësimi i drejtpërdrejtë bëhen me anën e “Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu”. Në formular jepen disa kriteret që vlerësohen sipas renditjes nga shumë mirë, mirë, pjesërisht dhe dobët. Kështu vlerësohet organizimi dhe qartësia, si edhe komunikimi me studentët. Sipas formularit element përbërës për organizimin dhe qartësinë janë: (i) Përcakton qëllimin e orës së mësimi; (ii) Është i organizuar dhe i qartë; (iii) E paraqet materialin në përshtatje me nivelin e klasës; (iv) Shpjegon ide të rëndësishme thjesht dhe qartë; (v) Jep shembuj konkretë; (vi) Përmbledh çështjet kryesore të leksionit / seminarit.</p> <p>Ndërsa për komunikimin me studentët janë këta elemente: (i) Komunikon qartë dhe dëgjohet mirë; (ii) Demonstron entuziazëm për subjektin që shpjegon; (iii) Përdor siç duhet mjete ndihmëse audio-vizuale; (iv) Inkurajon pjesëmarrjen e studentëve; (v) shpjegon</p>

	<p>materialin në më shumë se një mënyrë, (vi) U përgjigjet siç duhet pyetjeve dhe komenteve të studentëve; (vii) Reagon ndaj (pa)vëmendjes së studentëve; (viii) Përdor humor në masën dhe mënyrën e duhur; (ix) Demonstron njohje të mirë të subjektit; (x) I referohet studimeve të rëndësishme, njohuritë që zotëron i përdor me efikasitet në orën e mësimit, (xi) Inkurajon mendimin/ analizën kritike Si instrumente për matjen e cilësisë në UET:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Testet e standardizuara;</li> <li>• Dëgjime në auditor;</li> <li>• Vlerësime me pikë;</li> <li>• Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët;</li> <li>• Vëzhgime gjatë kryerjes së praktikave.</li> </ul> <p>Në periudhën 2020-2021, për arsye të mësimit në distance, shumë nga monitorimet janë zhvilluar online me asistencën e departament të TI dhe platformave të UET-LMS. Ndërkohë që përgjegjësit e departamentit kanë monitoruar cilësinë e mësimeve.</p> <p>UET ka ndërtuar edhe rregulloret tranzitore për vijimin e procesit mësues online, duke detajuar informacionin e duhur që kërkohet për të ruajtur standardet e cilësisë.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>30.5 Metodologjia e punës së KSBC provimet 30.7 Shpërndarja e relacionit të KSBC mbi silabuset</p> <p>5.1. Vendim_Mbi zhvillimin e procesit akademik në situatën e krijuar nga pandemia COVID-19 dhe Mbi leshimin e formave të diplomave 5.2. Rregullore tranzitore_Mbi vijimin e procesit akademik gjatë semestrit të parë të vitit akademik 2020-2021 në kushtet e pademisë COVID-19 5.3 Rregullore tranzitore_Per zhvillimin e procesit akademik gjatë Vitit Akademik 2020-2021</p> <p><u>Informacionet plotësuese të kërkuara gjatë vizitës</u></p> <p>11.1. Formularë të plotësuar për monitorimin e mësimeve në auditor 11.2. Vlerësime online të stafit akademik 11.3. Raporti për provimet Departamenti Shkenca Humane dhe Komunikim 11.4. Evidenca për zhvillimin e focus-grupeve_njoftimet_shpërndarja e Raporteve 11.5. Ekstrakt - Raport i fokus grupeve_2021-2022 dhe Kalendari i takimeve 20. Format vetëvlerësimi i stafit akademik_follow-up</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve,</p>	<p>Anketimet e studentëve për ecurinë e programit të studimit janë periodike me frekuencë dy herë në vit (çdo semestër). UET vlerëson veprimtarinë akademike nga pikëpamja cilësore edhe përmes sondazheve me studentët për të gjitha lëndët dhe të gjithë pedagogët. Marrja e vlerësimeve nga studentët realizohet përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Sondazheve me studentët e programit të studimit;</li> </ul>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 78

<p>të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sondazheve të vlerësimit të didaktikës dhe kurikulës;</li> <li>• Pyetje konceptuale;</li> <li>• Intervista</li> </ul> <p>Rezultatet përdoren nga drejtuesit e departamenteve/ fakulteteve/ si edhe institucionit për të reflektuar në vlerësimin e performancës së çdo pedagogu.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>30.5 Metodologjia e punes se KSBC provimet</p> <p>30.7 Shperndarja e relacionit te KSBC mbi silabuset</p> <p><u>Informacionet plotësuese të kërkuara gjatë vizitës</u></p> <p>11.1. Formularë të plotësuar për monitorimin e mësimdhënies në audior</p> <p>11.2. Vlerësime online të stafit akademik</p> <p>11.3. Raporti për provimet Departamenti Shkenca Humane dhe Komunikim</p> <p>11.4. Evidenca për zhvillimin e focus-grupeve_njoftimet_shperndarja e Raporteve</p> <p>11.5. Ekstrakt - Raport i fokus grupeve_2021-2022 dhe Kalendari i takimeve</p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="627 869 783 936">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="791 869 983 936">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="991 869 1182 936">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1190 869 1378 936">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="627 936 783 972"></td> <td data-bbox="791 936 983 972"></td> <td data-bbox="991 936 1182 972"></td> <td data-bbox="1190 936 1378 972">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<p><b>Standardi VI.4</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</b></p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Sipas dokumentacionit të përcjellë nga institucioni, UET me vendim të Senatit Akademik ka ngritur Komisionin për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, i cili ka në përbërjen e tij aktorë të brendshëm dhe të jashtëm. Në përbërje të këtij komisioni janë anëtarë përfaqësues nga të gjitha fakultetet e UET, përfaqësues i Këshillit Studentor, si edhe një ekspert i jashtëm. (Vendim Senati Nr. Prot 14 Date 17.12.2020 Miratimi i përbërjes se KSBC; Vendim Senati Akademik Nr. Prot 27 Datë 16.12.2021 Miratimi i përbërjes së KSBC) Ky komision rinovohet çdo vit dhe në përbërje të tij ka edhe përfaqësues të Këshillit studentor. Kjo gjithë përfshirje bën që të sillen në KSBC përvoja nga të gjitha fakultetet si edhe këndvështrime të ndryshme, duke ndikuar kështu në monitorimin dhe ruajtjen e cilësisë së programeve.</p> <p>Gjithashtu, një eksperiencë e mirë e për të thithur mendime që i shërbejnë rritjes cilësore të programeve është edhe ngritja e Bordeve të Punës pranë departamenteve. Kjo krijon gjithashtu mundësinë e marrjes së mendimeve për programet/ kurikulat dhe përshtatjen sa më të mirë të tyre me tregun e punës.</p>

	<p>Si pjesë e procedurave të tij të punës, KSBC ka krijuar metodologjinë e monitorimit, ka përcaktuar hierarkinë dhe linjën e komunikimit të raporteve të tij si edhe planin e aktiviteteve.</p> <p>Për të rritur cilësinë në arsimin e lartë, UET ka qenë pjesëmarrëse në dy projekte Tempus “ENCHASE” (përfunduar në 2016) dhe projektin e Erasmus + QAIN AL (përfunduar në 2019). Këto dy projekte kanë përfunduar, por njohuritë dhe informacioni i fituar i shërbejnë për KSBC dhe kanë ndihmuar në rritjen e cilësisë dhe llojshmërinë e mekanizmave të brendshëm për të rritur cilësinë në UET.</p> <p><i><u>GVJ sugjeron që Manuali për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë duhet përditësuar duke përfshirë përvojat e mësimdhënies online që u vërejtën gjatë viteve të pandemisë së COVID -19 si edhe me zhvillimet teknologjike në fushën e komunikimit.</u></i></p> <p><i><u>Referencë:</u></i></p> <p><i>30.5 Metodologjia e punës së KSBC provimet</i></p> <p><i>30.7 Shperndarja e relacionit të KSBC mbi silabuset</i></p> <p><i>30.9. Fisha e projektit Enchase</i></p> <p><i>30.10. Fisha e projektit QAINAL</i></p> <p><i><u>Informacionet plotësuese të kërkuara gjatë vizitës</u></i></p> <p><i>1. Mbledhje e Bordit të Tregut të Punës</i></p> <p><i>13.1. Vendim Senati Nr.Prot 14 Date 17.12.2020 Miratimi i perberjes se KSBC</i></p> <p><i>13.2. Vendim Senati Akademik Nr.Prot 27 Datë 16.12.2021 Miratimi i perberjes se KSBC</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Humane dhe të Komunikimit si pjesë e Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale janë pjesëmarrës në KSBC sipas vendimeve të Senatit Akademik. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë janë dokumentet bazë që përcaktojnë edhe proceduara dhe detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të KSBC-së.</p> <p>Në mbarëvajtjen edhe sigurimin e cilësisë së procesit mësimor një rol shumë të rëndësishëm luajnë edhe njësi të tjera të UET sipas programeve të studimit siç janë departamenti dhe koordinatori i programit.</p> <p><i><u>Referencë:</u></i></p> <p><i>30.5 Metodologjia e punës së KSBC provimet</i></p> <p><i>30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë</i></p> <p><i>30.3 Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë</i></p> <p><i><u>Informacionet plotësuese të kërkuara gjatë vizitës</u></i></p> <p><i>13.1. Vendim Senati Nr.Prot 14 Date 17.12.2020 Miratimi i perberjes se KSBC</i></p> <p><i>13.2. Vendim Senati Akademik Nr.Prot 27 Datë 16.12.2021 Miratimi i perberjes se KSBC</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet</p>	<p>Sipas dokumentacionit të përcjellë nga institucioni, sipas urdhrave administrativë mbi ngritjen e KSBC jepet përbërja e këtij komisioni me pjesëmarrjen nga të gjithë anëtarët nga departamentet dhe</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 80



<p>përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>fakultetet, nga Këshilli Studentor, si edhe me një pjesëmarrës ekspert të jashtëm.</p> <p>Sipas dokumentacionit “Mbi Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë” jepen përbërja dhe detyrat e anëtarëve të KSBC. Në përzgjedhjen e anëtarëve merren parasysh kriteret e mëposhtme:</p> <p>“...  <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Kompetencat profesionale;</li> <li>▪ Cilësitë personale (si ndershmëria, korrektesa, serioziteti, përgjegjshmëria, etj.);</li> <li>▪ Ngarkesa mësimore apo ngarkesa me kryerjen e funksioneve të tjera administrative;</li> <li>▪ Eksperiencia e mëparshme në detyrë të njëjtë apo të përafërt;</li> <li>▪ Të mos jenë pjesë e autoriteteve drejtuese të UET-it.</li> </ul> </p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Komisioni vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore, kërkimore ose artistike, si dhe efikasitetin e veprimtarive administrative dhe financiare të institucionit. Secili anëtar i KSBC përgatit raportin e vlerësimit për veprimtarinë e monitoruar”.</p> <p><u>Referencë:</u>  8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë  30.5 Metodologjia e punës së KSBC provimet  30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë  30.3 Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë  <u>Informacionet plotësuese të kërkuara gjatë vizitës</u>  13.1. Vendim Senati Nr.Prot 14 Date 17.12.2020 Miratimi i perberjes së KSBC  13.2. Vendim Senati Akademik Nr.Prot 27 Datë 16.12.2021 Miratimi i perberjes së KSBC</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vryera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Siç shikohet nga baza rregullative e ndërtuar nga UET lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë, si edhe nga urdhrat e Senatit Akademik për ndërtimin e KSBC, në përbërje të këtij komisioni janë edhe ekspertë të jashtëm dhe studentë.</p> <p>Ekspertët e jashtëm, në vitin aktual, janë pedagogë dhe pjesëmarrës në projekte të mëparshme me UET dhe që kanë ekspertizën e duhur për të procedurat, metodologjinë dhe mekanizmat për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë.</p> <p>Sigurimi i cilësisë bazohet në disa rrahë të kontrollit dhe disa nivele të zhvillimit të tij të tilla si (i) kontrolli nga drejtuesit e departamentit; (ii) përgjegjësi i grup lëndëve; (iii) koordinatori i programit; (iv) KSBC; (v) Zyra e kurikulave. Krahas edhe formateve të vlerësimit nga studentët dhe formateve të vetëvlerësimit të pedagogëve.</p> <p><u>Referencë:</u>  8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë  <u>Informacionet plotësuese të kërkuara gjatë vizitës</u>  13.1. Vendim Senati Nr.Prot 14 Date 17.12.2020 Miratimi i perberjes së KSBC</p>

	13.2. Vendim Senati Akademik Nr.Prot 27 Datë 16.12.2021 Miratimi i perberjes se KSBC			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Politikat, Strategjitë, dhe baza rregullatorë ku mbështetet aktiviteti i Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në UET janë të miratuara dhe një pjesë e tyre, që lidhet me aktet e rëndësishme rregullatore janë edhe publike në faqen online të UET.</p> <p>Ndërkohë që KSBC harton planin për aktivitetin e monitorimeve dhe vlerësimeve. Ky plan miratohet nga Rektori i Universitetit. Plani i aktiviteteve diskutohet me drejtuesit e departamenteve. Në ndërtimin e këtij plani dhe më pas zbatimin e tij është edhe një studentë që është anëtar i KSBC. Raportet e vlerësimit u njoftohen edhe drejtuesve të departamenteve përkatëse.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>2. Statuti i UET</p> <p>8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshem te cilesise</p> <p>16. A.II. Kodi e Etikës</p> <p>30. Të dhëna për individët e angazhuar në KSBC</p> <p>30.1. Plani veprimit KSBC</p> <p>30.7 Shperndarja e relacionit te KSBC mbi silabuset</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>UET i konsideron sensitive të dhënat e monitorimit nga KSBC dhe nuk i publikon. Informacioni nga monitorimi ndjek linjën hierarkike, duke u drejtuar tek drejtuesit e UET, Rektori, Administratori, dekanët e fakulteteve. Ndërsa në departament diskutohen vetëm pjesët respektive. Gjatë vizitës së GVJ, në dosjet e personelit akademik, u gjet edhe vlerësimi i stafit i përfshirë në dosje.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Informacioni i mbledhur me të gjitha formatet (anketime, fokus-grupe, vëzhgime nga kolegët/drejtuesit e departamenteve, në orët e mësimit, etj) përdoret nga njëra anë për të ndjekur ecurinë e situatës dhe gjithashtu për të sjellë në vëmendje problematika që duhet të marrin zgjidhje.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Rezultatet nga anketimet diskutohen në njësinë bazë dhe kryesore për të nxjerrë një plan masash veprimi për ndryshimin e pikave që mund të jenë të dobëta.</p> <p>Të dhënat nga pyetësorët vetë-vlerësues shfrytëzohen edhe të bërë krahasime në periudha kohore dhe për të bërë vlerësim të performancës. Departamenti i përdor rezultatet e anketimeve edhe individualisht për çdo pedagog për të dhënë info, edhe në departament duke i analizuar</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423


Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 82

	<p>ato me studentët në mbledhjet e hapura në semestër. Koordinatorët e programeve të studimit kanë gjithashtu një rol të rëndësishëm në mbledhjen dhe përpunimin e informacionit i cili ndihmon në marrjen e vendimeve për përmirësimin e cilësisë.</p> <p>Baza dokumentare e përcjellë nga institucioni dëshmojnë se UET vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, duke I shërbyer kështu përmirësimit të cilësisë së programit të studimit.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë <i>Informacionet plotësuese të kërkuara gjatë vizitës</i></p> <p>6. Vendim Senati Akademik Nr.Prot 11 Datë 26.03.2021</p> <p>13.1. Vendim Senati Nr.Prot 14 Date 17.12.2020 Miratimi i perberjes se KSBC</p> <p>13.2. Vendim Senati Akademik Nr.Prot 27 Datë 16.12.2021 Miratimi i perberjes se KSBC</p> <p>30.7 Shperndarja e relacionit te KSBC mbi silabuset</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Për të realizuar përfshirjen e stafit akademik dhe studentëve në përmirësimin e cilësisë së programeve akademike UET përdor metoda të drejtpërdrejta dhe të tërthorta. Të drejtpërdrejta janë pjesëmarrja e pedagogëve dhe studentëve në organizmat që monitorojnë sigurimin e cilësisë. (KSBC, Këshilli Studentor, Senat Akademik, etj.).</p> <p>Gjithashtu edhe në dy projekte të realizuara në tij 2013-2016 ENCHASE TEMPUS dhe QAINAL 2016-2019 që lidheshin me sigurimin e brendshëm të cilësisë janë organizuar trajnime të stafit lidhur me sigurimin më të mirë të cilësisë, duke synuar arritjen e standardet ndërkombëtare. Outputet e këtyre projekteve janë ende në formatet e standardeve, metodologjive dhe stafit të trajnuar.</p> <p>Informacion për studentët realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në KSBC, si edhe në mbledhjet e hapura të departamentit. Gjithashtu, informacion të rëndësishëm studentët marrin edhe në javën e parë të orientimit lidhur me ecurinë dhe mënyrat për të kontribuar në cilësinë e programeve të studimit.</p> <p><u>Referencë:</u></p> <p>2. Statuti i UET</p> <p>8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë</p> <p>16. A.II. Kodi i Etikës</p> <p>30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë</p> <p>30.3 Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë</p> <p>30.4. Urdhër administrativ mbi përbërjen e KSBC</p> <p>30.5 Metodologjia e punës së KSBC provimet</p> <p>30.7 Shperndarja e relacionit te KSBC mbi silabuset</p> <p>30.8. G-III-4-1 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu</p> <p>30.9. Fisha e projektit Enchase</p> <p>30.10. Fisha e projektit QAINAL</p> <p>37. Formati i relacionit për monitorimin e silabuseve</p> <p><i>Informacionet plotësuese të kërkuara gjatë vizitës</i></p>

	30.7 Shperndarja e relacionit te KSBC mbi silabuset 2.1. E-mail_Mbledhje e hapur me studentë - 2021 2.2. E-mail_Mbledhje e hapur me studentë - 2022 2.3. Mbledhje e hapur me studentë - 2021 2.4. Mbledhje e hapur me studentë - 2022			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Komunikim” me profilet “Gazetari”, “Marrëdhënie Publike”, “Grafikë- Dizajn” dhe “Marketing” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti European i Tiranës”**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Nëpërmjet “Bordeve të Punës” UET ka vendosur marrëdhënie të qëndrueshme me qendra, organizma dhe biznese, duke mbështetur përfitimin e studentëve për praktika profesionale. Kjo u krijon mundësinë studentëve të njohin tregun real të punës dhe njëkohësisht të krijojnë eksperiencë për më tej. Departamenti mbështetet në përvojën e mirë të krijuar nga UET në të gjitha fushat e tjera duke krijuar një bazë të mirë për studentët edhe në planifikimin e karrierës së tyre.
2. Mundësia e zhvillimit edhe te programit të ciklit të dytë në të njëjtin universitet, dhe madje edhe në Ciklin e Tretë është një tërheqje më shumë për studentët dhe i ndihmon ata për të plotësuar kuadrin e dijeve dhe përballjen me tregun e punës.
3. Kurikula për këtë program studimi është e ndërtuar përmes një ndarje të drejtë të ngarkesës së lëndëve në tri vitet akademike. Marrja e njohurive teorike dhe shprehive praktike vjen në mënyrë graduale nga viti parë, në të tretin, me një kombinim të lëndëve që zhvillohen.
4. Studentët që ndjekin programin e studimit “Komunikim” Bachelor kanë hapësira të japin mendime dhe sugjerime mbi kurikulën, mbi metodat e mësimdhënies nga ana pedagogëve, mbi cilësinë e literaturës së detyruar dhe të rekomanduar, etj. Njësia bazë ka vëmendje për të dëgjuar mendimet dhe propozimet e studentëve, për të reflektuar në përmirësimin e standardeve të programit.
5. Profili i theksuar publik i institucionit dhe përfshirja e tij në aktivitete ekstrakurrikulare u japin mundësi studentëve për të eksploruar njohuritë e tyre në fushën e komunikimit ekspozuar edhe aktivitetin e tyre në fushën komunikimit.
6. Sistemi i brendshëm i komunikimit elektronik lehtëson procesin e mësimdhënies dhe krijon interaktivitetin midis studentëve dhe stafit, u vërejt si mjaft i vlefshëm sidomos në kushtet e pandemisë Covid-19.



## Pika të dobëta

1. Tendencë në ulje gjatë viteve të fundit të përfshirjes së personelit akademik me grada dhe tituj shkencorë në këtë program studimi.
2. Aktualizimi i literaturës, si fond i bibliotekës, veçanërisht publikime të viteve të fundit në hard copy dhe soft copy, që lidhen me kurrikulën e programit “Komunikim” në Bachelor.

## Rekomandime

1. Njësia bazë dhe dekanati duhet të kenë më shumë në vëmendje ngritjen e kualifikimit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi, për fitimin e gradave dhe titujve. E njëjta gjë mund të thuhet dhe për procesin e rekrutimit të personelit të ri, PAE dhe PAK që duhet të jetë me grada e tituj shkencorë, si garanci për cilësinë dhe qëndrueshmërinë e këtij program studimi.
2. Institucioni duhet të forcojë më tej mobilitetet e studentëve me universitetet jashtë vendit, në kuadër të projekteve. Do të duhet të kapërcejnë gradualisht ndikimin nga pandemia COVID-19 e këtyre dy viteve. Departamenti dhe UET sugjerohet të forcojnë komponentin e pjesëmarrjes në projekte ndërkombëtare, për kërkimin shkencor si edhe projektet e BE.
3. Manuali për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë duhet përditësuar duke përfshirë përvojat e mësimdhënies online që u vërejtën gjatë viteve të pandemisë së COVID -19 si edhe me zhvillimet teknologjike në fushën e komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun.
4. Biblioteka e UET duhet të shtojë më shumë shkëmbimet e publikimeve shkencore, si një instrument efektiv në plotësimin e kërkesave për literaturë cilësore dhe e shumëllojshme që kanë studentët dhe pedagogët e këtij programi studimi, apo dhe në programe të tjera të studimit në UET.

**Conclusions of the Evaluation of the study program of the first cycle Bachelor "Communication" with the profiles "Journalism", "Public Relations", "Graphic-Design" and "Marketing" of the Institution of Higher Education "European University of Tirana"**

**Strengths and Affirmations:**

1. The establishment of "Labour Boards", UET has created and maintained stable relations with different centres, organizations and businesses, being so a support to the students for professional practices. This gives students the opportunity to get to know the real labour market and as well, as create experience for their future career. The Department relies on the good experience, created thought years, by UET in all fields setting up a solid foundation for students in their career planning.
2. The possibility of follow up the Second Cycle program (Masters') at the same university, and even in the Third Cycle (PhD.) is another attraction for the students and helps them to complete the framework of knowledge and face the real labour market.
3. There is a fair and equal division of the course loads and credits taken during the three academic years, for this study curricula. The acquisition of theoretical knowledge and practical skills comes gradually from the first year to the third one, with a combination of subjects that are scheduled in the study program.
4. There is an open space/opportunity for discussion with the students of Bachelor program of "Communication" for them to give opinions and suggestions on the curriculum, on the teaching methods by the lecturers, on the quality of the required and recommended literature, etc. The program's Basic Unit has been carefully listening to the opinions and proposals of the students, to reflect on the improvement of the program's standards.
5. The prominent public profile of the UET and its involvement in extracurricular activities give students the opportunity to explore their knowledge in the field of communication and expose their activity in the field of communication.
6. The internal electronic communication system facilitates the teaching process and creates interactivity between students and staff, was seen as quite valuable especially during the Pandemic of Covid -19.

**Weak points:**

1. During the last years, there has been a tendency to decrease the involvement of academic staff with high degrees and scientific titles in this study program.
2. The literature in the library fund should be updated, especially with publications of recent years in hard copy and soft copy, related to the curriculum of the "Communication" program in the Bachelor.

**Recommendation:**

1. The basic unit and the dean's office need to pay more attention to raising the qualification of the academic staff engaged in this study program, for obtaining degrees and titles. The same can be said about the recruitment process of new personnel, which must hold degrees and scientific titles, as a guarantee for the quality and sustainability of this study program
2. The institution (UET) should further strengthen the mobility of students with universities abroad within the framework of projects. There is the need to gradually overcome the impact of the COVID-19 pandemic of these two years, in this respect. It is suggested to the Department and UET overall to strengthen the component of participation in international projects, for scientific research as well as other EU projects.
3. The Internal Quality Assurance Manual might need to be updated and include the online teaching experiences observed during the years of the COVID-19 pandemic as well as technological developments in the field of communication and public relations.
4. The UET library should increase the exchange of scientific publications, as an effective instrument in meeting the requirements for quality and diverse literature, that the students and lecturers of this study program have, or in other study programs of UET.



**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

